

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Prill 2012
Numri: 49
E përmuajshme

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den

ETIKA

Prania e PROFETIT në jetën tonë


صلى الله
عليه
وسلم



9 772223 61006

Zytetërimi i virtyteve

Nga epoka e lumturisë deri në ditët tona



*“Historitë e bukura
të robërve të devotshëm
janë pothuaj si dhuratat
e xhenetit.”*



Editorial

“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për të. O besimtarë! Lutuni për të dhe përshëndeteni me “selam”!” (el-Ahzab, 56.)

Allahu Teala i bën të ditur mendjes njerëzore se Profeti (a.s.), është një krijim madhështor me cilësi të rralla, një vepër e mrekullueshme e Tij.

Të tregosh atë, është shkalla më e lartë e devotshmërisë ndaj Allahut. Pa e kuptuar dhe pa e njohur atë, pa ndjekur gjurmët e tij dhe pa përfituar prej ndjesive të tij shpirtërore, as besimi ynë nuk është i plotë, as Kuranin nuk mund ta kuptojmë dhe as devotshmëria jonë nuk është e përsosur...

“Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed), që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.” (esh-Shu’ara, 193-195.)

Jeta e tij profetike prej njëzet e tre vjetësh, është një tefsir më vete i Kuranit Kerim. Prandaj, të fshehtat dhe urtësitë e Kuranit mund të kuptohen vetëm duke përfituar prej ndjesive të tij shpirtërore.

“...ruajuni Allahut! Allahu ju mëson juve (atë që nuk e dini) ; Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” (el-Bekare, 282.)

Të mësosh “Sijer-i Nebi” (historinë e Profetit -a.s.-), nuk arrihet vetëm me një lexim kronologjik të ngjarjeve. Ata që e dinë më mirë “Sijer-i Nebi”, janë ata, jeta e të cilëve u përngjan më së shumti jetës së Profetit (a.s.). Ata që e njohin më mirë atë, janë ata që jetojnë me devotshmëri dhe përpikëri sunetin e tij, janë të dashurit e Allahut, të cilët jetojnë të përmalluar për atë diell të mëshirës. Ata ecin në gjurmët e të Dërguarit të Allahut, ashtu siç ecën hija mbas të zotit.

Profeti ynë i dashur (a.s.), është një diell që mbush çdo gjë me emocione lumturie dhe me udhëzimin e tij ndriçon të gjitha botët. Edhe të dashurit e Allahut, të cilët janë trashëgimtarë të profetëve, me devotshmërinë e tyre janë bërë si drita e hënës, që reflekton dritën e diellit. Ekzistenca e dritës së hënës është e lidhur ngushtë me dritën e diellit, sepse nuri, bukuria dhe madhështia e dritës së hënës është një reflektim i vogël që vjen prej diellit...

Në veprën e tij “Gylistani”, shejh Sadi shprehet:

Një njeri shkoi në hamam dhe një nga miqtë e tij i dha një copë argjile me erë të këndshme për t’u pastruar. Prej argjilës përhapej një aromë e këndshme, që të ledhatonte shpirtin. Prandaj dhe njeriu e pyeti argjilën:

- Ah, moj e bekuar! Mos je gjë misk apo amber? Aroma jote ma kënaqi shpirtin...

Argjila i thotë:

- Unë nuk jam as misk dhe as amber, por veçse një copë tokë. Por gjendem poshtë rrënjëve të një trëndafil dhe çdo mëngjes lagem prej pikave të vesës që bien nga gonxhet e tij. Pra, edhe aroma e këndshme që të kënaqi shpirtin, vjen prej atij trëndafil...

Trëndafil është simboli i Profetit tonë (a.s.). Prandaj dhe gjëja më e rëndësishme, që duhet të mësojë njeriu në shkollën e kësaj jete të përkohshme, është:

Të njohë atë mbret të Trëndafilave.

Të përfitojë prej aromës së atij Trëndafil të bekuar dhe prej ndjesive të tij shpirtërore.

Të bëhet një pikë vese në petalet e tij...

Do të lexoni:



- Ahmet Tashgetiren / 4** Edukata e Profetit në jetën tonë të përditshme
- Dr. Kerim Bulladë / 8** Jeta bëhet e bukur me besim dhe vepra
- Vehap S. Kola / 10** Një biografi tjetër për Profetin
- Edison Çeraj / 12** Dija e transmetuar dhe urtësia
- Imam Muhamed Sytari / 14** H. Vehbi Sulejman Gavoçi
- Prof. dr. Ezhder Okumush / 16** Muhamedi (a.s.) dhe shoqëria e mëshirës
- Prof. dr. Sherafetin Gëlçyk / 20** Mesazhi i Kuranit
- / 23** Ne dhe edukimi
- Mirjona Dervishi / 24** Sistemi bankar Islamik: Nga kërcënimet e krizës në mundësitë për të ardhmen
- Prof. dr. Ibrahim Sarmësh / 27** Mbulesa
- Nexhat Ibrahimimi / 28** Konteksti shoqëror-politik dhe kulturor-shkencor i shfaqjes së filozofisë dhe shkencës në perëndim

Ahmet Tashgetiren



4

Prof. dr. Ezhder Okumush



16

Mirjona Dervishi



24

Viti: VI | Numri: 49 | Prill 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com
+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Ma. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Arjan Ymeraj / Artur Tagani

Elona Sytari / Evans Drishti

Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Prill 2012

40

Osman Nuri Topbash



Mjeshtëria në punën e myslimanit

Kamata dhe shoppingu

Martesa pothuajse një mrekulli

Fotoja e Muajit

Një ajet - Një hadith

Të njohësh shpirtërisht Profetin (a.s.)

Integriteti mendje-shpallje

Mbi lutjen dhe shekullarizmin

Islami është Teuhid

Rëndësia e këndimit të Mevludit

Mbështetja tek Zoti

Në demokrasit detyra sociale e grues

Shqiptarja në ndërtimet osmane

Filozofia Islame

Qëndrimi i sheriatit ndaj sterilitetit

Ebu Ferexh el-Isfehani dhe vepra e tij

"El-Egani", enciklopedia klasike

e muzikës arabe

Profeti i mëshirës

Arsyet pse ta konsumojmë ujin

Teknologjia që do të ftohë planetin

30 / *Ma. Gilman Kazazi*

32/ *Abdurrahman Xhandan*

34 / *Xhafer Durmush*

36 /

38-39 /

40 / *Osman Nuri Topbash*

46 / *Alltan Murat Ynall*

49 / *Dr. Myzafer Tan*

52 / *Adil Akojunllu*

54 / *Sami Muçej*

56 / *Mustafa Islamgollu*

58 / *Zani i s'kaluemes*

60 / *Ma. Ermal Nurja*

62 / *Ma. Artur Tagani*

64 / *Ma. sci. Flamur Sofiu*

68 / *Enciklopedi Islame*

70 / *Imam Naim Drijaj*

72 / *Shëndet*

73 / *Teknologji*

49

Dr. Myzafer Tan



56

Mustafa Islamgollu



PROGRESI
SOTIMI
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi

Shkodër / Albania

Tel: +355 22 254 634

Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25

Shkup / Maqedoni

+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin

Prizren / Kosovë

Tel: +381 29 222 795

Fax: +381 29 222 797

+377 4411 98 48

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor): 1500 Lekë

Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro

Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN

Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro

Edukata e Profetit në jetën tonë të përditshme

Ahmet Jashgetiren

Suneti është Kurani dhe islami, zbatuar në jetën e përditshme nga profeti Muhamed, salallahu alejhi ve sellem; korniza e jetës, të cilën duhet ta marrë si shembull çdo mysliman.

Brezi i parë i myslimanëve e pati shumë të vështirë ta jetonte fenë në jetën e përditshme, pasi duhej të përballej me reagimet që vinin nga shoqëria e tyre me një strukturë të vjetëruar, e cila i sulmonte vetëm për faktin se ata besonin në një fe tjetër. Qe një kohë, kur edhe prindërit ta prisnin rrugën e nisur.

Megjithatë, ai brez kishte edhe një avantazh. Shpallësi i fesë së re jetonte mes tyre dhe një- rëzit mund ta shihnin nga afër, të shkonin pas tij dhe të ndërtonin një personalitet të ri, në sajë të

edukimit që merrnin prej tij. Për të treguar përpikmërinë e jetës së unifikuar me mësimet e shpalljes hyjnore, Abdullah bin Umeri pati thënë: "Ne tregoheshim të kujdesshëm që të mos debatonim as me gratë tona, se kishim frikë se mos zbriste ndonjë ajet në lidhje me ne."

Vahji, sapo ishte shpallur.

I Dërguari i Allahut jetonte mes tyre si një edukator që i largonte nga skaji i gropës së zjarrit, pranë së cilës ndodheshin. Ai përpiquej me sa fuqi që kishte, ngaqë merakosej se mos myslimanët do të ndiqnin rrugën që do t'i shpinte në zjarrin e xhehenemit.

Vështirësia që përjetuan ata që erdhën pasi Profeti Muhamed ndërroi jetë, qe fakti se ata mund të takoheshin me shembullin e tij të bukur vetëm nëpërmjet librave.

Këtë vështirësi e kishte parashikuar edhe vetë profeti Muhamed, i cili kishte lavdëruar ata që "do të vazhdonin në gjurmët e tij, edhe pse nuk e kishin parë me sytë e tyre"; i kishte konsideruar ata "vëllezërit" e tij dhe kishte dhënë sihariqin se "do të ishte në pritje të takimit me ta tek burimi i Kevtherit, në xhenet".

Ashtu siç pati ngjarë me shembullin e Hanzales edhe në atë periudhë ekzistonte një dallim mes qëndrueshmërisë shpirtërore që përjetohet kur gjendeshin me zemër bashkë me profetin, ndërsa ndodheshin në vende të ndryshme. Hanzale i pati pohuar Ebu Bekrit se "ai ishte në të vërtetë një mynafik", kur e kishte takuar këtë të fundit në rrugë...

Pse vallë?

Sepse,- shtonte Hanzaleja,- kur qëndroj së bashku me Profetin, përjetoj momente të ndryshme shpirtërore nga ato që përjetoj kur ndahem prej Tij.

Ky qe padyshim, një dallim shumë i rëndësishëm.

Prandaj problemet e brezave që erdhën pas Profetit përmbledheshin në mënyrën e përjetimit të ndjenjave, pasi Profeti ishte ndarë nga kjo jetë.

Domosdoshmëria e praktikës së rabëta-së në misticizmin islam, buron po kështu nga nevoja për të përfutur një mundësi takimi edhe në kushtet e mungesës së tij në këtë botë. Përpjekja për të mbërritur tek ndjesitë që përjetohehin, kur profeti qe gjallë, u shndërrua në njërin prej elementëve themelorë të edukatës mistike.

Në këtë situatë, në qoftë se përiqemi "të jemi bashkë me profetin edhe tani që ai është ndarë nga kjo jetë", do të thoshte të merrje edukimin nga profeti në rrugë shpirtërore.

Duke pohuar në lidhje me çdo gjë se "**Profeti ka thënë se...**", ne transmetojmë rreze drite nga Profeti në jetën tonë të përditshme.

Atëherë Ai e ndërton personalitetin tonë sipas Kuranit, e ndërton me fjalët e tij të bekuara, që komentojnë ajetet e Kuranit.

Atëherë, ejani dhe të fillojmë të bashkëbisedojmë, duke thënë "**Profeti na ka thënë se...**":

Profeti na ka thënë se:

Islami ngrihet mbi pesë shtylla. Fjala e dëshmisë islame, namazi, agjërimi, haxhi dhe zeqati...

Profeti na ka thënë se:

Imani ka gjashtë kushte. Besimi në Allahun, melekët, librat, profetët, ahiretin dhe kaderin, pra që edhe e mira edhe e keqja vijnë prej Zotit.

Profeti na ka thënë:

Të jetojmë sipas ihsanit, që do të thotë të ndërtojmë jetën tonë të përditshme si robër të Zotit, sikur shohim Zotin, që është duke na parë se çfarë bëjmë. Megjithëse ne nuk e shohim Atë, Ai na sheh ne.

Pastaj profeti synon që të endë qëndisma me anë të islamit, imanit dhe ihsanit, në personalitetin tonë si myslimanë. Nuk mund të shkohet tek konsistenca e myslimanit të vërtetë, pa i përbushur siç duhet kushtet dhe obligimet e çdonjërit prej tyre.

Profeti na sjell ndërmend ajetin e Kuranit, ku thuhet:

"Nuk mbaron puna pse thatë vetëm «Kemi besuar».
Ky pohim shpreh vetëm përfshirjen në kornizën e Islamit. Besimi nuk ka zënë ende vend mirë siç duhet nëpër zemra."

Synimi i gjithë këtyre që thamë, është të mbërrihet në qëndrueshmërinë që përjetohej "**nga një rob i Zotit që vepron sikur është duke e parë Zotin**".

Për këtë arsye, profeti ka thënë se "*Namazi është shtylla e fesë*". Në qoftë se ai do të na shihte se falemi thjesht, sa për të kryer obligimin e namazit, do të na thoshte "*Sa për kështu, ti nuk je falur aspak, prandaj shko dhe falu sërish*". "*U fale, por vetëm një e dhjeta e namazit që fale pati vlerë për ty*" Ai na detyronte që ta përsërisnim namazin e falur në këtë mënyrë disa herë. Në qoftë se namazi, agjërimi nuk e pastron personalitetin tonë dhe nuk ndikon që ne të heqim dorë nga gjynahet, pra, në qoftë se nuk është namazi dhe agjërimi i duhur, atëherë Profeti do të na kishte tërhequr vërejtjen për faktin se

"Allahu nuk ka nevojë që ju të përkuleni përpara Tij apo që të rri me barkun bosh." "*Çdo namaz fale duke menduar se mund të jetë namazi i fundit që fal në këtë jetë.*"

Në çdo namaz, Profeti u mësonte myslimanëve të kuptonin se po qëndronin përpara audiencës hyjnore.

Nga fjalët e profetit kuptojmë se agjërimi është edukimi i të qenit rob i Zotit. Ai dëshironte prej nesh që agjërimi të shndërrohej në mburojë tonë prej gjynaheve dhe që së bashku me agjërimin të udhëtonim bashkë deri në xhenet. Ai dëshironte që ne të laheshim dhe të pastroheshim në klimën e agjërimin, si të ishim duke u larë nën një ujëvarë një muaj rresht.

Në qoftë se do të shihte se koprracia jonë do të dilte në pah, kur të shihnim se si profeti po ndante pjesën e zeqatit dhe të sadakasë nga pasuria jonë, ai do të na kujtonte urdhrin e Kuranit: "**Dhuroni me dëshirë nga ato që janë gjërat më me vlerë për ju.**" Po ashtu do të na kujtonte thirrjen e Kuranit: "**Mos jepni sadaka atë gjë që, po t'jua dhuronin të tjerët, ju do të prishnit çehren.**" Ai na njofton paralajmërimin e Kuranit: "**Mos e jep sadakanë sikur je duke ia dhënë në dorë Allahut**". Mos lejo që pasuria jote të ndyhet,- thoshte profeti. *Jep zeqatin, që ta pastrosh pasurinë tënde nga e drejta e të varfrit mbi ty.*"

Zemra e tij nuk pajtohej me veprimin e njeriut që dhurome dhe përdorte fjalë ose bënte veprime kabahe ndaj të varfrit, duke e nënçmuar në këtë mënyrë atë. Zemra e profetit nuk pajtohej me sadakanë që e vriste

në shpirt të varfrin.

Ai e përjetonte dhe e prezantonte haxhin si një takim mes anëtarëve të ymetit, si një kongres gjithëpërfshirës, ku shpallehin publikisht mesazhet globale të Islamit ndaj botës mbarë.

Ai qe profet. Ai qe njeri që nuk bënte mëkate. Megjithatë, ngrihej në mbrëmje dhe falej para Zotit, deri sa i fryheshin këmbët.

Dëshira e tij e vetme ishte: *"Të meritonte të konsiderohej nga Zoti njeri mirënjohës dhe falënderues."*

Ja pra, ky është perceptimi i ekzistencës, perceptimi i të qenit rob i Zotit, perceptimi i begative hyjnore dhe ndjenja e falënderimit (shukr), që buronte nga këto lloj perceptimesh. Kjo përpikmëri e treguar nga profeti, sjell para egos sonë përgjegjësinë e vetëllogarisë që edhe pse përdor gjithë ato të mira të Zotit, megjithatë kryen rregullat e Tij.

Le t'i shtojmë kësaj edhe "edukimin e Profetit që bënte istigfar njëqind herë në ditë". A nuk na bluan nga brenda merakut se "edhe po t'i lajmë një mijë herë në ditë duart dhe zemrat tona, kemi arritur qoftë edhe një istigfar të vetëm që bënte profeti?"

Trishtimi në zemrën e sahabiut, që shkoi tek profeti pasi kishte bërë një gjynah të madh dhe iu drejtua atij me fjalët: "Më pastro nga ky gjynah, o i Dërguari i Allahut!", a nuk përbën një kriter matjeje për botën tonë të mëkateve? Sa situatë e vështirë është të qëndrosh përpara të dërguarit të Allahut, kur jeta jote është e fëlliqur dhe e errësuar nga numri i madh i gjynaheve!

Si do të kishte ushtuar në botën tonë të ekonomisë, që është zhytur deri në fyt brenda kamatës, thirrja e tij *"e shtyp me këmbë kamatën"*, duke vënë para nesh marrëdhënien që krijoi ai me fajden, të cilën nën urdhrin e Kuranit e konsideroi përherë si **"luftë e shpallur vetë Zotit"**? Si do të kumbonte në zemrat tona kërcënimi profetik, i mbështetur në Kuranin se **"ai që ushqehet me para të fituara me kamatë, do të ngrihet nga vendi ku është, duke ndenjor si i djallosur."**

Në qoftë se gjakmarrja, për të cilën profeti shpalli publikisht në haxhin e lamtumirës se e kishte shkelur me këmbë, vazhdon të jetojë si traditë mes njerëzve të sotëm dhe, në qoftë se sot ende vdesin njerëz nga plumbi qorr, a nuk do të ndalemi një çast të pyesim veten: "A kam zemër unë vallë apo nuk kam zemër?"

Thirrjet e Kuranit: **"Kapuni pas Allahut, vraponi drejt Allahut"**, përjetohen me një emocion të veçantë, kur dëgjohen nga vetë goja e Profetit. Ai na komunikoi thirrjen hyjnore se **"Po e përmendët Zotin edhe Ai do t'u përmendë juve"**, duke shtuar edhe informacionin e mrekullueshëm se **"Kudo që të ndodheni, Zoti është bashkë me ju."** Madje edhe sihariqin se **"Njeriu ka më afër Zotin, sesa damarin e qafës së tij"**, së bashku me paralajmërimin që **"të mos tregohemi indiferent ndaj fesë"**. Ah, sikur zemra jonë të ishte e mbrujtur nga dora e profetit me këto paralajmërimet hyjnore.

Kushedi sa tronditëse do të ishte për ne, kur profeti do të na tërhiqte vëmendjen me ajete që na sjellin ndërmend *"takimin me Zotin"*, *"Zotëruesin e ditës së fesë"* dhe *"librin tonë të jetës që do të lexohet në botën tjetër"*, në një kohë kur ne jemi kaq shumë të dhënë pas kësaj bote dhe kujtojmë se do të mbetemi përherë këtu.

Sa emocionuese do të ishte të perceptonim nga e para Kuranin me profetin, për të cilin Kurani thotë se është *"udhëzues për besimtarët e devotshëm"*, të përcjellim në individualitetin tonë nivelin e lartë të profetësisë së Muhamedit (a.s.), nëpërmjet veçorive Rauf dhe Rrahim, që vijnë nga bota e atributëve hyjnore (esmaulhusna).

A nuk do të pastrohej përfundimisht zemra jonë, në qoftë se do të niseshim për hixhret drejt Medinës së Islamit dhe kur rreziku për jetën të na afrohej aq shumë, sa prej tij të na ndante vetëm një rrjetë merimange dhe në atë moment të na qetësonin vetëm fjalët e Profetit: **"Mos u brengos se Zoti është me ty"**.

Si do të na këputeshin këmbët dhe do të binim përtokë, në qoftë se do të shihnim të pasqyruar në sytë e Profetit nervozizmin që do të shkaktonin fjalët, që do t'i thoshim një vëllai tonë të fesë, duke e quajtur *"djali me nënë zezake"*, duke e fyer për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës dhe gjuhës që flet, edhe në qoftë se do të kishim emrin e mikut më të ngushtë të profetit, siç ishte, për shembull, Ebu Dheri.

Çfarë është vëllazëria islame, që ngjason me dhëmbët e krehërit? Cila është pozita më sublime tek Allahu? Çfarë është cilësia e devotshmërisë? Cili njeri mund të quhet i devotshëm? A nuk do ta mbrunim më ndryshe personalitetin tonë, në qoftë se do të dëgjonim prej gojës së Profetit Muhamet kriteret e Kuranit?

Çfarë do të bënim, në qoftë se ai do të na kërkonte



llogari, duke na thënë: “Nuk do të hyni në xhenet, në qoftë se nuk do të besoni; nuk do të keni besuar, në qoftë se nuk ia doni të mirën njëri-tjetrit”, kur të kishte parë veprimet tona si ymet pas të cilave ne ndihemi të ndarë nga njëri-tjetri me kilometra? Do të lëshonte testamentin e tij në zemrat tona, që të bëhemi të gjithë si dhëmbët e krehrit. Po në qoftë se do të na edukonte, duke iu lutur Allahut që myslimanët të mos ushqejnë smirë për njëri-tjetrin. Do të na urdhëronte t’ia shtrëngonim dorën njëri-tjetrit duke shtuar fjalët bëhuni vëllezër me njëri-tjetrin.

Si do të merakoseshim, kur të na tërhiqte vërejtje me “paralajmërimin e hidhët” të Kuranit se kemi ngatërruar miqtë tanë të vërtetë me armiqtë tanë, duke u bërë miq me “armiqtë e Zotit”, si shejtani dhe idhujt, për të cilët Allahu na ka paralajmëruar që **“të mos miqësoheni me ta”** dhe si përfundim kemi dalë nga rruga e “Mikut të vërtetë”.

Sa do të përpiqeshim që të pastronim zemrën tonë, në qoftë se do të kishim vrarë dikë në luftë, edhe pse ai kishte thënë fjalën e dëshmisë islame, duke menduar se është bërë mysliman, nga frika e vdekjes dhe kur këtë ngjarje ta kishte marrë vesh profeti Muhamed, i cili do të na kishte qortuar orë e çast duke na thënë: “Mos vallë ia çave zemrën dhe e pe se çfarë besonte në të vërtetë ai njeri?” A nuk do të kishim thënë me vete: “Ah, sikur të isha bërë sot mysliman, në mënyrë që të mos e meritoja këtë qortim të Profetit?”

Si do të kishin humbur kuptim luksi dhe pasuria jonë përpara Udhëheqësit të Bekuar, që përsëriste shpesh se ai “ishte djali i një gruaje që hante mish të thatë” dhe që preferonte të flinte mbi një rrogë, që i linte shenja në trup, megjithëse ai ishte profeti i një bashkësie shumë të madhe.

Profeti që qepte rrobat e tij në shtëpi. Një burrë shtëpie që, jo vetëm nuk i shkonte ndërmend të përdorte dhunën dhe forcën ndaj grave të tij, por që nuk i ngacmonte as me fjalë të rënda ato... Çfarë shembulli për botën tonë të ndjenjave, atëherë kur logjika fluturon përpara nervozizmit. Çfarë rregulli të ri do të sillte në jetën tonë të përditshme, të mbytur nga hallet e familjes, punës dhe detyrimeve të tjera shembulli i profetit, që nuk e nënvleftësonte aspak përgjegjësinë e tij familjare, megjithëse kishte detyrën më të vështirë në botë, atë të profetësisë?

Zemërdhembshur,
Hijerëndë,

Modest,
Buzëqeshur,
Rauf,
Mëshirues,

Një karakter i rrallë, i pajisur me të gjithë anët e bukura të moralit.

Me sa dëshirë të zjarrtë do të zhyteshim në oqeanin e dashurisë hyjnore, në qoftë se do të dëgjonim ftesën profetike: **“Në qoftë se e doni Allahun, më ndiqni mua, në mënyrë që edhe Allahu t’u dojë juve dhe t’jua falë mëkatet”...**

“Çfarë t’u urdhërojë profeti, zbatojeni, atë që ua ndalon ai, mos e bëni!”

Kështu na urdhëron Krijuesi i Lartë në Kuran.

Profeti pasqyroi vetëm sjellje dhe veprime të hijshme, gjatë gjithë jetës së tij.

Ai jeton edhe pasi u nda nga kjo jetë, nëpërmjet shembujve të bukur që la pas.

Ai jeton së bashku me Kurandin.

Ai jeton me modelin e jetës, që Kurani e cilësoi si **“shembullin më të bukur”**.

Njerëzit që jetuan në një kohë me të, e deshën, sa ishin gati të jepnin shpirtin për të, ia dëgjuan dhe iu bindën fjalëve të tij gërmë për gërmë, jetuan me dëshirën që të ngjasonin me të në fjalë, sjellje dhe veprime...

Ky qe morali i një ymeti të tërë.

Edukata e një ymeti, që mbeti amanet për brezat që do të vinin.

“Të bëhesh pjesë e ymetit”, do të thotë të edukohesh sipas shembullit të profetit.

Të përçosh në zemra dritën e tij.

Të ndriçosh rrugën tënde të jetës me dritën e tij.

Të lumtë ata, që arrijnë të kryejnë fundin e udhëtimit islam, të kapur për dore nga Profeti.

Të lumtë ata, që arrijnë ta përmbushin udhëtimin e jetës, nën Flamurin e Lavdërimit (livaul-hamd).

I lutemi Zotit që të na bëjë të mundur të pimë, qoftë edhe një pikë ujë, nga duart e bekuara të Profetit, atje në burimin e Kevtherit në Xhenet.



Jeta bëhet e bukur me besim dhe vepra

Dr. Kerim Bulladë

Allahu Teala i ka dhënë mirësi të ndryshme njeriut. Mirësitë materiale dhe shpirtërore që Ai i ka dhuruar njeriut, është e pamundur të numërohen. Në lidhje me këtë çështje, Allahu Teala thotë:

“Ai ju dha gjithçka që dëshironi. Nëse përpiqeni t’i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk dot’i numëroni dot. Njeriu me të vërtetë është i padrejtë dhe mosmirënjohës.” (Ibrahim, 34)

Disa mirësi janë të dukshme dhe disa të tjera janë të padukshme. Allahu i Madhëruar, në ajetin fisnik, thotë:

“A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t’i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiejë e në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme?..” (Llukman, 30)

Mirësitë, si mendja, mendimi, vullneti, revelata dhe Islami, janë përmendur si mirësi shpirtërore. Ndërsa organet e trupit tonë, uji që pimë, frutat e perimet që hamë, pasuritë tona nëntokësore e mbitokësore dhe produktet e detit, janë përmendur si mirësi materiale.

Në krye të mirësive që Allahu Teala i ka dhuruar njeriut, është mirësia e jetës. Jeta e njeriut, e cila është pajisur me mendje, mendim, gjykim dhe vullnet, nuk i ngjan jetës së krijesave të tjera, sepse njeriu është cilësuar si krijesa më e ndershme. Shumë krijesa, shumë mirësi dhe shumë mundësi janë vënë në shërbimin e tij.

Për këtë arsye, njeriu është i obliguar që të njohë Allahun, ta sistematizojë jetën sipas urdhrave e ndalesave të Tij dhe ta falënderojë Atë. Ajeti i mëposhtëm përcakton pozitën dhe vlerën e njeriut ndërmjet krijesave të tjera. Allahu i Madhëruar thotë:

“Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi

bërë të mundur që të udhëtojnë në tokë dhe në det, u kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej atyre që kemi krijuar.” (Bekare, 28)

Nëse njeriu e kryen detyrën e adhurimit ndaj Allahut dhe e koncepton përgjegjësinë duke e kuptuar shkakun e ekzistencës, mund ta mbrojë nderin dhe famën e tij, madje mund të arrijë një shkallë më të lartë se engjëjt. Kur njeriu nuk e kryen detyrën e adhurimit dhe nuk e koncepton përgjegjësinë, bie në shkallën më të ulët. Kurani Fisnik njofton kështu për këtë gjendje:

“Pasha fikun dhe ullirin. Pasha malin e Sinait. Pasha këtë Qytet të sigurt (Mekën). Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer. Pastaj e çuam atë (që nuk beson) në gjendjen më të ulët.” (Isra, 70)

Allahu Teala e ka krijuar njeriun si krijesën më të përkryer nga aspekti i aftësive shpirtërore dhe fizike. I ka dhënë atij mendjen dhe vullnetin e lirë. Kur njeriu t’i përdorë këto aftësi ashtu siç ka urdhëruar Allahu, mund ta mbrojë fisnikërinë që ka në krijimin (natyrshmërinë) e tij. Kjo është rruga për t’u bërë një besimtar i përsosur. Në të kundërt, mund të zbresë në shkallën më të ulët të krijesave dhe gjallesave.

Ky përngjasim që bën Kurani Fisnik, nxjerr në pah qartësisht se ç’do të thotë një jetë, e cila nuk sistematizohet sipas urdhrave dhe ndalesave të Allahut.

“A e ke parë atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A mund ta mbrosh atë? Apo mendon se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si kafshë. Madje, ata janë edhe më të devijuar nga rruga e drejtë.” (Tin, 1-5)

Ata që nuk e njohin Zotin, që ua kthejnë shpinën të vërtetave, që nuk e kryejnë detyrën e adhurimit dhe vrapojnë pas

dëshirave vetjake, duke mos e pranuar mesazhin hyjnor, i cili u ka arritur, u janë përngjasuar kafshëve. Madje, në pjesën e dytë të ajetit 44, shprehet se këta njerëz janë më poshtë se kafshët, sepse kafshët i zbatojnë detyrat të cilat u janë dhënë në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre.

Jeta e njeriut është një jetë e mbushur plot përgjegjësi. Kjo jetë nuk i është dhënë atij pa ndonjë qëllim. Kjo jetë i është dhënë për ta njohur Allahun dhe për ta adhuruar Atë, ashtu siç shprehet edhe në ajetin fisnik:

“Unë i kam krijuar xhindët dhe njerëzit vetëm që të më adhurojnë.” (Furkan, 43-44) Koncepti i përgjegjësive i jep kuptim jetës së njeriut dhe e bën atë të lartë e të ndryshme nga ajo e gjallesave të tjera. Falënderimi që kërkohet nga njeriu si kundërvlerë për mundësitë dhe mirësitë e dhuruara, është detyra themelore e tij. Çfarë vlere mund të ketë jeta, nëse njeriu nuk falënderon, nuk e njeh Allahun Teala, i cili i ka dhënë mirësitë dhe nuk e kupton përgjegjësinë?

Çfarë ndryshimi ka nga gjallesat e tjera një njeri i tillë? Ajetet e mëposhtme shprehin se njeriu është krijesa që mbart përgjegjësinë ndërmjet të gjitha krijesave në këtë botë. Allahu i Lartmadhëruar, thotë:

“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Dharijat, 56) **“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!”** (Kijameh, 37)

Përgjegjësia është veçoria më themelore që i jep kuptim jetës së njeriut dhe që e bën të vlefshme atë. Për këtë arsye, njerëzit që nuk e kuptojnë përgjegjësinë dhe që i nënvlerësojnë detyrat e adhurimit, me të vërtetë konsiderohen njerëz që e kanë humbur vlerën dhe nderin njerëzor. Ata që neglizhojnë detyrat e tyre, që nuk bëjnë ibadet, që nuk binden dhe që nuk i kryejnë përgjegjësitë e tyre, ndoshta mund të shpëtojnë në këtë botë, por kurrë nuk mund të shpëtojnë nga dhënia e llogarisë në audiencën e Allahut Teala.

Ajetet e mësipërme e shprehin qartë këtë. Në një ajet tjetër të Kuranit Fisnik, shpjegohet se ata të cilët nuk e kuptojnë përgjegjësinë dhe i mbyllin veshët ndaj të vërtetave, janë në një gradë më të ulët se kafshët dhe se do të ndëshkohen:

“Ne kemi paracaktuar për Xhehenemin shumë xhindë dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, madje edhe më keq. Pikërisht këta janë të shkujdesurit.” (Mu'minin, 115)

Siç shikohet, një zemër që nuk e njeh Allahun, një sy që nuk i shikon dhe një vesh që nuk i dëgjon të vërtetat, largohet nga qëllimi i krijimit. Njeriu që i zotëron këto, e humb nderin për të qenë rob ndaj Allahut dhe privohet nga virtyti i të qenit njeri. Edhe krijesat e tjera të papërgjegjshme kanë veshë, zemër dhe sy. Njeriu nuk është ai që shikon, dëgjon dhe ndjen më mirë, por ajo që e bën të vlefshëm njeriun dhe që i jep kuptim zemrës, syrit e veshit të tij, është lidhja ndaj Zotit xhelle xhelaluh.

Jeta e njeriut bëhet e bukur me besim dhe me veprat e mira që e forcojnë atë. Kur një burrë shkoi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe e pyeti: “O i Dërguari i Allahut! Kush është njeriu më i mirë?” Pejgamberi (s.a.s.), iu përgjigj:

“Njeriu më i mirë është ai që ka jetë të gjatë dhe vepra të mira.”

Burri pyeti përsëri: “Kush është njeriu më i keq?” Pejgamberi (s.a.s.), iu përgjigj:

“Njeriu më i keq është ai që ka jetë të gjatë dhe vepra të këqija.” Domethënë se jeta, e cila është dhënë si amanet, zbukurohet dhe merr vlerë, së pari me besim, pastaj me veprat e mira, të cilat besimi i bën të domosdoshme.

Ne kemi nevojë për një llogaritje të thellë të vetes, duke u mbështetur në dritën e këtyre të dhënave. A e kemi zbukuruar me vepra të mira jetën që na është dhënë amanet? Me çfarë e kemi begatuar jetën? Çfarë kemi mbjellë në arën e jetës sonë? Nëse na thonë se sot do të fillojë udhëtimi dhe na pyesin se a jemi gati, çfarë kemi përgatitur për këtë? A e kemi të plotë namazin? A kemi zekat borxh? A i kemi hyrë në hak ndokujt? A janë të mjaftueshme punët që kemi në sandëkun e veprave që do të na shpjen në botën e përherëshme?

Dita e llogarisë po afron nga dita në ditë, ashtu siç shprehet edhe në ajetin fisnik: **“Po u afrohet njerëzve dita për të dhënë llogarinë, por ata vazhdojnë të jenë të shkujdesur e të shmangur (nga e vërteta).”** (Enbija, 1) A jemi gati për të dhënë llogarinë e jetës? Në mesazhin hyjnor të mëposhtëm shprehet qartë se në ditën e gjykimit, popujt do të pyeten nëse e kanë ndjekur apo jo rrugën e pejgamberëve? Ndërsa pejgamberët do të pyeten nëse e kanë kryer apo jo detyrën e predikimit. Allahu i Madhëruar thotë:

“Pa dyshim, Ne do të kërkojmë llogari prej popujve që u kemi çuar të dërguar e patjetër që do t’i pyesim edhe të Dërguarit.” (A'raf, 6)

Le të shikojmë jetën tonë, le të kontrollojmë adhurimet tona, le t’i shikojmë edhe një herë sjelljet dhe veprat tona. Sa i praktikojmë urdhrat e Kuranit dhe sunetin e Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem? A jemi përgatitur për provimin? A thua do ta kalojmë? Si do t’i japim përgjigje Allahut? A do të guxojmë t’i themi Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, se jemi munduar të veprojmë sipas sunetit në vartësi të besimit, fuqisë dhe sinqeritetit?

Ajeti i mëposhtëm na inkurajon, edhe nëse punën e kemi të mangët si besimtarë. Allahu i Madhëruar, thotë:

Thuaj: “O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahë, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.” (Zumer, 53)

Sipas një transmetimi të Hz. Enesit, një burrë erdhi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, dhe e pyeti: “Kur do të ndodhë kiameti?” Pejgamberi (s.a.s.), i tha: **“Çfarë ke përgatitur për kiametin?”** Burri u përgjigj: **“Unë dua Allahun dhe të Dërguarin e tij.”** Pastaj i Dërguari i Allahut, alejhisselam, i tha: **“Atëherë ti do të jesh bashkë me atë që do.”** Enesi, i cili transmeton këtë hadith, thotë: **“Nuk ka pasur gjë që na ka gëzuar më shumë se kjo fjalë e Pejgamberit, pasi kemi hyrë në Islam.”** (Muslim, Birr, 163)

Ky hadith na jep shumë shpresë. Madje, i ndan me ne ndjenjat e Hz. Enesit dhe na qetëson. Veprat i kemi të mangëta, durimin dhe rezistencën e kemi të pakët, adhurimet nuk i kemi të mjaftueshme, por ne e duam Pejgamberin, sallallahu alejhi ve sellem dhe po përjetojmë fatmirësinë e të qenit umet i tij. Lusim Allahun që ta lejojë Pejgamberin të ndërmjetësojë për ne dhe shpresojmë që të bëhemi fqinj me të në xhenet.

Një biografi tjetër për Profetin

I.

Ali ibn Ebu Talib (r.a.), e përshkroi Profetin (s.a.v.s.), në këtë mënyrë: “Ai nuk ishte vulgar, as nuk e falte vulgaritetin dhe nuk bërtiste në treg. Ai nuk e kthente të keqen me të keqe, por falte dhe nuk vinte re. Gjatë gjithë jetës, nuk qëlloi kënd me dorën e tij, përveçse kur luftonte në emër të Allahut. Nuk qëlloi kurrë shërbëtorin as gruan. Unë kurrë nuk e pashë të hakmerrëj për një padrejtësi që i shkaktohej, përveç rasteve kur shkeleshin ndalesat e Allahut. Nëse shkeleshin kufinj të Allahut, ai ishte nga më të zemëruarit. Sa herë i jepej mundësia të zgjidhte, zgjidhte më të lehtë. Kur hynte në shtëpi, ishte si çdo burrë; pastronte tunikën e tij, milte dhinë dhe shërbente vetë.

Ai e përmbante gjuhën nga çfarë nuk i interesonte. I afronte njerëzit dhe nuk u rrinte larg. Ai e nderonte njeriun e fisëm dhe i besonte përgjegjësi. Ishte i matur me njerëzit dhe frenohej para tyre, por nuk e kursente buzëqeshjen e ngrohtë apo sjelljen e duhur. Ai interesohet për shokët e tij dhe pyeste njerëzit për ta. E përkrahte të mirën, e përmirësonte atë dhe i kundërvihet së keqes. Ishte i qetë dhe i qëndrueshëm. Nuk ishte kurrë i shkujdesur, që njerëzit të mos mësoheshin të shkujdesur dhe të bëheshin mospërfillës. Ishte i përgatitur për çdo rast dhe kurrë nuk i mungonte drejtësia, as nuk e tepronte. Më pranë tij qëndronin njerëzit më të mirë dhe, njerëzit më të mirë në sytë e tij, ishin më të kuptueshmit në këshillë. Më i larti mes tyre ishte më i kujdesshmi me të tjerët dhe ai që i ndihmonte njerëzit. Sa herë ulej apo ngrihej, lëvdonte Zotin. Nëse shkonte në një kuvend, ulej në fund të grupit (dhe jo në krye) dhe kështu i nxiste njerëzit. Çdokujt që ulej pranë tij, i jepte vëmendje, aq sa secili prej tyre ndihej se askush nuk ishte më i rëndësishëm se ai, për Profetin. Nëse vinte dikush të ulej pranë tij apo t’i kërkonte një nder, ai ishte i durueshëm dhe qëndronte me të, derisa miku të largohej. Kushdo që vinte me një kërkesë ndaj tij, kthehej me çfarë kishte kërkuar ose me një fjalë të përzemërt. Gazmendi dhe sjellja e tij e mirë i kishte pushtuar të gjithë, saqë ai u bë si një baba për ta dhe

të gjithë fituan të drejta të barabarta. Kuvendet e tij ishin kuvende dijeje, përunjësie, durimi dhe fisnikërie. Aty nuk ngrihej zëri, as nuk shkeleshin ndalesat. Ai nuk i vinte në dukje gabimet e të tjerëve, por nuk reshtte së këshilluari frikën ndaj Zotit. Gjatë këtyre kuvendeve, respektoheshin të thyerit në moshë, fëmijëve u falej mëshirë, u jepej përparësi atyre që ishin më ngushtë dhe mbroheshin të huajt.”

Ai vijon: “Ishte gjithmonë i buzëqeshur, miqësor në sjellje, i butë në natyrë. Ai nuk ishte i vrazhdë, i pashpirt, i zhurmshëm, shfrytëzues apo dorështrënguar. Çdo gjë që nuk i pëlqente, nuk e përfillte dhe askush nuk u dëshpërua ndonjëherë prej tij. Asnjëherë nuk iu përgjigjej nënçmimit apo fjalëve të ulëta. Ai ia kishte ndaluar vetes tri gjëra: debatin, mendjemadhësinë dhe atë që nuk i takonte. Nga tri gjëra i lehtësoi njerëzit: nuk diskreditonte askënd as nuk i fyente, nuk gjurmonte nderin apo çështjet e tyre private dhe fliste vetëm në rastet kur shpresonte se do të shpërblehej. Kur fliste, pjesëmarrësit i ulnin kokat si t’u ishin ulur zogj mbi supe. Kur ai mbaronte, ata flisnin. Ata nuk haheshin për fjalën me njëri-tjetrin në prani të tij, por, kur dikush fliste, e dëgjonin deri sa të mbaronte. Në prani të tij, fliste i pari i tyre. Qeshte me njerëzit dhe shprehte habi. Kishte durim me të panjohurit, kur flisnin ashpër dhe kërkonin shumë, aq sa shokët e tij do t’i qëllonin. Ai thoshte: “Nëse shihni ngushtë ndokënd, silleni tek unë. Pranonte lëvdatë vetëm prej njerëzve të matur dhe të përmbajtur. Nuk ndërkalte të folmen e tjetrit, nëse nuk mëkatonte, për çka ai mund t’i qortonte apo mund të largohej. Ai ishte më zemërgjeri, më fjalëdrejti, më i buti dhe fisniku në marrëdhënie. Ai që e shihte për herë të parë, i frikësohej, ndërsa ai që shoqërohej me të, e donte. Ata që e përshkruajnë, thonë: “Nuk kam parë kurrë më parë apo më pas një njeri të ngjashëm me të, paqja qoftë mbi të.”



II.

Nën ndikimin e kësaj biografie karakteriale të Profetit, unë mund ta përfytyroj atë si një njeri që ec mbi vezë dhe kujdeset që të mos thyejë asnjë syresh. Mund të thirren në ndihmë shumë virtyte dhe vlera të larta morale për të përmbledhur më besnikërisht këtë përshkrim mallëngjyes të Aliut për Profetin dhe secili prej tyre do të ishte me vend. Por vetëm një prej tyre do të ishte i mjaftë: vetëpërbajtja. Kurdo që kishte një gëzim, një ngjarje të pakëndshme, një rrezik apo një kuvend miqësor, ai festonte, trishtohej, përgatitej apo bisedonte, duke qenë i bindur se ajo që po bënte ishte një gjë e drejtë dhe e dashur për Zotin. Mund ta përfytyrojmë Profetin që mendohet mirë përpara se të hedhë një hap, përpara se të marrë një drejtim, para se të flasë apo të gjykojë. Por nuk mund ta përfytyrojmë Profetin me durim të humbur, në mes të panikut, në histeri apo në akte, për të cilat më pas duhej të ndjente keqardhje. Kësisoj mund të kuptojmë se misioni i tij ishte i rëndësishëm dhe një mision serioz mund të përmbushje vetëm me maturi.

Megjithatë, shumëkush mund ta keqkuptojë vetëpërbajtjen dhe maturinë e Profetit. Mbi këtë argument, Lindjes i mvishet tipari i mefshtësisë, dembelizmit dhe prapambetjes. Ndërkaq, me konkurrencën dhe ndryshimin e pandërprerë në thelb të tij, qytetërimi modern dhe mënyra bashkëkohore e jetesës ngjajnë, në një këndvështrim, si sipëror ndaj asaj letargjie orientale. Është e vërtetë se fati i Islamit u themelua si një qytetërim i qëndrueshëm, në komunitetin e ngulitur të Medinës. Është kaq e vërtetë, gjithashtu, se mënyra moderne e jetesës në qytetërimin judeo-kristian pikëniset në fatin e pasigurt dhe të paqëndrueshëm të hebrenjve në shkretëtirë. Por kjo nuk do të thotë aspak se dinamizmi dhe arratia nga boshti i traditës të përbëjë një avantazh ndaj maturisë dhe natyrës qëndrësore të Islamit.

Për gjithkënd që mund të keqkuptojë vetëpërbajtjen e aktualizuar të Profetit dhe atë të priturën nga çdo mysliman, është e dobishme të përpiqet të rrokë pozitën qendrore të Zotit në mendimin dhe veprimin e Muhamedit dhe çdo pjesëtarit të bashkësisë së tij. Veprimi dhe mosveprimi i tij përcaktohej nga vetëdija mbi vështrimin e plotë hyjnor dhe bindja se përgjegjësia para të Gjithëditurit në Ditën e Gjykimit nuk është aspak e lehtë, as e shmangshme.

Vetëdija dhe bindja e tillë përcaktonin plotësisht qëndrimin dhe veprimin e Profetit dhe ai, kësisoj, i jepte Islamit, përmes rolit qendror të modelit të tij, një natyrë evolutive, e jo revolute. Ndryshimi përmes transformimit gradual dhe organik të institucioneve dhe elementëve të shoqërisë njerëzore dhe jo përmes përplasjes me to apo thyerjes së tyre, ishte metoda e vënë në veprim nga Islami. Kjo metodë nuk u zgjodh as rastësisht, as për shkak të pamundësisë së përbalimit të alternativës së përplasjes. Nëse kjo do të ishte e vërtetë, atëherë Profeti dhe komuniteti i besimtarëve do të ishin lirisht të ashpër dhe arrogantë me pakicën hebraike të Medinës, apo me popullsinë, dikur persekutuese e tashmë të nënshtruar, të qytetit të Me-

kës në çastin e çlirimit. Kësisoj, qëndrimin dhe veprimin e Profetit nuk e kishte përcaktuar asnjëherë qëndrimi apo veprimi i subjektit ndaj tij personalisht, por vetëm vetëdija mbi shikimin vigjilent të Qiellit.

Ndoshta një njohje e vërtetë dhe e pakomprometuar e Profetit do t'i ndihmonte njerëzit që të ndërtonin një klimë më të qëndrueshme mirëbesimi dhe pajtimi. Me gjasë, botës do t'i ishin kursyer disa shfaqje cinike të arrogancës dhe shpotisë ndaj myslimanëve dhe po aq shpërthime historike të irritimit të vetë myslimanëve në reagimin ndaj tyre. Prapëseprapë, të paktën myslimanët do të kishin dhënë kontributin e tyre përmes një reagimi të matur dhe të vetëpërbajtur ndaj tyre. Askush nuk mund të thotë se karikaturimi i profilit të Profetit është një akt naiv dhe që vjen nga padija: ky do të ishte një argument tërësisht i papranueshëm. Ndërsa nga ana tjetër, duket se arenën e kësaj ndeshjeje të paqytetëruar dhe të pakulturoar e ofron në mënyrë naive vetë bota islame. Respekti duhet merituar. Nëse të tjerët nuk na respektojnë, kjo nuk do të thotë se ne nuk kemi mundur t'i detyrojmë të tjerët të bëjnë kështu. E kundërta, nëse të tjerët nuk na respektojnë, ne nuk kemi mundur t'i bindim ata se ne jemi dinjitozë.

Modeli i Profetit duhet të kuptohet në dritën e statusit të tij, si mëkëmbës i Zotit (*khalifetu'Llah*) në tokë. Si mëkëmbës, ai duhet të përfaqësonte dhe reflektonte Cilësitë e Larta Hyjnore në marrëdhënie me komunitetin e njerëzve dhe mjedisin natyror, ku drejtësia garanton një pozitë të mesme të paprekur. Ndërkaq, përfaqësuesi i Zotit duhet të kujdeset për rendin në tokë, për mirëqenien e krijesave dhe për ruajtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore. Misioni i tij nuk është të mbrojë dhe garantojë të drejtat e tij personale, por të përpiqet që të sjellë në Qiell një rekord të mirë.

III.

Ndërsa lexon se si e kujton Profetin një nga njerëzit që e kanë njohur më mirë atë, bindesh se mizëria e frikërave, vuajtjeve dhe pakënaqësisë së njeriut të sotëm, mysliman apo jo, besimtar apo ateist, buron nga baltovina e karakterit të keq. Një qasje e përmbysur, sipas së cilës mirëqenia njerëzore nis me kërkimin e të drejtave dhe jo me përmbushjen e detyrimeve, i ka shformuar karakteret e njerëzve. Përfundimi mund të merret me mend: askush nuk merr atë që i takon, sepse askush nuk ka përmbushur detyrimin që ka ndaj tjetrit; sepse askush nuk mendon të japë atë që mundet për botën.

Siguria mbi pasojat është një parakusht i domosdoshëm për veprimin e patensionuar. Profeti ishte i bindur se Zoti është i gjithëpranishëm përmes gjithëveprimit në kozmos, në jetë. Nisur që këtej, ai nuk kishte ndonjë brengë mbi të ardhmen, duke qenë i patundur në besimin e tij mbi rolin hyjnor në skenën e historisë. Sakaq, Profeti ndërroi jetë, por gjithëprania hyjnore përmes gjithëveprimit, nuk reshti së përcaktuari kahjen dhe pasojat e zhvillimeve në shoqërinë njerëzore. Prandaj, i këtitillë duhet të jetë edhe qëndrimi i besimtarit mysliman, pjesëtarit të *umetit*, bashkësisë së themeluar nga vetë Profeti (a.s.). Ky duhet të jetë edhe kuptimi i jetërrëfimit të Profetit: të jetë modeli i myslimanit.



Dija e transmetuar dhe urtësia

Edison Çeraj

“Atij njeriu që Zoti ia do të mirën, ia bën të mundur të kuptuarit e fesë.”

Profeti Muhamed

Kjo thënie e Profetit (bekimet e Zotit qofshin mbi të!) shfaqet si mjaft e rëndësishme në një kohë kur myslimanët janë të mbërthyer nga dija e transmetuar/përcjellë, duke u bazuar kryesisht vetëm te kjo lloj dijeje; duke mbyllur dyert e përsiatjes dhe kuptimit vetjak¹; duke ia mbivendosur atë pothuajse çdo gjendjeje e çdo çështjeje, pa marrë parasysh kontekstin e ndryshëm me tipare e karakteristika të tjera prej nga vjen apo ku është aktualizuar një dije e caktuar e transmetuar, qoftë edhe kur është universale.

Në fakt, me sa duket sheshazi, kjo është gjendja edhe e Perëndimit sot - me rrënjë në Rilindje - sidomos pas shekullit XVIII.

Pa mëdyshje që, një nga mjetet kyç e më përcaktues për mbizotërimin e dijes së transmetuar kudo në botë është arsimiti, i cili sa vjen e merr një fizionomi përherë e më teknike (po aq edhe procedurale), duke i shkuar nga pas me përlujtje të thellë një *pragmatizmi të ri*, me lëvizhje të re, por sigurisht, me bërthamën e vjetër, që është pikërisht ideja e “parajsës tokësore”, e cila rrjedh nga doktrina hebraike dhe, për rrjedhojë, çifutët besojnë se parajsa është këtu në tokë; duhet vetëm të përshpejtohet (me çdo mënyrë e mjet, mjafton që t’i shërbejë qëllimit) ndërtimi i saj. Pra, nga universitetet sot dalin përherë e më shumë të ashtuquajtur ekspertë dhe specialistë, të cilët janë të detyruar

1. Çdo të kuptuari duhet t’i paraprijë një përsiatje sa më e thellë, në mënyrë që përfitim i të kuptuarit apo i një kuptimësie të jetë sa më afër të vërtetës së synuar.

të ushtrojnë vetëm atë “dije” për të cilën janë profilizuar (skajshëm). Zakonisht, njerëzve të tillë ua kanë mbushur mendjen e po aq ia kanë mbushur edhe ata vetes, se nuk marrin vesh nga asnjë fushë a drejtim tjetër përveç atij të cilin e kanë të damkosur në një karton që luan rolin e një gardiani të zellshëm për t’i mbajtur brenda katër mureve të profesionit.

Kur Profeti thotë: “Atij që Zoti ia do të mirën...”, nënkuptojmë qartazi se kemi të bëjmë me një njeri të zgjedhur, të caktuar, meritore për një favor kaq themelor. Është e kuptueshme se njerëz të tillë janë të zgjedhur nga Zoti për këtë begati, pasi në qenien e tyre ekzistojnë disa cilësi që i bëjnë meritore e për pasojë, të hapur për këtë dhunti. Pa dyshim që cilësia kryesore e kësaj kategorie njerëzish mbetet sinqeriteti i tyre në raport me Zotin, por edhe në raport me kërkimin e asaj dijeje, që të jep mundësinë drejt një njohjeje sa më të qenësishme të Zotit; ngaqë vetëm njohja e Zotit nënkupton drejtpërdrejt njohje të vetvetes. Pra, fati i qenies është i lidhur përfundimisht me Qenien, nëse do perifrasonim Heidegger-in. Për këtë, dëshmojnë shumë vargje të Kuranit e shumë thënie të Profetit.

Gjithashtu, nga kjo thënie kuptojmë se rëndësia e dijes nuk qëndron te mësimi i saj përmendsh (ose memorizimi), por te mënyra se sa dhe si e kemi kuptuar dijen që zotërojmë, qoftë ajo edhe e pakët. Pra, çështja e madhe është urtësia.

Ky është një raport ndërmjet qasjes sasiore dhe asaj

cilësore, ku mësimi përmendsh ka gjithnjë prirje sasiore, kurse përpjekja që bëjmë për ta kuptuar sa më drejt një dije të caktuar, është një qasje cilësore ndaj saj.

Në pjesën e dytë të thënies së tij, Profeti thotë: "...ia bën të mundur të kuptuarit e fesë". Dhuntia për të kuptuar - në këtë rast Kurani dhe Sunetin, por edhe tekste të tjera, që mund t'i emërtojmë si përpjekja njerëzore drejt së Vërtetës - është si dhuntia për të shkruar poezi; që do të thotë se kjo, në thelb, nuk varet nga njeriu. Ashtu sikurse poeti që nuk mund të shkruajë poezi atëherë kur do, por kur i vjen/zbret frymëzimi, ashtu edhe një njeri i dijes nuk mund ta kuptojë një gjë, vetëm se atëherë kur i vjen/zbret kuptimi i saj. Fjala vjen, mund të ndodhë që ta lexosh me dhjetëra herë një varg nga Kurani apo një hadith të Profetit e të mos e kuptosh, të mos i japësh një kuptim që të qetëson. Ndoshta vetëm në një çast apo kohë të caktuar, kur mbase edhe nuk e pret, mund të të kthjellohet çdo gjë nga një përndritje e beftë së brendshmi. Kemi të bëjmë me një realitet që ka pushtet mbi ne e jo e kundërta.

Edhe gjatë ligjëratës së "haxhit të lamtumirës" kemi një porosi vërtet themelore, e cila qëndron në të njëjtën hulli me thënien që po interpretojmë, madje shfaqen si plotësuese të njëra-tjetrës në rrafsh semantik, ku, ndër të tjera, Profeti u thotë të pranishmëve: "Përcillen këtu që po ju them sot, se mbase ata që do të vijin pas jush do e kuptojnë më mirë se ju."

Kjo është një nga dëshmitë që të kuptuarit e teksteve apo e një dukurie të caktuar qenësore nuk është ekskluzivitet i askujt.

Në librin *Shkencë e kozmosit, shkencë e shpirtit*, William Chittick-u shkruan:

"Të kuptuarit intelektual, nëse flasim përpiktazi, gjendet në kulmin më të lartë të vetvetes njerëzore, pra, në atë që filozofët e quajnë "intelekti i mirëfilltë". Kur të kuptuarit e tillë e lë sferën e inteligjencës së kulluar dhe zbret në nivelin e mendimit dhe gjuhës, kemi të bëjmë me shprehjen e tij, që do të jetë gjithnjë e mangët. Si fillim, të shprehurit përbën thjesht dije të transmetuar, jo të kuptuarit e vërtetë. Prapëseprapë, ende mund të çmojmë faktin se, në Islam dhe traditat e tjera, është bërë gjithnjë dallimi mes këtyre dy llojeve të dijes.

Tradita intelektuale në Islam ka shtjelluar katër tema bazë: Zotin, kozmosin, shpirtin njerëzor e marrëdhëniet ndërvetjake. Tri të parat janë përbërëset themelore të realitetit që përndijojmë, ndërsa e katërta i zbaton tejmshtrimet e arritura nga studimi i tyre në sferën e veprimtarisë njerëzore. Sigurisht, për të gjitha këto tema mund të lexosh në burimet autoritative të dijes së transmetuar, si Kurani e Hadithi, por t'i njohësh vetë është krejt çështje tjetër. Për traditën intelektuale, dija e transmetuar luan rolin e shigjetave treguese drejt një të kuptuari që duhet aktualizuar dhe realizuar nga vetë kërkuesi.

Ndoshta, mënyra më e mirë për ta kuptuar dallimin ndërmjet dijes së transmetuar dhe intelektuales është që të thellohem mbi dallimin ndërmjet "imitimit" ose "ndjekjes së autoritetit" (*taklid*) dhe "realizimit" ose "vërtetësimin"

(*tahkik*), terma këto që tregojnë dy rrugë bazë për arritjen e dijes. Për të qenë pjesëtar i cilësdo feje, kulture, shoqërie a grupi, duhet të mësoh nga pjesëtarët e tyre dhe ky proces i të mësuarit vazhdon përmes "imitimit". Kështu e mësojmë gjuhën dhe kulturën, pa përmendur shkrimet e shenjta, rritualet dhe ligjet. Në kontekstin islam, ata që kanë marrë përsipër përgjegjësinë e ruajtjes së trashëgimisë së transmetuar quhen 'ulema, pra "njohës" të traditës."²

Siç e vëmë re edhe në këto radhë të Chittick-ut, dija e transmetuar duhet t'i paraprijë dijes intelektuale ose të kuptuarit vetjak, përmes përsiatjes e reflektimit e jo ta ndryjë atë.

Kështu që, nuk ka asnjë mospërputhje a kontradiktë në këtë mes; jemi ne ata që bëhemi shkak për rrjedhja kontradiktore ndërmjet këtyre dy botëve, pra dijes së transmetuar (e mësuar përmendsh) dhe të kuptuarit të saj (urtësisë).

Duhet theksuar se këtu po bëjmë fjalë për atë dije intelektuale dhe për atë të kuptuar vetjak, që merr shkas nga ato tekste për të cilat nuk ka një mendim unanim te dijetarët dhe mendimtarët e njohur apo për ato tekste për të cilat nuk është dhënë aq sa duhet shpjegim ose për ato tekste që kërkojnë/imponojnë një kuptim shtesë, krahas kuptimit të tyre fillestar, që mund të ketë shërbyer në një kohë dhe hapësirë të caktuar apo për ato çështje/dukuri të cilat nuk kanë ekzistuar kohë më parë e kështu me radhë.

Duhet theksuar gjithashtu se, kjo hapësirë është domen i atyre individëve të cilët kanë si preokupim të vazhdueshëm dijen dhe përsiatjen mbi të dhe nuk ka aspak rëndësi se si mund të quhen këta individë; se cilit rang social i përkasin; se a janë të arsimuar apo jo; madje, në disa raste nuk ka rëndësi edhe se cilit botëkuptim apo fe i përkasin; sepse në thënien e Profetit në krye të këtij shkrimi, nuk përmendet asnjë lloj ngjyrimi e specifike që duhet të ketë njeriu që mund të gëzojë dhuntinë e të kuptuarit. Profeti e thotë fare thjesht: "Atij njeriu që Zoti ia do të mirën, ia bën të mundur të kuptuarit e fesë."

Kështu, tani kemi mbërritur në dy përfundime, që mendojmë se janë të rëndësishme:

1. Dija e transmetuar (Zbulesa: Kurani dhe Suneti) është ajo që i paraprin dijes intelektuale dhe të kuptuarit vetjak, i cili mund të pasurohet duke studiuar tekstet dhe duke përsiatur në mënyrë të pavarur.

2. Për sa më sipër, duhet bërë dallimi ndërmjet dijes dhe urtësisë, për të cilën bën fjalë edhe hadithi i Profetit në krye; pasi, "të kuptuarit e fesë" është pikërisht urtësia, e cila në thelb mbetet dhunti dhe nuk mund të fitohet as përmes kërkimit të dijes e as me ndonjë formë tjetër.

Ata të cilët mjaftohen vetëm me dijen e transmetuar, pa kërkuar kuptimin dhe aktualizimin e saj përmes urtësisë, mbeten jashtë kohës në të cilën jetojnë. Ndërsa, ata që mjaftohen vetëm me urtësinë vetjake apo të dikujt tjetër, jetojnë në një botë utopike, pasi kanë hequr dorë nga Burimi i urtësisë.

2. Chittick, W. (2011) *Shkencë e kozmosit, shkencë e shpirtit*. Përkth.: Edin Q. Lohja. Tiranë: Botimet "Eneas".



Imam Muhamed Sytari
Mifti i Zonës Shkodër

H. VEHBI SULEJMAN GAVOÇI

dijetari që nderon një komb, një ymet...

Resulull-llahi (a.s.) na kujton se: "Shembulli i dijetarëve në tokë, është si shembulli i yjeve në qiell, njerëzit udhëzohen me ta në errësirat e tokës dhe të detit. Kur të fiken yjet, kërkuesit e udhëzimit, mund të humbasin rrugën".

(Imam Ahmedi, nga Hasani (r.a.). Shih: Imam Sujuti, "El xhamius-sagir", hadithi nr. 2441.)

Nuk është e lehtë të përkufizosh personalitetin e shquar të dijetarit të madh, H. Vehbi Sulejman Gavoçi, vepra dhe misioni i të cilit nderon një komb, një ymet.

Ai është përkufizuar si një dijetar me "një ndikim shumë të mirë te studentët e dijes, të cilët mbajnë për të, në zemrat e tyre, dashurinë dhe nderimin, për të mirat që u jep, materialisht dhe moralisht, duke dhënë në këtë mënyrë imazhin e shembullit të lartë e të mirë, për të gjithë ata që e duan dhe bashkëpunojnë me të, sepse dijetari punëtor është shembull në këtë kohë, që fjalët janë shtuar dhe punët janë pakësuar", siç do të shkruante kryemyftiu i Sirisë Dr. Ahmed Keftaro.

Hoxha ynë, është lindur në Shkodër, në qershor të vitit 1923. Ai është brumosur me besimin, kulturën dhe qytetarinë e të atit, për të cilin kujton: "Prej sifateve të mira që ka pasë baba, pastë rahmet, ka qenë mbështetja në veten e tij gjithmonë! Nuk ka qenë hoxhë, që përkëdhel pasanikët apo që afrohet me zyrtarët. Kurrë nuk ka treguar se ka nevojë për dikë. Ndoshta e ka ngrënë bukën thatë, ka punuar si punëtorët, mirëpo kurrë s'e ka ulur kokën para kujt. Ka qenë me çallmë, me mjekër, ka qenë imam dhe hatib...

Ka besuar se Zoti të jep, ndërsa robi është i shtrenjtë dhe nuk të jep, vetëm nëse e ka caktuar Zoti (xh.sh.).

Kemi mësuar prej tij me qenë të saktë! Nuk e di se baba jonë na ka gënjyer ndonjëherë, ose ka gënjyer dikë, ose dikush thotë se ai po gënjen. Kemi mësuar prej tij djegien e zemrës dhe shpirtit, për të mësuar hallkun..."

Hoxha i nderuar, emigroi nga vendlindja në moshën 14-vjeçare, për arsye politike dhe për faktin se i ati kishte vënë re se Shqipëria po largohej dita-ditës nga feja dhe besimi.

Në vitin 1947, pas 10 viteve studime akademike në më të mirin universitet islam të botës, në atë kohë, "Ez'herin Sherif", Hoxha u kthye në Damask, prej ku nisi një rrugë të gjatë në mësimin e njerëzve, në përhapjen e mesazheve të harmonisë, besimit dhe ruajtjes së dinjitetit njerëzor, me frikën e Zotit para syve!

Në aktivitetin e tij fetar, ndonëse larg Shqipërisë dhe Shkodrës, ai asnjëherë nuk e harroi origjinën e tij, as e shiti atë, as punoi për të mirën e vendit të tij për interesa materiale personale.

Shkruan: "Ndër artikujt e parë që kam shkruar është edhe "Asal-xhenneh" - (**Shkopi i xhenetit**), ku kam shkruar për Shqipërinë, vuajtjet që keni pësuar ju, vëllezërit e mi, pas vitit 1944. I pari artikull imi ka qenë për ju, për vendin tim..."

Ylli i dijes së zotërisë sonë Vehbi S. Gavoçi, do të shndriste përherë e më shumë në botën islame, që me botimin e librave të parë, ku vetëm: "Femra myslimane", do të ribotohej 14 herë në shumë shtete arabe islame. Ai do të pasonte me botimin e mbi 20 veprave origjinale në gjuhën arabe, redaktimin, studimin dhe verifikimin shkencor të dhjetra veprave të kolegëve të tij dijetarë, si dhe në botën islame shqipfolëse, me rreth 30 tituj librash të botuar në Shkodër, Prishtinë, Shkup, Tiranë etj.

Kudo, në librat e Hirësisë së Tij, pas mbiemrit shënohet edhe llagepi: "El-Albani", dmth, shqiptari, sepse ai ka besuar dhe

beson se ky vend i ka rrënjët e thella në Islam dhe se asnjëherë nuk duhet të ndalemi nga angazhimi për të nxjerrë në pah kulturën, forcën e traditave dhe shpirtin islam tek shqiptarët!

Me dijen dhe përkushtimin e tij, Hoxha i madh i Shkodrës, i Shqipërisë dhe i mbarë ymetit islam, ka fituar një respekt të pashoq në mesin e dijetarëve, besimtarëve dhe pasuesve të shumtë të mësimeve të tij.

Në verën e vitit 2001, kam qenë dëshmitar i një skene respekti dhe nderimi ndaj personalitetit të tij... Dijetari i njohur islam Dr. Beshir El-Bani, i puthte dorën, duke i thënë: "Ti je hoxha dhe mësuesi ynë"! (Dijetari në fjalë, asokohe i kishte kaluar të 90-at).

Ai është dijetari, për të cilin, dijetari i madh Shejkh Abdulfettah Ebu Guddah, shkruan: "Profesor Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi, Allahu e ruajtë dhe përfitoftë njerëzia dhe vendet e botës nga dija dhe mirësia e tij!"

Ai është këshilluesi i pashoq, për të cilin dijetari i shquar Dr. Mustafal-Khan, shkruan: "Nuk kam parë në të, vetëm se burrin e mirë, këshillues dhe thirrës në rrugë të Allahut, me dije, udhëzim e këshillë..."

Ai është mbrojtës i të vërtetave hyjnore, për të cilin mendimtari i shquar Dr. Said El-Buti shkruan: "Sot e konsideroj si njërin ndër më të zgjedhurit që përfaqëson, me besimin, moralin, ruajtjen dhe sjelljen e tij, traditën e të parëve tanë të ndershëm, duke marrë parasysh edhe jetën e tij shkencore me botimet e shumta në ruajtje të së vërtetës".

Ai është njohësi i mirë i jetës dhe veprës së Resulull-llahit (a.s.), për të cilin ish-kryemyftiu i Kosovës, Dr. Rexhep Boja, dëshmon: "Gjithmonë i qetë dhe i gatshëm që kurdoherë t'i ndihmojë të tjerët, shumë studentëve të interesuar u mbante ligjëratat plotësuese në Xhami të Pejgamberit, nga lënda e Sires.

Po në këtë qytet, kurdo që lajmërohej për ndonjë ligjërim të Shejkh Vehbiut, edhe salla më e madhe nuk mund t'i pranonte të gjithë të interesuarit..."

Ai është njeriu me zemër të madhe, që nuk e harroi asnjëherë vendin e tij, për të cilin dëshmohej se: "Sa herë që mblihdemi me të e diskutojmë për gjendjen në Shqipëri pas vitit 1997, profesori vetëm qan për atë gjendje të keqe të vendit tonë..."

Ai është shkolla e njerëzve të mirë, me kontribute për shoqërinë e tyre, kudo në botë, për të cilin, Thirrësi Islam shqiptar me banim në Amerikë, z. Burhanuddin Fili, shkruan: "Kudo në Washington, Virxhinia, Florida, Kaliforni, Miçigan, e vende të tjera ku kam qenë, kam takuar studentë të H. Vehbi Gavoçit me grada shoqërore, që edhe sot e kësaj dite e ruajnë me krenari ndikimin e atij zotërie në formimin e tyre njerëzor, duke ia kushtuar atij udhëzimin e tyre në jetë..."

Ai është dijetari-bamirës, për të cilin Imam Vehbi Ismaili (rahmet pastë!) shkruan: "Kur u lirua Shqipëria, ai qe ndër të parët që shkroi shumë libra në gjuhën shqipe, libra të cilët ai i shpërndante falas. Me sa di unë, ky ishte i vetmi me Hafiz Ibrahim Dalliu, që i shpërndante librat falas. Haxhi Vehbiu është Alim-Amil, që nderon me veprat, dijen dhe moralin e tij fenë islame dhe kombin shqiptar."

Ai është H. Vehbi Sulejman Gavoçi, sot edhe "Qytetar Nderi" i Shkodrës.

Ai është i pari që mendoi se ky vend ka nevojë për teologë të rinj, studiues të thelluar në fenë islame, që të ndihmojnë në rimëkëmbjen e Thirrjes Islame, pas kolerës komuniste, që e konsideronte si një "kryqëzatë famëkeqe" kundër Islamit

dhe myslimanëve në Shqipëri, që e shkatërroi vendin dhe shpirtin e tij.

Në letrën e parë që na dërgonte, kur sapo kishim shkuar për studime në Damask, para 19 viteve, Hoxha na shkruante dhe na këshillonte:

"Më falni për vonesën në shkrimin e kësaj letre, pasi isha në Umre dhe vetëm dje filluan mësime tek ne.

...

Unë kërkoj prej jush të duroni, se jeta ka vështirësi e heqje, por ta dini se me durim, e liga kalon. Unë personalisht, kam kaluar ditët e studimeve në Misir, me bukën thatë. Të tjerët kanë kaluar edhe më keq, po unë ju këshilloj të lexoni librin: "Safahatun min sabril-ulema"¹, ku do të shihni se si kanë duruar dijetarët dhe si kanë vuajtur në rrugën e kërkimit të dijes.

...

Dijeni mirë se ju po mësoheni për t'u bërë trashëgimtarët e Profetit (a.s.), d.m.th, po punoni për një gradë më të lartë se çdo gradë e leximeve të tjera. E mira për ju është e përkufizuar.

Përfitoni prej kohës dhe rinisë, sa të mundeni, se koha nuk kthehet dhe rasti nuk vjen përherë! E di shumë mirë se largimi nga familja është shumë i zorshtëm, por kur të ktheheni Ulema, është për të mirë se ktheheni me dije, ndërkohë që dikush tjetër kthehet me pak të holla.

Ndoshta shpresa dhe imagjinata për një jetë të lehtë e të kollajtë nuk ju plotësohet, por duroni, se kur të shijoni ëmbëlsinë e mësimit, gjithçka do t'ju vijë e lehtë dhe e dashur, insha'All-llah.

...

Merruni me studime sa të keni mundësi, se vetëm me dije dhe vetëm me të i bëjmë nder vetes, familjes e krejt popullit...

Hoxha ynë i dashur, është pa dyshim një ajet mëshire dhe mirësie, që vërteton se kjo tokë dhe ky vend i ka rrënjët e forta në Islam dhe se bijtë e tij duhet të ndihen krenarë dhe kryelartë me shembullin e Hirësisë së Tij, para gjithkujt!

Ai është një shembull i pashoq i modestisë, i përluljes dhe marrëdhënies korrekte me Zotin. Si të thuash, ai është personifikim i thënies së njohur: "Zoti im, Ti je qëllimi im dhe pëlqimi Yt është kërkesa ime!"

Në një letër, disa ditë para botimit të monografisë sime mbi jetën e tij, në maj, 2004 (*për të cilën ai nuk ka pasur dëshirë*), më shkruan: "Un nuk interesohem me u dukë e me pasë fotografina rastesh... Un jam model i vjetër, nuk më pëlqejnë zhurma, as fotografija...!"

Këshilloj përherë: Mos më lavdëroni, mos m' zmadhoni se unë vërtet jam i vogël. Perëndia më ka përdorë si qole t' Tij dhe mburrem se jam qole e Tij (xh.xh.)..."

Allahut (xh.sh.), i lutem t'i japë jetë të gjatë e shëndet të plotë Hoxhës sonë, që ta kemi përherë si një busull orientimi dhe një mbështetje shpirtërore në punën tonë dhe përpjekjet e sinqerta në shërbim të Thirrjes Islame.

Allahu (xh.sh.), e shpërbleftë për përkujdesjen e tij ndaj nesh dhe vullnetin e mirë për të kërkuar më të mirën për ne dhe studimet tona.

E dua Lejlanë sa të jem i gjallë e, nëse vdes, dikë do të lë, Lejlanë ta dojë pasi të kem vdekur!²

1. "Faqe nga durimi i Ulemave", i autorit dhe dijetarit Abdul Fettah Ebu Guddah.

2. Shejkh Zijad M. Humejdan, "Nibrasu da'vetin ve menaru hidaje", fq. 59



Muhamedi (a.s.) dhe shoqëria e mëshirës

Prof. dr. Ezhder Okumush

*S*hoqëria e injorancës, para ardhjes së islamit, ishte një shoqëri në të cilën dominonin taditat e injorancës, morali i keq dhe dhuna ndaj gruas, të varfrit, të skamurit e të shtypurit. Kriteri i së drejtës në shoqërinë nga e cila doli Hz. Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem dhe në të cilën u shpall si Pejgamber, ishte të qenët i fortë dhe i pasur.

Nisur nga kjo, nëse ishe i fortë, ishe i drejtë, nëse ishe i dobët, ishe i padrejtë. Aktorët që kishin në dorë fuqinë, nuk njihnin kufij në çështjen e shtypjes së të dobëtve. Ua merrnin mallrat të huajve, por nuk ua jepnin paratë. Fëmijët dhe gratë nuk kishin ndonjë vlerë. Gratë poshtë-roheshin dhe fëmijët vajza, varroseshin të gjalla në tokë me vendimin e babait.

Adhurimi i idhujve dhe politeizmi ishin shumë të përhapur dhe të imponuar. Nuk toleroheshin besimet, mendimet dhe mënyrat e tjera të jetës. Shoqëria e injorancës del përpara nesh si një shoqëri, në të cilën pothuajse ka vdekur ndjenja e mëshirës. Në vend të dashurisë, mbizotëronte dhe vlente vetëm urrejtja, mallkimi dhe armiqësia. Ishte një shoqëri, në të cilën nuk mësohej mëshira.

Në vend të së drejtës, barazisë dhe drejtësisë, në shoqërinë e injorancës vlente padrejtësia, pabarazia dhe dhuna. Aty nuk kishte shumë vlerë respekti. Padrejtësitë, shtypja, pabarazia, dhunimi, mosrespekti dhe urrejtja ishin në

kulmin e tyre edhe në vende të tjera të botës, përveç gadishullit arabik.

Edhe te persët dhe bizantët gjendja nuk ishte më ndryshe. Kjo ishte koha, kjo ishte shoqëria dhe kjo ishte bota, kur Hz. Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem, mori detyrën si Pejgamber. Kjo shoqëri kishte shumë nevojë për Pejgamberin e mëshirës. Ky fakt ishte i qartë si dielli në mes të ditës. Shumë pak njerëz, që kërkonin të vërtetën dhe të dhunuarit, kishin nevojë për mëshirë dhe prisnin një udhëheqës mëshire.

Allahu i Lartmadhëruar, i cili është shumë i mëshirshëm ndaj të gjitha krijesave dhe ndaj të gjithë njerëzve, siç shprehet edhe në besmelenë (Bismillahi'rr-Rahmani'rr-Rahim), të cilën besimtarët e thonë në fillim të çdo pune, si një shfaqje e cilësive të tij Rrahman dhe Rrahim, iu përgjigj menjëherë kësaj nevoje, këtij kërkimi e kësaj pritjeje dhe Muhamedin, të birin e Abdullait, i cili njihej në shoqëri me cilësinë e besueshmërisë dhe të cilin e respektonin të gjithë, e dërgoi si pejgamber të mëshirës. Këta rreshta e shprehin qartë këtë gjendje:

Njerëzit thirrën me të madhe: Mëshirë! Mëshirë, o Zot!

Hapën duart dhe thanë: Mëshirë, o Rrahman!

Besimtarët u lutën dhe u përgjëruan: Mëshirë, o Rrahim!

Përgjigjja erdhi nga Rrahmani dhe Rrahimi:

“Ja mëshira. Tashmë u kam dërguar Pejgamberin e mëshirës, Muhamedin, të birin e Abdullait.”

PËRMBAJTJA KUPTIMORE E MËSHIRËS

Mëshira ka një përmbajtje kuptimore shumë të gjerë. Konceptin e mëshirës nuk është e drejtë ta kufizojmë me ndjenjën e dhembshurisë, sepse ngelet i mangët. Në turqisht, fjala mëshirë ka lidhje me fjalën dhembshuri, por ajo ka një kuptim më të thellë dhe më të gjerë se dhembshuria.

Të kuptosh se ç’do të thotë mëshirë, është një çështje e rëndësishme. Mëshira është një ndjenjë hyjnore, që shfaq cilësitë “Rrahman” dhe “Rrahim” të Allahut (xh.xh.), i cili është më mëshiruesi i mëshiruesve. (el-Mu’minun, 109.)

Cilësia Rrahman është mëshira dhe dhembshuria më e gjerë e Allahut të Madhëruar, e cila përfshin të gjitha krijesat dhe arrin te të gjithë e te çdo gjë, duke pranuar brenda saj të gjithë njerëzit, pa bërë ndonjë ndarje ndërmjet tyre. Sipas mendimit të disa gjuhëtarëve dhe komentuesve të Kuranit, Allahu Teala, me cilësinë Rrahim, mëshiron vetëm besimtarët. Kjo shprehet qartë në disa ajete të Kuranit Fisnik. Për shembull: (el-A’raf, 156; et-Tevbe, 128 etj.)

1. Të mëshiruarit ka dimensionin e vet praktik. Kështu që, njëri prej dy njerëzve të barabartë në planin ontologjik, duhet të ketë dhembshuri ndaj tjetrit, sepse kjo është detyra e parë e të mëshiruarit dhe e të afruarit me dhembshuri dhe me sinqeritet. Këtu bëhet fjalë për një dimension moral.

Njeriu që mëshiron, e bën veten mburojë, në mënyrë që njerëzit e tjerë të mos përballen me situata të këqija. Punon për shoqërinë dhe përpiqet t’i ndihmojë të varfërit, të shpëtojë robërit, të as-

gjësojë padrejtësinë dhe të mbrojë njerëzit nga zjarri i xhehenemit. Kryeja e këtyre është tregues konkret i të qenit mëshirues dhe e vërtetën atë.

Mëshirues është ai njeri që i ngjall individët dhe shoqërinë, ashtu siç ngjall shiu vendin dhe bimët, që i ndihmon ata të jetojnë dhe i mbron. Siç shikohet, mëshira nuk është një ndjenjë që përbëhet vetëm prej dhembshurisë.

Nëse në një zemër nuk ka mëshirë, ajo është e sëmurë. I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili u dërgua si mëshirë për botët, me hadithet, me sjelljet dhe qëndrimet e tij shembullore u bë përfaqësuesi më i madh i mëshirës.

HZ. MUHAMEDI (A.S.): PEJGAMBERI I MËSHIRËS PËR BOTËT

Kurani thotë se pejgamberi ynë i dashur, Hazreti Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem, i cili ishte një njeri i bukur dhe shembull për njerëzinë, u dërgua vetëm si mëshirë për botët: **“Ne të kemi dërguar si mëshirë për botët.”** (el-Enbija, 107.)

Nëse dërgimi i Hazretit Muhamed (s.a.s.), si mëshirë për botët nga një Zot, i cili është Erhamurrahimin, mëshiruesi i mëshiruesve, Rrahman dhe Rrahim, kuptohet si dërgim i një pejgamberi për të gjithë botën, atëherë profetësi do të thotë mëshirë. Fakti që Allahu i Madhëruar i dërgoi njerëzisë një pejgamber, do të thotë se i ka dërguar mëshirë nga ana e tij. (el-Bakara, 105; Ali Imran, 74; el-A’raf, 63; Merjem, 53; el-Kasas, 46.)

Kurani i cilëson si mëshirë edhe librat që janë dërguar si udhëzim për popujt e tjerë. (en-Nahl, 64; el-En’am, 157 etj.)

Duke parë jetën shembullore të Hazretit Pejgamber, sallallahu alejhi ve sellem, mund të kuptohet shumë qartë se çfarë do të thotë të qenët e tij mëshirë për botët. Ai ishte shembulli i mëshirës dhe këtë e tregoi duke e përjetuar vetë në jetën e tij cilë-



sinë "pejgamberi i mëshirës", e cila vërtetohet duke e vënë atë në praktikë.

Fakti ishte jeta e tij. Ndërsa burimi i parë, që na tregon cilësinë e të qenit pejgamber i mëshirës, është vetë Kurani Fisnik. Ai e pohon me ajete të ndryshme se Hazreti Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem, kishte shumë dhembshuri ndaj çdo gjëje, ndaj të gjithë njerëzve dhe veçanërisht, ndaj umetit të tij.

Kurani Fisnik shprehet se Hazreti Muhamedit (s.a.s.), i vinte shumë rëndë që shoqëria apo individët e shoqërisë të binin në vështirësi. Ai kishte shumë dhembshuri ndaj njerëzve dhe ishte shumë i butë e shumë i mëshirshëm ndaj besimtarëve. (et-Tevbe, 128.)

Me profetësinë e mëshirës dhe me mesazhin që i ishte dhënë, së pari duke bërë ndryshime rrënjësore në jetën e popullit të Mekës e atë të Medines dhe pastaj në jetën e të gjithëve, i shpëtoi ata nga besimi dhe jeta e adhurimit primitiv të idhujve dhe arriti t'i bënte robër, që adhurojnë vetëm Allahun, t'i bënte njerëz të lirë, t'i bënte njerëz si rrjedhojë e virtyteve të mësipërme, t'i bënte njerëz që thoshin e bënë të vërtetën e jo që gënjenin dhe t'i bënte njerëz që gjykonin me drejtësi e jo me padrejtësi.

Ai ishte Pejgamberi (a.s.), i cili me mëshirën e tij përgjatë gjithë jetës, u përpoq me mish e me thua për t'i shpëtuar njerëzit nga ndëshkimi i xhehenemit. Po ashtu, ai kërkonte që myslimanët t'i mëshirojnë njerëzit, duke marrë për shembull atë.

Ai ishte Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, i cili, me mëshirën e tij, i dha shoqërisë bedevite primitive Arabe elementët kryesorë të jetesës, si dashurinë, tolerancën, vetëpërbajtjen, butësinë, ndarjen e pasurisë me të tjerët, barazinë, drejtësinë, moralin e bukur, sjelljen e butë dhe ia hoqi urrejtjen e mallkimit. I mori ata nga balta dhe i bëri njerëz.

Ajo ishte një shoqëri, e cila përbëhej prej individësh, që, për shkak të mentalitetit të tyre mizor, gruaja nuk vendosej në pozitën e njeriut. Kur dëshironin, e varrosnin atë të gjallë. Çdo lloj dhune ndaj të varfërve, të skamurve, dhe të dobëteve e shikonin si diçka të përshtatshme. Të fortin e pranonin si të drejtë, të dobëtin si të padrejtë.

Kështu, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i zbukuroi ata me një mentalitet krejt të kundërt. Në botën

e jashtme dhe të brendshme të tyre, në subjektivitetet dhe objektivitetet e tyre, bëri ndryshime të mëdha. Në këtë mënyrë, si kryemësuesi i mësimit të mëshirës, ndërtoi një periudhë të bukur, e cila quhet "Asru Saadet" dhe shoqërinë shembullore të mëshirës.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, i cili Allahun e Madhëruar e kishte burim të mëshirës, përgjatë gjithë jetës së tij nuk i dha vend mallkimit. (Ali Imran, 31, 74, 159; el-Bakara, 64, 105, 218; Nisa, 96, 113; En'am, 12, 54, 133, 147; A'raf, 151, 156; Zümer, 53 vd.) Ai i urdhëroi njerëzit që të mos mallkonin, ashtu siç nuk kishte mallkuar as vetë.

Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, i cili ishte pejgamberi i dashurisë, i dhembshurisë dhe i mëshirës, dëshironte gjithmonë që çdo rob i krijuar të ishte i lumtur në këtë botë e në botën tjetër. Po ashtu, asnjëherë nuk dëshironte që ata të binin në vështirësi. Siç transmetohet në hadithet e sakta, kur i kërkuan që të mallkonte politeistët, qafirët, jobesimtarët dhe të padrejtët, ai tha:

"Unë nuk jam dërguar si mallkues. Unë jam dërguar si pejgamber i mëshirës." (Muslim, Birr, 87.)

Kur shkoi në Taif për të predikuar tevhidin, ata nuk e dëgjuan dhe e plagosën me gurë. Edhe pse ndodhej i tëri në gjak, përsëri bëri këtë dua: *"O Zot! Fali, sepse ata nuk dinë!"* (Ibn Hibban, Ed'ije, 973.)

Shkurtimisht, ai ishte një pejgamber mëshire, i cili nuk e shikonte me sy të mirë mallkimin dhe një pejgamber që i gjallëronte njerëzit, duke mos mallkuar. Edhe ata që dëshironin ta vrisnin, morën pjesë nga mëshira e gjerë dhe gjetën jetë me të.

Edhe kur luftoi për të mbrojtur besimin, fenë e jetën, ai luftoi me cilësinë e mëshirës dhe, në këtë mënyrë, e vazhdoi përpjekjen e tij. Jo vetëm njerëzit, por edhe kafshët dhe bimët ai i ka trajtuar me mëshirë. Mëshira e tij përfshinte të gjitha krijesat.

Siç është e mundur që ta shikojmë në jetën dhe në sunetin e Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, se ai ishte pejgamber i mëshirës, po ashtu mund ta shikojmë edhe në hadithet, të cilat janë një pjesë e pandashme nga jeta dhe tradita e tij. Në hadithet e sakta shkruhet se Hz. Pejgamber, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

"Kush nuk i mëshiron ata që janë në tokë, njerëzit, fëmijët



dhe gratë, edhe Allahu nuk do ta mëshirojë." (Buhari, Edeb, 18; Ebu Davud, Edeb, 58; Muslim, Fedail, 66, Selam 153-155; Tirmidhi, Birr 16.)

NDËRTIMI I SHOQËRISË SË MËSHIRËS

H. Muhamed, sallallahu alejhi ve sellem, si një pejgamber me lejen dhe me urdhrin e Allahut (xh.xh.), synonte të ndërtonte shoqërinë e mëshirës, e cila mbështetej në dashuri dhe kishte moral të bukur. Përgjatë gjithë jetës, përpjekjeve dhe luftërave të tij shikojmë dimensionet dhe shembujt e ndryshëm të vendosmërisë për realizimin e këtij synimi që kishte.

Hazreti Muhamedi (s.a.s.), i edukoi shokët e tij me mësimin e mëshirës që praktikonte dhe në Medine ndërtoi një shoqëri mëshire. Në shoqërinë e mëshirës, domethënë në shoqërinë ku sundonte mëshira dhe ndjenja e dhembshurisë, linden vlerat bazë, si dashuria, drejtësia dhe morali. Marrëdhëniet sociale formohen e përjetojnë me dashuri, shoqërimi ngrihet e realizohet me dashuri, formohen marrëdhënie që mbështeten në bazën e strukturës social-kulturore, në dhembshuri plot dashuri dhe në respekt.

Një kulturë e gatuar me dashuri transmetohet nga brezi në brez. Këtë është e mundur ta shikojmë në shoqërinë e sahabëve, që ndërtoi Hazreti Muhamed, sallallahu alejhi ve sellem. Sahabët e Medines së tij, si aktorë të një shoqërie të tillë, arritën mëshirën e Hazretit Pejgamber (s.a.s.) dhe e ngritën atë (mëshirën) në pikën më të lartë. Për këtë arsye, këtë shoqëri mund ta quajmë shoqëri të mëshirës.

Mëshira është ajo që e bëri këtë shoqëri të njihet nga gjithë bota në një kohë të shkurtër dhe që Islami të përhapet në një gjeografi të gjerë. Mëshira që kishte i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ndaj sahabëve dhe ajo që i mësoi umetit të tij, përfshinte jo vetëm të afërmit dhe besimtarët, por të gjithë njerëzinë, madje të gjitha krijesat.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u përpoq të siguronte dominimin e dashurisë në shoqërinë që kishte ndërtuar, duke u thënë besimtarëve këto fjalë plot kuptim: *"Asnjëri prej jush nuk mund të jetë besimtar i vërtetë, përderisa të mos dëshirojë për vëllain e tij atë që dëshiron për vetë."*

Si përfundim, Hazreti Muhamed, sallallahu alejhi ve sellem, sipas Kuranit është dërguar mëshirë për botërat. Ai u është afruar njerëzve me ndjenja të thella mëshire. Ndërsa, argumenti që vërteton se ai ishte Pejgamberi i mëshirës, është jeta e tij, është stili i jetës së tij. Ai është sjellë me mëshirë jo vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj të gjitha krijesave, ndaj kafshëve dhe ndaj bimëve.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, u është afruar njerëzve në mënyrën më njerëzore. Ndërsa dashurinë, respektin dhe drejtësinë i bëri bazë në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, ngaqë ai ishte dërguar si mëshirë për botërat. Hazreti Pejgamber, sallallahu alejhi ve sellem, si njeriu më i mëshirshëm, më i dashur, më i respektuar dhe më i drejtë, për njerëzinë, ka lënë një rrugë e cila buron nga Kurani dhe mbështetet në mëshirë.

Në këtë rrugë nuk ka vend për dhunë, urrejtje dhe padrejtësi. Në këtë rrugë ka dashuri dhe mëshirë ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Në këtë rrugë ka dashuri dhe dhembshuri për fëmijët. Në këtë rrugë ka dashuri, respekt, mëshirë dhe moral për gratë. Në këtë rrugë ka mëshirë për të privuarit, për të varfërit, për të dhunuarit, për të dobëtit, për të pafuqishmit, për të vetmuarit dhe për të skamurit.

Në këtë rrugë ka dashuri dhe mëshirë në marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Në këtë rrugë ka luftë kundër padrejtësisë dhe dhunës, por nuk ka terrorizëm. Në këtë rrugë, bazë është të ndihmuarit e njerëzve për të jetuar dhe jo për t'i vvarë. Në këtë rrugë, bazë është dhembshuria, dashuria dhe respekti, të cilët janë faktorë të domosdoshëm për mëshirën.

Shkurtimisht, në këtë rrugë të mëshirës, njerëzve u takon të marrin për shembull Hazreti Muhamedin, të jenë nga një burim mëshire dhe të përpiqen për të gjallëruar njerëzinë, duke ia shfaqur mesazhin e Islamit mentalitetit të shekullit, ashtu siç thotë edhe Mehmet Akifi.

Nëse dëshirojmë që të shpëtojmë nga fatkeqësitë e kaosit, terrorit e padrejtësisë, në të cilën gjendet sot njerëzia dhe që kjo botë të arrijë paqen e qetësinë, duhet të marrim për shembull këtë mëshirë të gjerë, e cila buron nga Allahu i Lartësuar, që është Rrahman e Rrahim, Hazreti Muhamedin, sallallahu alejhi ve sellem dhe duhet t'i çlirojmë zemrat me mëshirë, ashtu siç vepruan sahabët e tij.



Mesazhi i Kuranit

Prof. dr. Sherafetin Gëlçyk

Kurani, si një realitet, është shenja e vetme ndërmjet Krijuesit dhe krijesave të Tij. Përmes Kuranit, myslimanët gjejnë unitetin. Kurani i drejtohet gjithë njerëzimit, duke i ftuar për besim dhe duke qortuar e tërhequr vëmendjen për gabimet. Ai shpreh një lidhje e marrëdhënie të ngushtë ndërmjet Allahut dhe njeriut. Sepse Kurani është një kod i shpalluar nga Allahu, për të përmirësuar, zbukuruar jetën dhe për të siguruar lumturinë e njerëzve, si në këtë botë, ashtu edhe në botën e amëshuar. Megjithë hijeshinë, bukurinë mahnitëse dhe magjepsjen, e cila të bën për vete, Kurani nuk është poezi, sepse me stilin unik të ndërtimit të fjalive, përshkrimet e gjalla e të godituara, muzikalitetin dhe gjallërinë e ajeteve, ai nuk e fsheh në asnjë mënyrë kuptimin. Kurani themelon e ndërton një model jete dhe mendimi me veçoritë karakteristike që ka.

Me përmbajtjen e pasur dhe të thellë, Kurani nuk shërben vetëm si udhëzues për ndjenjat dhe anën shpirtërore, por në të njëjtën kohë, ai është edhe udhërrëfyes në jetën e përditshme. Prandaj, Kurani përcakton për myslimanin një sjellje fetare nën udhëheqjen e Tij.

Kurani është themeli i qytetërimit islam. Në botën islame, Kurani është baza kryesore për zgjidhjen e problemeve fetare, sociale dhe morale.

Në të vërtetë, praktikimi i përsosur i Kuranit, librit të Allahut, do të realizohej fillimisht në një shoqëri si shoqëria e Mekës. Për të arritur suksesin e duhur, Kurani përvetësoi një metodë dhe mënyrë karakteristike të vetën, për të mos e tronditur fort e, menjëherë, mënyrën e mendimit dhe jetesës së ngulitur thellë përgjatë shekujve, të popullit të Mekës. Metoda kuranore qëndron në bindjen e zemrave dhe mendjeve, nëpërmjet paraqitjes së mesazhit islam me urtësi, duke marrë parasysh edhe realitetin ku ndo-

dhej shoqëria. Në vija të përgjithshme, metoda hyjnore e ndjekur në Kuran, është që, nëpërmjet përshkrimeve elokuede dhe fakteve të pakontestueshme, njeriu ta pranojë vetë të vërtetën.

Në ajetet e para të shpallura nga Kurani, Allahu theksohet si krijues i njeriut dhe i gjithçkaje tjetër. Është shumë interesant edhe fakti që ajetet e para, përveç deklarimit të Allahut si krijues i gjithësisë, i bëjnë jehonë leximit, dijes dhe mësimi nëpërmjet shkrimit, pa përmendur edhe temat në lidhje me krijimin e njeriut. Nëpërmjet këtyre ajeteve, Allahu shpallet si krijuesi i vetëm dhe i pashoq. Përveç kësaj, shpallet edhe si udhëzuesi i vetëm.

Në përhapjen e një mendimi të caktuar, rol parësor luan përçuesi i mesazhit, i cili në rastin tonë është Pejgamberi (a.s.). Personaliteti i tij, sidomos besimi i palëkundur dhe këmbëngulja për ta çuar përpara kauzën, na rrëmben menjëherë. Muhamedi (a.s.), i vetëm dhe pa asnjë mbështetje shpirtërore apo materiale, mori nismën për të përçarur në çdo cep të botës një të vërtetë shpirtërore. Nga kjo pikëpamje, lëvizja e re hyjnore është një lëvizje individuale e Pejgamberit (a.s.). Së këndejmi, çdo mysliman është i detyruar të ndjekë Muhamedin (a.s.), udhëheqësin e përsosur.

Në planin praktik, kur individit i ngarkohet një përgjegjësi e madhe, është i detyruar të kryejë çdo gjë me forcat e veta. Njeriu i gjendur përballë Allahut dhe caktimit të Tij, bëhet i vetëdijshëm për përgjegjësinë që ka marrë. Këtë fakt, Kurani e përmend në ajete të ndryshme, si në ajetin **“Çdo njeri është peng i veprave të veta.”** (Mudethir, 38.)

Pejgamberi (a.s.), së pari ndjen përgjegjësi të thellë përballë vetes së Tij, pastaj përballë Allahut. Edhe myslimani duhet të ndjekë shembullin e Pejgamberit (a.s.). Urdhri për t’iu bindur dhe adhuruar Allahun ishte dhënë me kohë.

Thuaj: "Unë jam urdhëruar që ta adhuroj Allahun me përkushtim të sinqertë. Unë jam urdhëruar të jem i pari nga ata që i nënshtrohen Atij." (Zummer, 11/12.)

Qysh në fillim, Kurani e tronditi në themel mendësinë materialiste dhe pagane të popullit të Mekës. Në shumë vende Kurani i kërcënon jobesimtarët me dënime të ashpra në këtë botë dhe në botën tjetër. Nga ana tjetër, Kurani jep informacione të detajuara për botën e amëshuar, duke e përdorur këtë informacion si element edukativ dhe arsimor.

Nga elementët bazë të doktrinës së Kuranit, është gjykimi suprem në ditën e fundit. Ndërsa zbulesa kuranore vazhdonte pa ndërprerje, gjithnjë e më shumë theksohej koncepti i apokalipsit dhe botës së përtejme. Dita e gjykimit zë një vend të rëndësishëm në Kuran. Në njërën anë flitet për xhenetin me mirësitë dhe begatitë e shumta të përgatitura posaçërisht për besimtarët, nga ana tjetër flitet për xhehenemin me vuajtjet dhe dënimet që do të pësojnë jobesimtarët në botën tjetër. Këtë këndvështrim të Kuranit do ta vërtetonte më vonë historia. Zbulesa kuranore kishte synime të caktuara. Nga synimet ishte edhe arritja e bashkimit të arabëve. Me bashkimin e arabëve do të arrihej përhapja e islamit në vende të tjera.

Stili i bukur dhe tërheqës i Kuranit i kishte detyruar edhe armiqtë më të egër ta pranonin atë si mrekulli. Armiqtë e Islamit bënë të gjitha përpjekjet për të parandaluar përhapjen e Kuranit më tej, jashtë Mekës, sepse ata ishin të vetëdijshëm për ndikimin që kishte mbi njerëzit që vinin për të vizituar Qaben. Ndikimi i tij kishte bërë të mundur të ndahej vëllai nga vëllai.

Ndikimi i Kuranit nuk ishte i kufizuar vetëm me masën e gjerë të popullit, por ishte shtrirë edhe në shtresën e lartë të Mekës. Në krye të listës qëndronin poetët dhe magjistarët. Stili i jashtëzakonshëm i Kuranit i kishte mahnitur dhe habitur njëkohësisht, duke i kthyer ata në të pavlerë në sytë e popullit.

Si për nga stili, forma, mënyra dhe përmbajtja, Kurani u jepte përgjigje dhe zgjidhje përfundimtare problemeve e nevojave jetësore të popullit. Në kohën kur zbriti Kurani, tregtia në Mekë ishte në lulëzim, por pabarazia sociale, padrejtësitë dhe imoraliteti ishin kthyer në një gangrenë të vërtetë. Ishte i nevojshëm shërimi i plotë dhe i përhershëm i kësaj gangrene. Në këto momente pritej një mrekulli dhe, pikërisht në këto momente, shfaqet Kurani me gjithë madhësinë e vet, duke i ofruar njerëzimit recetën për një jetë të vërtetë. Vendosi një ideal të madh para popullit të Mekës. Vetërealizimi i njeriut në këtë botë do të arrihej nëpërmjet misionit që i ishte ngarkuar atij gjatë krijimit nga Allahu. Detyra e përmbushjes së këtij misioni duhej mbajtur vazhdimisht gjallë në zemrat dhe ndërgjegjen e njerëzve. Kjo është arsyeja që suret e zbritura gjatë periudhës së Mekës theksojnë besimin në një Zot të vetëm, duke

e kaluar përkohësisht në plan të dytë karakterin social dhe kolektiv të Islamit. Fillimisht, synimi hyjnor i Kuranit ishte përgatitja dhe më pas, rrënjosja fort e besimit në zemrat e njerëzve, në mënyrë që të ishin të gatshëm për transformimin që do të pësonin në mënyrën e perceptimit të botës. Në pamje të parë, duket sikur aspekti social është anashkaluar, por në të vërtetë nuk është ashtu. Duke vënë në dukje anët negative të shoqërisë Mekase, si mendjemadhësinë, ambiciet e tepruara, koprracinë, Kurani ftonte për vëllazëri, harmoni dhe ndihmë ndaj të varfërve. Surja maunë është një shembull shumë i gjetur për këtë fakt: **"A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?"**

Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit. Mjerë për ata, të cilët, kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet, të cilët duan vetëm që të duken dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve." (Maun)

Ndihma ndaj të varfërve dhe interesimi për gjendjen e tjetrit, ishin sjellje shumë të rralla në shoqërinë arabe. Në Meken e atëhershme ekzistonin dy shtresa shoqërore: shtresa e tregtarëve dhe shtresa e të varfërve në shërbim të tyre, së bashku me skllëverit.

Mesazhi kuranor gjeti jehonë të madhe, veçanërisht në shtresën e dytë. Për herë të parë shfaqet një njeri që thotë se është i Dërguari i Allahut dhe, në të njëjtën kohë, përçues i fjalës së Tij. Ky pejgamber, i dërguar si mëshirë për gjithë njerëzimin, interesohej për problemet e tyre dhe u premtonte parajsën, vendin e mirësive dhe begatitë të përhershme. Për herë të parë forca dhe autoriteti i padiskutueshëm i shtresës së lartë, u vu në dyshim. Kurani nuk urdhëroi direkt shkatërrimin e putave. Së pari, ai vuri në dukje kotësinë e mënyrës së jetesës që kishin përvetësuar dhe shpalli qartë se çdo mënyrë tjetër jetese, jashtë programit hyjnor, është e pavlefshme dhe e refuzuar. Në të njëjtën kohë, u kujtoi atyre se kënaqësitë që merrnin nga mirësitë e kësaj bote, ishin të përkohshme. Përmes fjalës së Tij, Kurani, Allahu shpallosi një platformë morale të pranueshme dhe të përvetësueshme nga gjithë shoqëria.

Nuk kishte asnjë arsye që Kurani të aplikonte forcën apo dhunën. Përkundrazi, në Kuran jepet një mesazh i gjallë për popullin e Mekës: Allahu i lartësuar ka zgjedhur nga mesi juaj për Pejgamber Muhamedin (a.s.), i cili është model i gjallë në drejtësi, besnikëri dhe në sjellje, jo vetëm me njerëzit, por edhe me natyrën. Më i miri prej jush është ai, që është më afër Allahut dhe më afër Tij është më i devotshmi. Ky parim kuranor i shpallte njerëzit të gjithë të barabartë para Allahut. Nuk ekzistonin më dallime midis individëve apo kombeve për arsye prejardhjeje, gjinie, ekonomie etj. Tashmë, kriter për dallimin e njerëzve u bë morali.

Një nga përmbysjet më të mëdha që bëri Kurani, ishte përmbysja e botëkuptimit material dhe vendosja e një botëkuptimi me qendër Allahun, krijuesin e gjithçkaje.

Kurani është themeli i qytetërimit islam. Në botën islame, Kurani është baza kryesore për zgjidhjen e problemeve fetare, sociale dhe morale.

Me këtë botëkuptim të ri, njeriu nuk do të bëhej rob i pasurisë dhe të mirave materiale të kësaj bote. Tashmë njeriu do të ishte vetëm rob i Allahut, i cili e krijoi dhe po ai do të jetë gjykatësi suprem në ditën e gjykimit. Më në fund, lumturinë e shumëkërkuar në këtë botë, njeriu do ta gjejë vetëm në atmosferën e imanit. Nga kjo pikëpamje, ibadeti dhe lutja zënë një vend të rëndësishëm në jetën e besimtarit, sepse gjatë ibadetit dhe lutjes, njeriu është përballë Allahut të lartësuar.

Tema kryesore e Kuranit është besimi i plotë në ekzistencën e Allahut të pashoq dhe dedikimi i ibadeteve vetëm Atij. Nuk ekzistonte Zot tjetër përveç Allahut, të gjitha adhurimet i kushtohen vetëm Atij. Me mesazhin kuranor lindi një epokë e re, e cila karakterizohej nga fryma hyjnore. Më në fund, hyri epoka e Kuranit.

Kur analizojmë Kurantin gjatë historisë, ajo që duket qartë, hapur dhe pastër është: Kurani është një realitet i gjallë. Kurani e ruan në të gjitha aspektet rëndësinë, dinamizmin dhe gjallërinë në shoqëritë myslimane aktuale.

Barrën kryesore për përhapjen e mesazhit kuranor e mbajti Pejgamberi (a.s.), i cili, me besimin dhe vendosmërinë e Tij e çoi deri në fund detyrën e ngarkuar. Çdo mysliman duhet të marrë për model Pejgamberin (a.s.). Përkushtimin e tij në përmbushjen e detyrës, Pejgamberi (a.s.), e ka shprehur shumë bukur në haxhin e lamtumirës, përpara një turme të madhe njerëzish, duke iu drejtuar: *"Po ju lë librin e Allahut, Kurantin. Për sa kohë t'i përmbaheni atij, nuk do të bini kurrë në gabime"* Nga ky deklaram profetik, në një rën anë kuptojmë përgjegjësinë tonë, në anën tjetër rëndësinë e madhe të Kuranit te Profeti (a.s.).

Përgjegjësia është e lidhur ngushtë me karakterin dhe personalitetin e njeriut. Qëllimi hyjnor në Kuran është që, krahas ngarkimit me përgjegjësi individuale, të zhvillojë karakterin dhe personalitetin e njeriut. Në ditën e gjykimit, njeriu do të gjykohej vetëm për përgjegjësitë individuale. Ai do të dalë i vetëm përpara Allahut. Prandaj në Kuran, theksohet vazhdimisht dita e gjykimit të fundit.

Një shoqëri e shëndoshë dhe e konsoliduar lind së pari nga ndërgjegjësimi i lartë për përgjegjësitë individuale. Dhe ky ishte qëllimi përfundimtar i Kuranit, formimi i një shoqërie islame me bazë teuhidin, njësimin e plotë të Allahut. Shoqëria e re me bazë teuhidin, do të ndërtohej duke çrrënjësuar përfundimisht sistemin e vjetër të besimit pagan.

Myslimani, si mëkëmbës i Allahut dhe përfaqësues i vullnetit të Tij në tokë, do të ndërtojë një botë krejt të re, duke u qëndruar besnik parimeve kuranore. Për realizimin e këtij projekti, frymëzimin dhe fuqinë e merr vazhdimisht prej Kuranit.

Më vonë, bota islame u shndërrua në një qendër të ma-

dhe kërkimore, qëllimi i së cilës ishte paraqitja sa më bukur e fjalës së Allahut. Gjithë këto përpjekje ishin që, brenda mundësive, të vihej në jetë Kurani dhe të kryhej zbatimi sa më korrekt i Tij.

Në këtë mënyrë, njerëzimi u bë dëshmitar i themelimit të një qytetërimi mbi parimet kuranore. Të gjitha sjelljet e shoqërisë islame marrin formë nga Kurani, nga ky burim i fuqishëm hyjnor.

Ringjallja e shoqërisë islame dhe rishfaqja para botës me një projekt-qtetërimi të ri, është e mundur vetëm me studimin e hollësishëm të Kuranit nga pikëmapja sociologjike, psikologjike e teologjike dhe përfundimet e nxjerra të ndahen me çdo individ të shoqërisë islame.

Nga ana tjetër, Kurani akoma nuk e ka përmbushur detyrën sublime, sepse ai, me gjithë madhësinë e vet, e ruan akoma superioritetin. Libri i shenjtë i myslimanëve është në shërbim dhe gatishmëri të plotë për zgjidhjen e një sërë problemesh globale me karakter moral, social apo fetar. Por që të realizohet kjo, së pari duhet që vetë myslimanët t'i kthehen Kuranit, që më pas jehona e Tij e ëmbël të pushtojë zemrat e gjithë njerëzimit.

Kurani, ky libër universal, i cili doli fitimtar kundër jobesimtarëve, politeistëve dhe hipokritëve të kohës, duhet të marrë vendin që i takon në debatet globale për qytetërimin dhe kulturën. Ai duhet t'i rrezatojë dritë njerëzimit, për më tepër sot, kur gjithnjë e më shumë bëhet fjalë për një qytetërim global.

Detyrimet përballë Kuranit nuk u përkasin vetëm myslimanëve, por gjithë njerëzimit. Njerëzimi nuk duhet të harrojë rolin e Kuranit në ruajtjen dhe krijimin e vlerave njerëzore. Paqja botërore realizohet përmes afrimit dhe bashkëpunimit të kulturave dhe, në këtë pikëpamje, Kurani përmban një sërë elementesh që ndihmojnë në arritjen e këtij qëllimi. Një mision të tillë, Kurani e realizoi fillimisht me sukses të plotë në Mekë, pastaj në Medine, për të vazhduar më tej në gjithë botën islame. Në themel të suksesit të Kuranit qëndron vetëm imani.

Kurani është dhurata më e vlefshme dhe më e madhe e Allahut për njerëzimin. Ai është trashëgimia më e madhe shpirtërore në dorë të njerëzimit, sepse përfshin të gjithë librat e mëparshëm, duke i marrë në ruajtje deri në ditën e kiametit. Si i vetmi libër që e ruan karakterin hyjnor të tij, Kurani është edhe burimi më i rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve të njerëzimit, qofshin individuale, sociale, morale apo fetare.

Trashëgimia tjetër e rëndësishme është ajo profetike. Me këto dy trashëgimi të pasura, myslimanët janë shoqëria më fatlume në rruzullin tokësor. Pejgamberi (a.s.), është një Kuran i gjallë në mesin e shoqërisë islame. Myslimanët janë të obliguar që këto privilegje që zotërojnë, t'i ndajnë me gjithë njerëzimin.



NE dhe edukimi

Nuredin Nazarko



Çdo ditë e më tepër po i kushtohet një vëmendje dhe kujdes i posaçëm, arsimit të fëmijëve në të gjitha nivelet e shkollimit, pa marrë në konsideratë aftësitë e nxënësve dhe inteligjencën e atij që shkollohet. Arsimiti i individit është i lidhur pashmangshmërisht me prezencën e këtij të fundit në institucionet arsimore publike apo private. Institucionet arsimore besohet të jenë vatra, jo vetëm të aftësisë të individit në aspektin operacionel, por edhe si mjedisi në të cilin mbruhet një individ, një qytetar i së ardhmes i mirëedukuar, për t'i shërbyer nesër shoqërisë. Padyshim që në ditët e sotme jemi tepër larg institucioneve klasike të edukimit dhe jo vetëm. Synohet një përmirësim gjithmonë e i vazhdueshëm i infrastrukturës shkollore dhe bazës së saj materiale, që *de facto*, është një kusht më se i domosdoshëm për normalitetin e realizimit të një procesi mësimor normal. Por sidoqoftë, ajo çfarë përbën interes, është mënyra se si përgatiten individët dhe personalitetet, kryesisht në hallkat e zinxhirit të sistemit arsimor dhe jashtë tij. Prezenca në institucionet arsimore e vendos qenien njerëzore në zhvillim e sipër, përballë personelit mësimor, përbërë nga një numër i caktuar individësh, të cilëve u është besuar edhe edukimi i brezave të rinj. Brezi në rritje dhe në formim e sipër, përballet me një shumësi të caktuar karakteresh, që përtej transmetimit të njohurive, shpërfaqin karaktere vetjake, rezultat i një edukimi të mëhershëm, qoftë nga institucionet arsimore, familja apo shoqëria. Kësisoj, brezi i ri gjendet mes asaj çfarë ofrojnë tekstet shkollore, shoqëria, masmedia nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, modelit të ofruar nga pjesëtarët e personelit arsimor, në sintoni me modelin sundues të shoqërisë ose jo. Duke qenë se produkti final i sistemit arsimor është më së pari qytetari dhe jo njeriu, është më se e kuptueshme që brezi në formim e sipër dhe jo vetëm, do t'i serviren të gatshme direktiva dhe përgjigje orientuese të mënyrës së të jetuarit dhe kjo servirje do të vyshkë refleksionin dhe të menduarit dhe nuk mund të thatëzohet diçka që nuk ka qenë e gjallë më përpara. Këtij individit të ardhshëm të shoqërisë i mësohen në mënyrë shkollareske se cilat janë sjelljet që duhet të kryejë gjatë jetës dhe cilat jo, qoftë edhe duke iu imponuar dhe detyruar që të sillen kësioj, pasi ajo çfarë vlerësohet si sukses në formimin e qytetarit, është ndryshimi përjashtësor dhe skematik i sjelljeve dhe qëndrimeve të tij. Sjellja dhe qëndrimet e individit duhet të modelohen sipas modelit sundues, pa u vramundur se çfarë ndodh me brezinë e njeriut, madje ajo, as që duhet të gjallojë. Që të kemi një brez të edukuar me parimet universale dhe të mbarëkohshme, duhet të kemi si bosht referimi modele *modus Vivendi*, të gjakuara pikërisht me këto parime, modele të cilat na frymëzojnë me jetësimin e këtyre parimeve edhe atëherë kur ky jetësim duket krejt i pazakontë,

i panatyrshëm, madje dhe i pamundshëm. Pyetja që lind dhe shtrohet natyrshëm është se çfarë është në të vërtetë edukimi, çfarë do të thotë të edukosh? Mos vallë ndryshim të rrethanave ku jeton njeriu, për ta bërë më të mirë? Po sikur të mos jetë i mundur ndryshimi i këtyre rrethanave? Po atëherë, çfarë tjetër? Synimi i edukimit të vërtetë, s'është që të ndryshojë njeriun drejtpërdrejt (sepse shikuar hollë e hollë, kjo nuk është as e mundshme), por që me shembull, këshillë, pamje a me çfarëdo tjetër, të vërë në lëvizje një rrjedhë të brendshme të përjetimeve, të detyrojë një vendim fare të brendshëm në dobi të së mirës. Pa këtë, s'ka ndryshim të vërtetë të njeriut. Arrihet vetëm ndryshimi i sjelljeve, që mund të jetë i shtirur ose fare i përkohshëm. Sjellja që nuk angazhon gjakimin tonë më të thellë, që ka ngelur në sipërfaqe, s'është edukim, por dresurë. (Izetbegoviç, A. "Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit", Shkup, 2000, fq. 158). Detyra që shtrohet si domosdoshmëri para gjithësa janë të implikuar në shenjimin e *tabula rasa*, është të vendosurit në lëvizje të brendësisë së qenies njerëzore, për të manifestuar dramën e qenies njerëzore, sepse pa dramë nuk ka as edhe njeri. Por a mund të ndodhë kjo, në qoftë se vetë brendësia jonë nuk është vendosur në lëvizje dhe nuk rrjedh në shtratin e mendimit, për të mos qenë pjesë e atyre që kanë zemra, por nuk mendojnë? Të shenjuarit e *tabula rasa* është jashtëzakonisht i rëndësishëm për rrjedhën që merr jeta e qenies njerëzore gjatë zhvillimit dhe konsolidimit të saj, pasi të mësuarit nga dikush, është dhe mënyra e parëhershme e mbrujtjes së njeriut me dije. Ja se si shprehet André Gide, teksa vlerëson veprën e filozofit të mirënjohur francez René Guénon: "...S'kam absolutisht asgjë që të hedh poshtë në gjithësa shkruan Guénon, është thjesht i parrëzueshëm...Një nga gjenitë e kohëve tona...Ç'do kish ndodhur me jetën time, nëse do t'i kisha lexuar veprat e Guénon-së gjatë rinisë sime? - Por atyre viteve veprat e Guénon-së s'ishin shkruar ende. Tani është tepër vonë; jeta ime mori drejtimin që mori, tashmë asgjë s'mund ta ndryshojë." (Vlerësim i përmendur në kopertinën përmblyllëse të librit, *Kriza e botës moderne*, Tiranë, 2009). Megjithëse asnjëherë nuk është vonë për të hyrë në udhën e të menduarit, pra më së pari, të edukimit të vetvetes, pasiqë mendimi dhe çfarë duhet menduar qëndrojnë të hapura ndaj qenies njerëzore përsa gjendet në botën e vdekatarëve, sërish formimi dhe edukimi i hershëm i *tabula rasa* lë traga të pashlyeshme dhe shpeshherë, me influencë të parëdorshme në sjelljet dhe qëndrimet e njeriut apo qytetarit. Prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që edukimi i njeriut të kryhet në përputhje me natyralitetin e qenies së tij, duke u boshtuar përreth modelit njerëzor më të arrirë, që i ka jetësuar parimet e epërme dhe të mbarëkohshme në shkallën më të lartë të mundshme prej njeriut, që edukimi ynë të jetë kuptimdhënës i ekzistencës sonë si qenie njerëzore.

SISTEMI BANKAR ISLAMIK: NGA KËRCËNIMET E KRIZËS NË MUNDËSITË PËR TË ARDHMEN

Mirjona Dervishi



Për më shumë se një çerek shekulli, sistemi bankar dhe financat islame janë zhvilluar nga një ide dhe një shprehje e identitetit të myslimanëve, në një industri me rritje të madhe. Me krizën e fundit financiare globale, bankat islame dhe financat u bënë një nga çështjet më të debatuar në mbarë botën. Duke pasur parasysh që gjithçka që është e ndryshme është tërheqëse, bankat islame janë analizuar që nga fillimi i krizës, në mënyrë që të identifikohen karakteristikat e tyre, burimet e elasticitetit, dobësitë, potencialet dhe mundësitë për rritje. Sistemi bankar islam është një komponent i rëndësishëm i financave islame. Financat islame kanë karakteristika unike, sepse themelimi i tyre është hedhur në parimet dhe rregullat e ligjit islam (Sheriati), i cili thotë se çdo gjë është pronë e Allahut dhe njeriu vetëm është lejuar ta përdorë atë. Prandaj, përdorimi i fondeve udhëhiqet nga disa rregulla.

Në një vlerësim fillestar të përgjithshëm të bankingut islamik, tipari më thelbësor i bankave islame është ndalimi i interesit (Riba). Bankat islame, as nuk ngarkojnë dhe as nuk paguajnë interes në një mënyrë konvencionale, ku pagesa e interesit është përcaktuar më parë dhe shihet si çmim i paracaktuar i kredisë ose shpërblim për paratë e depozituara. Ligji islam e pranon shpërblimin mbi kapitalin për ofruesit e kredisë, vetëm në bazë të ndarjes së përbashkët të fitimit ose humbjes, duke punuar në parimin e kthimit të ndryshueshëm që lidhet me produktivitetin aktual dhe performancën e projektit të financiar. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i bankave islame është veçoria sipërmarrëse. Sistemi është i fokusuar, jo vetëm në zgjerimet financiare, por edhe në zgjerimin fizik të prodhimit ekonomik dhe shërbimeve. Bankat islamike janë përqendruar në aktivitetet e investimeve të tilla, si financimi i kapitalit, financimi i tregtisë dhe investimet e pasurive të patundshme. Bankat islame janë institucione që shtyhen drejt fitimit, ashtu si dhe bankat e tjera konvencionale, por ato e menaxhojnë të gjithë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin (sipas Sheriatit). I pari fenomen modern islamik bankar, u shfaq si rezultat

i reagimit të intelektualëve myslimanë, me përdorimin e bankave konvencionale tregtare në aktivitete tregtare në mes të komuniteteve të biznesit vendas dhe institucioneve të jashtme.

Sundimi kolonial në vendet islamike ka rritur nevojën e myslimanëve për të ruajtur dhe për të mbrojtur ligjin dhe parimet islame, madje edhe në sferën financiare. Eksperimentet e hershme në këtë sektor janë ndërmarrë në vitin 1963 në Egjipt dhe Malajzi. Pa referenca ndaj parimeve islame (si frikë e pasojave politike), Ahmed El Nexhhar themeloi të parën bankë kursimesh egjiptiane, të bazuar pa interes dhe parimet për ndarjen e fitimit. Korporata e Kursimeve të Pelegrinëve Myslimanë ishte institucioni i parë financiar islamik në Malajzi. Ajo u ngrit për të ndihmuar njerëzit mbi kursimet për kryerjen e haxhit. Sot, Malajzia është emetuesi më i madh i Sukuk simbol (bonove islame) në rang botëror dhe një nga nxitësit kryesorë të inovacioneve në sistemin bankar islam.

Bankat e para të vërteta islame nuk ishin hapur në nivel kombëtar. Në vend të kësaj, gjatë viteve 1970, një numër i këtyre bankave ishin krijuar në një nivel më lokal në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Banka e parë e mirëfilltë islame ishte Nasser Social Bank, e cila ka filluar të operojë në Kajro, në vitin 1972. Ajo u pasua nga Banka Islamike e Dubait, në vitin 1975 dhe Bankat Islamike Faisal u themeluan në vitin 1977, në Sudan dhe Egjipt.

Hapi i dytë në evolucionin e sistemit bankar islam ishte përhapja e tij në një nivel ndërkombëtar, duke krijuar të parin institucion ndërkombëtar financiar islamik, siç ishte Banka Islamike për Zhvillim, në vitin 1973. Hapi i tretë erdhi me transformimin e të gjitha sistemeve bankare kombëtare në përputhje me Sheriatin. Përmendim rastin e Iranit, Pakistanit dhe Sudanit. Bankat islame operojnë kryesisht në vendet myslimane, por aktualisht ato operojnë gjithashtu edhe jashtë këtyre vendeve. Për shembull,



në Mbretërinë e Bashkuar, e cila është bërë vendi më i rëndësishëm për aktivitetin islam financiar jashtë botës myslimane. Sot, rreth 53 vende kanë institucionet bankare isla-

me, dhe të paktën 70 vende, kanë një lloj të shërbimeve financiare islame. Pothuajse pa përjashtim, bankat e mëdha shumëkombëshe ofrojnë aktualisht një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare në përputhje me Sheriatin. Bankat më të mëdha islame janë të vendosura në vendet e Gjirit për Bashkëpunim Rajonal (Bahrain, Kuvajti, Omani, Katari, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe).

Për katër dekadat e fundit, sistemi bankar islam ka përjetuar një evolucion të madh nga një nishe e vogël e dukshme vetëm në vendet islamike, në një konkurrent fitimprurës, dinamik dhe elastik në nivel ndërkombëtar. Madhësia e bankave islame në mbarë botën, është vlerësuar të jetë afër 850 miliardë dollarë në fund të vitit 2008 dhe pritet të rritet me rreth 15 për qind në vit. Ndërsa sistemi bankar islamik mbetet komponenti kryesor i sistemit financiar islam, elementet e tjera, të tilla si, Takaful (kompanitë e sigurimeve islame), fondet e përbashkëta dhe Sukuk, kanë dëshmuar gjithashtu një rritje të fuqishme globale. Sipas një vlerësimi të besueshëm, industria financiare islame tani arrin në mbi 1 trilion USD (viti 2010). Për më tepër, mundësia për rritje në këtë sektor është e konsiderueshme. Është vlerësuar se sistemi mund të dyfishohet në madhësi brenda një dekade, në rast se vazhdon me të njëjtën performancë të së kaluarës edhe në të ardhmen.

Në dekadën para krizës financiare, sistemet financiare

në përputhje me Sheriatin kishin aftësi kthimi të jashtëzakonshme. Asetet u dyfishuan pothuajse çdo dy vjet dhe të ardhurat neto u dyfishuan çdo vit. Disa institucione patën një kthim në kapitalin e tyre të deklaruar, më shumë se 30 për qind dhe në disa raste edhe më shumë se 40 për qind. Ata ishin në gjendje për të fituar një mesatare të kthimit nga aktivitetet, duke arritur 10 për qind. Edhe nëse këto shifra nuk janë të jashtëzakonshme në krahasim me ato të deklaruara nga institucionet konvencionale financiare midis viteve 2000 dhe 2007, janë mjaft mbresëlënëse, po të kemi parasysh afatin kohor dhe dinamikën e evolucionit të sistemit islamik financiar.

Kriza globale financiare, që filloi në vitin 2007, ishte sfida e parë e vërtetë për këtë sektor me rritje të shpejtë financiar. Klima e krijuar pas krizës goditi ekonominë reale, duke krijuar sfida, si për institucionet e saj, ashtu dhe në mundësitë për zgjerimin e shpejtë. Pasojat e krizës mund të ndahen në dy faza të rëndësishme: ndikimi i krizës në sektorin financiar dhe efektet e krijuara nga kriza financiare në ekonominë reale. Për shkak të mungesës së studimeve gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme, analiza e performancës së sistemit bankar islam gjatë krizës, është e bazuar kryesisht në prova empirike, dëshmitare dhe arsyetimin e analistëve.

Faza e parë e krizës, gjatë vitit 2007 dhe 2008, ka favorizuar sistemin islamik bankar në krahasim me sistemin konvencional. Sipas një studimi të fundit të FMN (2010), bankat islamike kanë operuar më mirë se sa ato konvencionale në vitin 2008, në drejtim të profitabilitetit të kredive dhe rritjen e aseteve. Sipas këtij studimi të FMN-së, raportohet se bankat islame e kanë ruajtur rritjen e fortë të kredisë, në krahasim me bankat konvencionale, në pothuajse të gjitha vendet dhe në të gjitha vitet, duke sugjeruar se sistemi ka potencial të madh për zgjerimin e tregut të mëtejshëm të aksioneve dhe kontributin e mundshëm për stabilitetin e tregut nëpërmjet kredive në dispozicion. Trendi i njëjtë është ruajtur në anën e aktiveve dhe u rrit mesatarisht më shumë se dy herë se bankat konvencionale, gjatë periudhës 2007 - 2009. Për shkak se kriza globale është një fenomen në vazhdim e sipër, këto rezultate janë të përkohshme, megjithatë, ato janë të mbështetura nga karakteristikat e sistemit islamik bankar.

Karakteristika islamike mbi biznesin bankar, si model kanë ndihmuar sistemin duke e mbrojtur atë nga ndikimi i parë financiar i krizës globale. Financat konvencionale janë bazuar kryesisht mbi borxh dhe lejojnë transferimin e rrezikut, ndërsa ndërhyrja financiare islame është e bazuar mbi asetet dhe fokusohet në ndarjen e rrezikut. Ndalimi i ndërhyrjeve të tepruara, si dhe transferimeve të rrezikut sipas parimeve të Al-Sheriatit e bënë sistemin më elastik, më pak të ekspozuar, duke e mbrojtur kështu

nga ndikimi i aseteve toksike dhe efekteve derivative, që shkaktuan krizën globale financiare.

Karakteristikat e sistemit bankar islam i bëjnë aktivitetet të lidhura më ngushtë me ekonominë reale. Kjo zvogëlon kontributin e saj ndaj teprimeve, por gjithashtu, e bën atë më të ekspozuar dhe të pambrojtur në valën e dytë të krizës financiare: rënies reale ekonomike. Bankat islamike huazuan një pjesë të madhe të fondeve të tyre për sektorin e konsumatorit dhe kanë investuar në aktivitete që kanë provuar në kohë të jenë jolikuide, duke ndarë humbjet e veprimtarisë së tyre me palët e përfshira. Sipas studimit të FMN-së, rënia e profitabilitetit të bankave të mëdha islamike në 2009, ishte për shkak të dobësive në praktikën e menaxhimit të rrezikut, të lidhura kryesisht me shkallën e lartë të përqendrimit në/ose ekspozimit të madh mbi një sektor dhe/ose huamarrës.

Ky efekt i raundit të dytë ka sjellë në sipërfaqe disa mangësi që ndoshta mund të rrezikojnë kapacitetin e sistemit islamik bankar për t'u rritur dhe zhvilluar. Këto sfida duhet të adresohen, në mënyrë që bankat islamike të maksimizojnë potencialin e tyre, duke përfshirë nevojën për të përmirësuar menaxhimin e rreziqeve të disa tregjeve të caktuara të tilla, si likuiditetit dhe riskun e reputacionit. Menaxhimi i likuiditetit është i vështirë, sipas rregullave të financave islame, për shkak të mungesës ose kufizimit të instrumenteve praktike dhe numrit të vogël të pjesëmarrësve në tregun e parasë. Ngaqë shumica e mjeteve konvencionale të likuiditetit janë të ndaluara, sipas parimeve të Sheriatit, bankat islamike mbështeten në raporte të larta likuiditeti në krahasim me bankat konvencionale. Megjithatë, mungesa e standardizimit të kontratës, mungesa e instrumenteve për t'u mbrojtur kundër paqëndrueshmërisë së valutave dhe bursës së mallrave, kuadri ligjor jo i plotë, si dhe ekspertiza e pamjaftueshme në nivel mbikëqyrës dhe industrial, duhet të dobësojë potencialin e financave islame dhe të ndikojë në reputacionin e tyre.

Sistemi bankar islam nuk është homogjen. Disa banka i kanë mjetet e menaxhimit të rrezikut më shumë të sofistikuara, burimet financiare të ndryshme dhe një bazë të larmishme të konsumatorëve. Të tjerët kanë aktivitete më pak komplekse dhe nivele të ndryshme të likuiditetit. Megjithatë, të gjitha bankat islame janë të ndjeshme ndaj efekteve të mëdha negative nga ekonomia reale dhe kanë për të kapërcyer të metat e tyre aktuale, ndër të cilat më të rëndësishme janë: menaxhimi i likuiditetit,

përmirësimi dhe harmonizimi i regjimit rregullator dhe mbikëqyrës dhe mbajtja e infrastrukturës ligjore të përditësuar në linjë me ritmin e peizazhit financiar që po ndryshon me shpejtësi.

Sistemi bankar islam ka provuar qëndrueshmërinë e tij gjatë krizës financiare, por kjo nuk duhet të konsiderohet si zgjidhja për sistemin bankar konvencional të prekur nga kriza. Nuk ekziston gjë e tillë si sisteme bankare të përsosura, ka vetëm sisteme të cilat përshtaten më mirë për kushtet e tregut në të cilat ato operojnë. Bankat islame janë më pak të prekura nga kriza financiare, por nuk ishin në gjendje për të shmangur impaktet negative të efekteve të krizës ekonomike në meritat e kreditit të klientëve të tyre dhe për të parandaluar pasojat e shkallës së lartë të përqendrimit.

Para krizës, sistemi bankar islam mund të shihej si një mikrosistem që operoi në mënyrë të mrekullueshme për atë dimension. Mungesa e standardizimit dhe përqendrimi në tregun vendas, ishin veçoritë e bankave islame. Kushtet e reja të tregut tashmë e kanë çuar sistemin islamik bankar në një nivel tjetër, ku ekzistojnë rregulla dhe rreziqe të ndryshme.

Disa autorë argumentojnë se modeli i biznesit të shumë institucioneve financiare islame do të duhet të rishqyrtohet, duke ndërtuar burime të larmishme të të ardhurave të tilla, si të ardhurat nga shërbimet këshilluese, menaxhimin e aseteve ose të shërbimeve financiare, të ofruara për klientët me pakicë. Edhe pse bankat islame duhet të arrijnë ekonomitë e shkallës që i bëjnë ato konkurrentë praktikë, zgjidhja është për t'iu përshtatur kushteve të synuara të tregut dhe kërkesave dhe jo për të imituar instrumentet konvencionale apo strategjitë e menaxhimit të rrezikut. Fokusi, pra, duhet të jetë në zgjedhjen dhe strukturimin e produkteve më të përshtatshme, shërbimet dhe mjetet e menaxhimit të riskut, të cilat duhet të përshtaten për nevojat e pothuajse 2.1 miliardë konsumatorëve myslimanë nëpër botë.

Gjëja më e rëndësishme për të gjitha produktet, mjetet dhe aktivitetet e sistemit bankar islam është se ata janë në përputhje me Sheriatin. Shpresa e vetme është se njerëzit përgjegjës për formësimin e së ardhmes së bankave islame kanë parasysh mësimet e krizës aktuale dhe duhet të marrin më të mirën e sistemit bankar konvencional për t'iu përshtatur atyre, si dhe anasjelltas.



Mbulesa

Prof. dr. Ibrahim Sarmësh

Me degjenerimin dhe zvetënimin e shoqërisë, fillojnë të humbasin si vlerat hyjnore, ashtu edhe ato njerëzore. Dhe kur humbasin vlerat, zemrat ashpërsohen, sensibiliteti publik, toleranca dhe mirëkuptimi huajësohen. Benu Israilët, pasi u udhëzuan nën udhëheqjen e Musait (a.s.), filluan të devijonin, deri sa arritën në përdhosjen totale të vlerave. Nëse shprehemi me gjuhën e Kuranit, zemrat e tyre ishin ngurtësuar, madje ishin bërë më të forta se guri. **“Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta. Në të vërtetë, ka gurë nga të cilët burojnë lumenj, ka të atillë që çahen e nga të cilët rrjedh uji, madje ka edhe syresh që rrëzohen nga frika e Allahut. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.”** (El-Bekare, 74)

Edhe popujt arabë para islamit, patën besuar zbulesën e peygamberëve të mëparshëm dhe për një kohë relativisht të gjatë jetuan sipas udhëzimeve. Me kalimin e kohës, u çoroditën dhe iu ngurtësuan zemrat. Si pasojë e kësaj zemërngurtësie, ata arritën deri atje, sa të varrosnin për së gjalli foshnjat vajza.

“Ata i veshin Allahut vajza - i lavdëruar dhe i lartësuar qoftë Ai, - ndërsa për vete kanë atë që dëshirojnë (djemtë). Dhe, kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit, për shkak të lajmit të keq që mori dhe s’di a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhé. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata! (En-Nahl, 57-59)

Allahu u drejtohet me një pyetje retorike hipokritëve dhe atyre që kanë besuar, por që nuk i janë nënshtruar plotësisht vullnetit të Allahut.

“A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së Vërtetës që Ai ka shpallur e të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?! Me kalimin e një kohe të gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan dhe shumë syresh janë të pabindur.” (Hadid, 16)

Kur hedhim vështrimin përreth ambientit apo shoqërisë, pjesë e së cilës jemi, hasim vështirësi në kuptimin e sjelljeve që manifeston shoqëria. Përhapja në masë e intolerancës, fanatizmit, zemërngushtësisë dhe indiferencës në shoqëri, është tregues i qartë i zemërashpërsisë sonë. Fatkeqësisht, kjo tablo është e njëjtë, si për besimtarët, ashtu edhe për jobesimtarët. Në këtë kontekst dëshiroj të trajtoj intolerancën e theksuar që ekziston ndaj mbulesës islame.

Shumica e atyre që kundërshtojnë dhe urrejnë mbulesën islame, janë pasardhës të nënave të mbuluara. Nuk e kuptoj përse ekziston gjithë kjo frikë ndaj mbulesës islame. Përse një vajzë e mbuluar në një shkollë publike shkakton debat të nxehtë nëpër media dhe më gjerë? Ku është humanizmi, liria dhe respektimi i të drejtave të njeriut, që deklamohen aq shumë nga sistemi laik, i cili pretendon se mbron të drejtën e çdo personi, të veshë atë që dëshiron, sidomos kur është fjala për manifestim të fesë? A nuk duhet të ishte i barabartë dhe i paanshëm pushteti laik ndaj qytetarëve të vet, përse i përket lirisë së mendimit dhe mënyrës së jetesës? Ku është sistemi laik, i cili proklamonte me zë të lartë ndërtimin e një shoqërie të bazuar në drejtësi, liri e barazi, ku nuk do të ekzistonte intoleranca dhe fanatizmi? Përse atëherë, gjithë kjo frikë e shoqëruar me urrejtje për vajzat me shami, përderisa nuk cenonë sigurinë apo qetësinë e askujt, për më tepër që janë edhe qytetare me të drejta të barabarta të këtij vendi. Nuk ka asnjë shkak për t’u shqetësuar nga mbulesa islame. E gjithë çështja është në njohjen e të drejtave të njeriut për të gjithë. Nuk është aspak e nevojshme, por as etike të diskutojnë aspektin fetar të mbulesës persona jokompetentë.



KONTEKSTI SHOQËROR-POLITIK DHE KULTUROR-SHKENCOR I SHFAQJES SË FILOZOFISË DHE SHKENCËS NË PERËNDIM

Nexhat Ibrahim

HYRJE

Është e vështirë dhe komplekse të shkruhet fjala e fundit për këtë temë, duke pasur parasysh të gjithë faktorët që e kanë formuar këtë tërësi dhe të gjitha vakuomet dhe errësitat shkencore që ekzistojnë për këtë periudhë kohore.

Përpjekja jonë modeste do të shkojë në drejtim të ndriçimit sado pak të fakteve dhe provave, duke e prezantuar shfaqjen suksesive të filozofisë dhe shkencës në qytetërimin perëndimor, por edhe luftën morale dhe aktivitetet origjinale intelektuale që kanë ndikuar në transformimin më të hollësishëm të shoqërisë perëndimore. Përpjekja do të shkojë edhe në drejtim të konstatimit të pikave konvergjente në trendet bashkëkohore, që kanë ndikuar në shfaqjen e fenomenit të traditës perëndimore filozofike dhe shkencore.

PËRHAPJA E KRISHTERIZMIT NË EVROPËN PERËNDIMORE

Nga fundi i shekullit VII dhe sidomos nga mesi i shekullit VIII, një pjesë e konsiderueshme e Mesdheut erdhi në duar të myslimanëve. Bota kristiane u detyrua të tërhiqej nga bregdeti i Afrikës veriore, nga një pjesë e Italisë jugore dhe pjesa më e madhe e gadishullit Iberik. Duke marrë parasysh se edhe Avarët e sulmuan Evropën nga veriu, pjesë e lirë për shtrirjen kristiane mbeti Evropa qendrore dhe perëndimore. Kjo edhe ndodhi gjatë shekujve V-X.¹ Në fillim të shekullit IX pjesa më e madhe e Evropës hyri në rrethin kristian, kurse Karli i Madh u bë mecen i shkencës dhe artit, duke i trimëruar dijetarët të studionin, të shkollonin dhe të kontribuonin në nënqiellin e tyre.² Në këtë kohë kemi edhe migrime të tjera, si të sllavëve në Ballkan e

1. Kršćanstvo, në: <http://hr.wikipedia.org/wiki/Kr%C5%A1%87anstvo> (7.9.2011). Shih: William H. McNeill, *The Rise of the West* (Upton Zapada) (Chicago: The University of Chicago Press, 2. Izd. 1991.), 441-445.

2. Sipas: http://sh.wikipedia.org/wiki/Karlo_Veliki (7.9.2011). Shih: William H. McNeill, po aty.

Evropë lindore dhe pjesa më e madhe e tyre u kristianizua, madje edhe Anglia dhe Irlanda. Ky dinamizëm i gjurmët e veta në zhvillimin e mëpasëm evropian, por e tërë kjo do të ishte e zbehtë, nëse nuk do të merrej parasysh ekspansioni mysliman në pjesët jugore evropiane apo prania e myslimanëve në kufij me ta.³

Pasi myslimanët morën Afrikën veriore dhe Spanjën, Jugun e Italisë dhe ujdhesat e shumta në Mesdhe, erdhi deri te lulëzimi kulturor dhe qytetërimor në Spanjë.⁴ Këto zhvillime dhe ky konfiguracion i ri do të tregohet vendimtar në transmetimin e dijes në Perëndim. Edhe pse e ngurtë në disa qëndrime (fetare dhe shkencore), Evropa huazoi, përvetësoi dhe modeloi shumë institucione nga Bizanti dhe Islami. Ata nuk u frikësuan t'i përdornin përparësitë myslimane dhe me këtë arritën një siguri frymore dhe materiale, që nuk e kishte pasur Evropa më herët. Kësaj klime të ngritjes dhe përparimit evropian i ndihmoi edhe sukseksi ushtarak dhe politik, duke u shtrirë në vende të reja, si në Afrikë, Azi etj.⁵

TRANSMETIMI I TRADITËS FRYMORE DHE MATERIALE ISLAME

Pas kalimit të traditës shpirtërore dhe shkencore islame në Evropë, kryesisht nëpërmjet përkthimeve, por edhe kontakteve të drejtpërdrejta ushtarake, politike, tregtare dhe misionariste, tradita filozofike dhe shkencore perëndimore fitoi depërtimin vendimtar.⁶ Kjo ndodhi pas rënies në duar të Perëndimit të një pjesë të Spanjës, sidomos të dy qyteteve me rëndësi, Toledos dhe Saragozës.⁷ Kësaj fryme

3. Edvard Xhejms, *Severni svet u srednjem veku*, në: Xhorxh Holms, *Oksordska istorija srednjovekovne Evrope*, Beograd, 1998, fq. 68 e tutje.

4. Rozhe Garodi, *Islami dhe kultura*, Sarajevë, 1990.

5. Karl Grimberg, *Historia botërore dhe qytetërimi*, pjesa 4, Tiranë, 2004, fq. 17 e tutje.

6. Sipas: Haren, 117.

7. Josep Puig, *The Transmission and Reception of Arabic Philosophy*



i ndihmoi edhe humbja e Sicilisë më 1091.⁸ Shumë trashëgimi e shkruar apo materiale ra në duar të perëndimorëve. Evropa filloi t'i përktente këto vlera shkencore e intelektuale. Ndër të parët në këtë punë u dalluan Raymond de Sauvetat, kryepeshkop nga Toledo në periudhën 1126-1151.⁹ Kjo lëvizje e përktimeve u shtri edhe në vendet përreth. Kemi emra të dalluar, si: Herman Dalmatini, Robert Ketenezhani dhe Rodolphusi nga Brizhi¹⁰ etj.

Filozofia (*Falsafa*) ishte preokupimi më i madh i evropianëve. Në këtë rrafsh u dalluan dy qendra kryesore: Toledo, nën udhëheqjen e dy dijetarëve, Dominicus Gundisalvusit dhe Gerardusit nga Kremona. Ky aktivitet bëri që në shekullin XII Evropa ta lexonte në gjuhë evropiane Kindiun, Farabiun, Ibn Sinain, Gazaliun, madje edhe Kurandin në përktimin latin të bërë nga Kettani.¹¹ Ndikimet ishin përmbajtësore, si përktufizimi, klasifikimi i shkencave etj.

INSTITUCIONET ARSIMORE PERËNDIMORE

Si rezultat i ndikimit mysliman në Perëndim, por edhe lëvizjeve të tjera të vetë perëndimorëve, transformimet kaluan edhe në një fushë tjetër, atë të hapjes së universiteteve, që do të bëheshin të njohura, si ai i Oxfordit, më 1190, Cambridgit, më 1209, i Parisit më 1215 etj. Në këto universitete mësohej matematika dhe astronomia myslimane, pastaj filozofia, logjika etj., sipas sistemeve dhe metodave myslimane.¹² Toma Akvini, Roger Baconi, St.

in Christian Spain (until 1200), në: *The Introduction of Arabic Philosophy into Europe*, redaktorë: Charles E. Butterworth dhe Blake Andree Kessel (Leiden: E.J.Brill, 1994), fq. 9.

8. Edward Grant, *The Foundations of Modern Science in the Middle Ages: Their religious, institutional, and intellectual contexts* (Cambridge: Cambridge University Press, 1996), 23.

9. Josep Puig, fq. 10-11.

10. Gjerësisht: Ahmed F. El-Ehwani, *Filozofia islame*, Prizren, 2002, fq. 38-58. Krhs.: Josep Puig, po aty, fq. 11.

11. Josep Puig, po aty, fq. 13.

12. Shih: Charles Burnett, *The Introduction of Arabic Learning into*

Bonaventura dhe Duns Scoti, janë vetëm disa nga emrat më të dalluar të kësaj fryme të universiteteve. Më vonë, më 1257, kemi edhe Sorbonën e njohur.

Ndër shkencat e para që janë studiuar, janë astronomia, matematika, gjeometria, algjebra, por edhe medicina e farmakologjia e, sidomos, veprat e Ibn Sinait.

Mund të thuhet se rezultat të këtyre lëvizjeve kemi edhe fitoren e monarkëve perëndimorë ndaj klerikëve, si në Francë dhe Angli. Kjo bëri që Evropa të forcohej politikisht dhe ekonomikisht. Por Evropa nuk u kënaq me vetveten, kështu që filluan "shëtitjet" edhe jashtë Evropës, të motivuara për zbulim të territoreve të reja, për dominim të ri. Kemi zbulimin e Amerikës, por edhe të shumë vendeve përgjatë botës. Edhe filozofia edhe shkenca, pas kësaj periudhe gjetën një shtysë të re, një elan të ri dhe kjo nuk do të largohet deri në ditët e sotme.

NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Fillimisht, drejtpërdrejt e më vonë tërthorazi, Islami si fe, kulturë dhe qytetërim, ka dhënë kontribut në progresin e gjithanshëm evropian. Edhe pse këtë kontribut e kanë përcjellë shumë paragjykime e goditje, megjithatë te shkencëtarët objektivë evropianë nuk ka munguar sinqeriteti dhe pranimi se Islami është bosht i kësaj ngritjeje kulturore dhe qytetëruese. Mirëpo, deri sa myslimanët shërbyen si model për evropianët, këtë nuk e bënë me vetveten. Duke u dhënë pas luksit dhe interesave jashtëislame, drita e tyre filloi të fikej, kurse Perëndimi e vazhdoi traditën myslimane, e rroku punën dhe dominon për një periudhë të gjatë disashekullore. Ky është faktori kryesor për ngecjen e myslimanëve. Të gjithë faktorët e tjerë janë dytësorë.

British Schools, në: *The Introduction of Arabic Philosophy into Europe*, po aty, fq. 40-57.

Mjeshtëria në punën e myslimanit

Ma. Gilman Kazazi

Një nga problemet shoqërore, me të cilat përballet shoqëria shqiptare, është cilësia dhe mjeshtëria në punë, disiplina dhe edukata në të.

Puna i jep kuptim jetës, krijon vlera dhe është shkak për të fituar të ardhurat. Me anë të punës sigurohet mbajtja e familjes dhe shprehet roli i individit në shoqëri dhe në jetë. Statusi që gëzojnë njerëzit në një shoqëri, është i lidhur në shumë raste me punën dhe profesionin që kanë. Nuk dua të trajtoj llojet e punës dhe as aspektet ekonomike të saj, por mënyrën e të punuarit. A punojmë me profesionalizëm apo shkeleshko?

Të mos harrojmë se shpesh habitemi tek dëgjojmë që dikush krenohet me kulturën perëndimore në punë, me edukatën e punës në Perëndim. Dhe... nuk kujtohem aspak për veten tonë: Ku jemi ne, në çfarë stadi?..

Po Islami, ç'na mëson vallë?..

MJESHTËRIA NË PUNË ËSHTË IBADET

Nëse besojmë se puna hallall është pjesë e adhurimit ndaj Allahut, atëherë duhet të punojmë me seriozitet dhe sinqeritet. Punën e rëndomtë (nëse mund ta quajmë kështu) apo intelektuale, duhet ta realizojmë në mënyrën më të rregullt, më të përpiktë dhe më të saktë. Kultura dhe edukata e punës, mjeshtëria në punë është

pjesë e civilizimit islam, është parim islam, është porosi e Profetit Muhamed (a.s.):

"Allahu e do atë person, i cili, kur kryen një punë, e realizon në mënyrën më perfekte." (Ebu Ja'la.)

Nëse kemi bindjen se "ibadet" është çdo vepër, të cilën Allahu e pëlqen dhe e do, atëherë themi se edhe mjeshtëria në punë është ibadet.

Kjo saktësi dhe mjeshtëri që po kërkojmë, është prej veprave të mahnitshme të Allahut. Hulumtoni Gjithësinë, vështroni hapësirën, shikoni natyrën: a gjeni ndonjë çrregullim?

"...(kjo gjithësi) është mjeshtëri e Allahut, që përsosi çdo send..." (en-Neml, 88)

"I cili krijon çdo send në mënyrë të përsosur." (es-Sexhdeh, 7)

"...ti nuk vëren në krijesat e Mëshiruesit kurrfarë disharmonie dhe shiko edhe një herë nëse sheh ndonjë plasaritje." (el-Mulk, 3)

Mjeshtëria nuk është vetëm cilësi e veprave të Allahut, por edhe virtyt i Profetit Muhamed (a.s.). Aishja tregon: *"Kur i Dërguari i Allahut bënte një punë (ibadet), e përsoste atë në mënyrë të vazhdueshme"*. (Muslim)

MYSLIMANI ËSHTË NJERI POZITIV NË AKTIVITETIN E TIJ

Pjesë e këtij pozitiviteti është ndershmëria dhe saktësia në punë. Islami kultivon në karakterin e myslimanit ndjenjën e përgjegjësisë dhe përsosmërisë në punën e tij. Çdo punë e lejuar e myslimanit bëhet për Allahun dhe në emër të Allahut.

Thuaj: "Namazi im, kurhani im, jeta dhe vdekja ime janë dhe i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!" (el-En'am, 162-163.)

Nëse mësojmë dhe zbatojmë me përkushtim rregullat e namazit, kushtet e abdestit apo çështjet e agjërimin, pse të mos respektojmë me të njëjtin përkushtim edhe edukatën e punës, orarin e punës, saktësinë dhe cilësinë e punës. Kjo mjeshtëri dhe kjo saktësi në aktivitetin dhe punën e besimtarit, nëse buron nga bindja dhe besimi i tij, do ta ruajë atë nga hipokrizia, servilizmi apo syfaqësia. Sa janë ata punëtorë, të cilët respektojnë oraret dhe rregullat e punës vetëm atëherë, kur kanë kamera regjistruese ose vetëm atëherë kur kanë kontrollë nëpër këmbët e tyre.

Vërejmë nganjëherë edhe një fenomen të tillë: disa myslimanë janë të saktë në respektimin e orarit të namazit, por neglizhues në orarin e punës. Janë të rregullt në formën e namazit, por të çrregullt në cilësinë e punëve që kryejnë. Dashuria dhe kënaqësia e Allahut fitohet, jo vetëm me abdest të saktë, por edhe me punë të ndershme dhe me mjeshtëri në punë. "Kijameti do të ndodhë atëherë, kur të humbin emaneti dhe, emaneti do të humbë, kur puna do t'i besohet të paaftit, jo profesionistit." (Buhariu)

Nga kriteret e kërkuara në punë, sipas Kuranit, janë aftësia dhe besnikëria. Në Kuranin Famëlartë përmendet tregimi i H.Musait, nga ku citojmë versetin e mëposhtëm:

"Merre këtë njeri në shërbim, se me të vërtetë, i forti (afti) dhe i besueshmi, është më i mirë për t'u marrë në shërbim". (el-Kasas, 26.)

NE SI MYSLIMANË JEMI TË URDHËRUAR TË BËJMË MIRË

Të bërit mirë nuk ka vetëm kuptimin e të ndihmuarit

të një hallexhiu apo fukaraje. Të bërit mirë ka kuptim: realizimin e një vepre në mënyrën më të mirë, me bindjen se Allahu të vështron dhe të vëzhgon në realizimin e saj.

"...dhe bëni mirë. Allahu njëmend i do punëmirët." (el-Bekara, 195.)

"...Adhuroje Allahun, sikur ta shohësh Atë, edhe pse në realitet nuk e sheh, Ai të sheh ty." (Buhariu dhe Muslimi.)

"Me të vërtetë, Allahu e ka obliguar të bërit mirë (mjeshtërinë) në çdo gjë... saqë, edhe kur të prisni kurban, priteni në mënyrën më të mirë, më perfekte." (Tirmidhiu)

Paramendoni nëse në prerjen e bagëtisë lypset mjeshtëri (me kuptim: të tregohesh i mëshirshëm dhe të mos e mundosh atë), vepër e cila përsëfundi, nuk ka ndikim negativ në jetën shoqërore dhe mund të realizohet sido që të jetë e mundur. A thua vallë, në punët dhe profesionet tona, që janë të lidhura ngushtë me ecurinë dhe zhvillimin e jetës shoqërore, nuk duhet të tregohemi profesionistë dhe mjeshtër?.. Nuk duhet të tregohemi të përgjegjshëm dhe seriozë?.. Aq më tepër, le të mendojmë pak se me neglizhencën dhe mosseriozitetin në punën tonë, mund t'i bëjmë dëm dikujt tjetër, mund të mashtrojmë pronarin, qytetarin apo klientin. Kjo nuk është e gjitha. Në radhë të parë, i bëjmë dëm vetvetes, të ardhmes sonë, karrierës sonë dhe, ajo që është më e rëndësishme, shpirtit tonë. Kjo është thelbësore.

"Nëse veproni mirë, e bëni për vete, e nëse bëni keq, përsëri e keni kundër vetes suaj." (el-Isra', 7.)

"O njerëz! Me të vërtetë, padrejtësia që bëni, vetëm juve ju dëmton." (Junus, 23.)

"...por dinakëria (dredhia e keqe) nuk godet tjetër, vetëm ata që e kurdisën ..." (Fatir, 43.)

Ndaj, lypset që parimet islame t'i reflektojmë në jetën e përditshme; pra, që do të thotë: të mos i pranojmë vetëm me fjalë, por t'i zbatojmë me vepra. Kjo lidhje fjalë-vepër dhe zbatueshmëria e këtij binomi, i jep myslimanit vlerën e virtytit dhe njëkohësisht, jo vetëm i përkthejmë nga arabishtja në shqip, por "i përkthejmë" edhe nga njohuria në realitet.





Abdurrahman Xhandan

KAMATA dhe shoppingu

Sot, në kohët moderne, ndërkohë që mania për të shpenzuar është shtuar në një mënyrë marramendëse, ndjenjat si vetëmjaftueshmëria janë bërë pjesë e rafteve të harruara. Aq sa, njeriu sot nuk shpenzon vetëm paratë që i ka në duar, por edhe ato që nuk i ka. Veçanërisht kreditë e bankave, sikur po i dhurojnë ato shuma dhe shpenzimet e papërmbajtura të njeriut që nuk arrin ta kontrollojë veten, janë bërë shkak për shumë njerëz që familja e tyre të shpërbëhet dhe të vetëvriten. Në letrën 102, Imam Rabani u drejtohet atyre sufive që bëjnë shpenzime me kamata dhe që justifikohen me gjendjen emergjente që kanë:

Miku im! Kamata është e ndaluar në mënyrë kategorike, qoftë për atë që nuk ka nevojë, qoftë edhe për atë që ka nevojë. Përrjashtimi nga kjo ndalesë i atyre që kanë nevojë, është një tendencë për të abroguar Kuranin. (Letra 102.)

Të gjithë dijetarët myslimanë kanë rënë dakord se kamata është e ndaluar. Fatkeqësisht, duke u bazuar në gjykimin

*"Detyrimet legjitimojnë ndalimet", disa dijetarë kanë dhënë leje për praktika me kamata në raste nevojash. Por ka dallim mes, të jesh i detyruar dhe të kesh nevojë për diçka. Por, Imami kritikon dijetarët, pa vënë në dukje këtë dallim. Sipas tij, duke u nisur nga ajete, si **"Por kushdo që është i shtrënguar nga uria (dhe ha çfarë është e ndaluar), pa pasur qëllim të bëjë gjynah, do ta shohë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë."** (Maide, 3.), nuk duhet të arrijë në praktikën e të lejuarit të gjërave të ndaluara. Ajeti lejon ngrënien e një pjese të vogël nga mishrat e ndaluar, vetëm në raste përballjeje kritike me shëndetin, si uria e tejskajshme apo përballja me vdekjen. Nëse korniza e lejimit mbahet e gjerë, pra, nëse merret hua me kamata për një nevojë të vogël, atëherë neglizhon dhe pranon si të dala nga funksioni ajetet që e bëjnë të ndaluar kamaten.*

Marrja e huasë me kamata e nevojtarit është e mundur vetëm në raste kur nuk është e ndaluar. Përndryshe, çdokush që pranon për të paguar me kamata borxhin, nuk pranon diçka

që është në dëm të vetes së vet, pa pasur nevojë për të.

Për shembull, edhe nëse pranohet diçka e përgjithshme si nevojë, unë them që nevoja është vetëm në raste të detyruara. Dhe kur është e detyruar, përdoret vetëm aq sa është e detyruar. (Fjala vjen), ai që merr hua me kusht kamatën, nuk është e nevojshme të ushqejë njerëzit. Pasi kjo gjë nuk ka ndonjë lidhje me detyrimin.

Këto fjalë të Imamit, praktikohen në mënyrë të njëjtë në ditët e sotme. Shumë njerëz sot qerasin mikun e tyre në restorante me kartë kredit, pastaj këto borxhe i shlyejnë me interes të lartë. Sipas Imamit, edhe nëse bëhet me qëllim ibadeti, nuk është i lejuar një veprim i tillë. Kur ndërron jetë ndonjëri, nga pasuria e tij nxirren të ardhurat për qefinin dhe proceset e xhenazes, të tjerat u lihen trashëgimtarëve. Edhe për njeriun që ka ndërruar jetë, që ka nevojë më shumë se secili madje, nuk ushqehen mysafirët pa pëlqimin e trashëgimtarëve. (Letra 102.)

Këto detaje të bukura nuk vihen re as nga njerëzit me botë shpirtërore. Meqë është i zbutur interesi, edhe duke pasur pasuri në gjendje, njerëzit blejnë me kredi makinë luksoze, apartamente apo gjëra të tjera. Imam Rabani nuk i sheh aspak të lejuara gjëra të tilla. Madje edhe gostitë që shtrohen duke përdorur borxhe të tilla me kamatë, i konsideron si larg fesë islame. Kjo gjë, sot vërehet veçanërisht në banketet e shtruara për dasma.

Gositë apo rastet e tilla të mëdha janë një mundësi hileje për t'u konsideruar si të nevojshme. Andaj dhe të marrësh hua me kamatë dhe të pranosh se kjo gjë është e lejuar, është larg fesë. Atyre që i bëjnë këto gjëra, u duhet shpjeguar e keqja e këtij veprimi, në kuadër të formulës islame "të ndalosh nga e keqja dhe të këshillosh për mirë".

Imam Rabani u tërheq vërejtje veçanërisht atyre që e kanë bërë si mënyrë fitimi kamatën. Ai u shpjegon atyre se rrugët e rrishtit janë të shumta, nuk është vetëm rruga e kamatës. Megjithatë ka shumë qëndrime skeptike lidhur me kamatën, Imami këshillon që myslimanët të largohen nga kjo vepër. Edhe nëse një besimtar nuk heq dorë nga ajo, të lejuarën duhet ta pranojë si të lejuar dhe të ndaluarën si të ndaluar. Pra, njeriu të mos dalë nga feja duke pranuar si të lejuar veprimet me kamatë.

Fatkeqësisht, sot shumë njerëz po e humbasin këtë hollësi. Po e konsiderojnë kamatën si një burim jetese. Sikur dikush t'u thoshte se është i ndaluar një veprim i tillë, do të kthenin përgjigje të nxehur dhe me gjykime të djallëzuara: "E ç'ka këtu? Unë nuk po ia vjedh ndokujt tjetër. Paranë time po vë në lëvizje.". Madje, ngaqë disa imamë në xhamitë e tyre kanë shpjeguar për ndalimin e kamatës, disa nga xhemati janë ankuar tek eporët e imamëve. Ata

që veprojnë në këtë mënyrë, janë në një gjendje mjaft të rrezikshme. Disa miq më thanë se një ditë Mevlana Abdulfettah ka thënë: "Është bukur të marrësh hua pa kamatë. Atëherë, përse njerëzit marrin huanë me kamatë?" Ndërsa ju qenkëshit hedhur menjëherë: "Mos e mohoj të lejuarën!" Miku im! Ti këtë fjalë mund t'ia thuash vetëm njërit që mohon një të lejuar të padiskutueshme. Kurse veprimet që dyshohet rreth lejimit apo moslejimit të tyre, duhen braktisur. Njerëzit e devotshmërisë nuk japin leje të tilla. Përkundrazi ata gjithnjë vetëm lartësimin dëshirojnë.

Me këto fjalë, imami këshillon veçanërisht rrugëtarët e devotshmërisë, që të mos bazohen në fetvatë që tolerojnë një gjë të tillë të dyshimtë. Po ashtu, imami kritikon edhe ata që i japin leje një praktike të tillë, duke e justifikuar si një nevojë të kohës:

Dijetarët e Lahor-it kanë dhënë fetva për lejimin e një veprimi të tillë, me shkak nevojën. Ajo çfarë përfshin nevoja është aq e gjerë, saqë, po ta zgjerojmë edhe pak, s'mbetet as kamata. Ashtu sikurse shënova edhe më sipër, atëherë edhe vendimi që ka gjykuar si të ndaluar, del si i pakuptimtë dhe i kotë. Në fakt, këtë duhet ta mendonin dijetarët, cilit parim i përket përdorimi i huasë me kamatë, me qëllim që të ushqejë tjetrin? Nevojtar i ka të lejuar të ushqejë tjetrin duke bërë bijet një zotim kefaret apo diçka të ngjashme. Nevojat me orientime fetare të tilla, zhduken me begatinë e sado pak mendimi dhe devotshmërie. Andaj dhe Allahu i Madhëruar, thotë: "Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t'i japë risk prej nga nuk e pret." (Talak, 2-3.)

Kjo frikë e Imamit në ditët e sotme është realizuar tërësisht. Aq sa, disa myslimanë pretendojnë të afrohen tek Allahu duke bërë kurban me kredi. Faktikisht, ai që nuk ka mundësi, nuk e ka të detyruar të bëjë kurban. Sikur njerëzit të mendonin sado pak, shumë gjëra që duken si të nevojshme, do t'i kuptojnë se në të vërtetë nuk janë nevojë dhe do të mjaftoheshin me atë që kanë të lejuar.

Këto këshilla të Imamit, duhet t'i varim vath në vesh, si domos gjatë këtyre ditëve që gjithçka duket me bazament paranë dhe duhet të përpiqemi të mbrojmë nga kjo fatkeqësi njerëzit e familjes, miqtë dhe të gjithë myslimanët. Për t'i përballur nevojat tona me gjërat më të lejuara, duhet të krijojmë zgjidhje të përshtatshme, si dhënia e *karz-i hasenit* (dhënia e ndihmesës për besimtarë, pa kamatë). Përndryshe, edhe ne mund të marrim pjesë në gjynahun e atyre që praktikojnë kamatën.

Allahu i madhëruar na ruajtë të gjithëve nga fatkeqësia me emrin kamatë.

Amin!





Martesa

pothuajse një

rekulli

Xhafer Durmush



Po lexoj suren er-Rrum, buqetën e ajeteve, e cila konsiderohet prej argumenteve që tregojnë fuqinë hyjnore...

Në këtë sure ka shtatë ajete, që fillojnë me shprehjen “ve min ajatihi”. Të gjitha këto ajete na ftojnë në klimën e një meditimi të veçantë. Në njërin prej tyre thuhet:

“Dhe njëra prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (Rrum, 21)

I ndjeri Omer Nasuhi Bilmen e shpjegon kështu ajetin fisnik, i cili përbën temën tonë: “Njëri prej argumentave se Zoti do t’i ringjallë përsëri robërit e tij dhe do t’i shpjerë në botën e shpërblimit, është fakti se Ai ka krijuar gjëra me të cilat ata gjejnë qetësi dhe ndërmjet tyre ka vendosur dashurinë e mëshirën.”

Ajeti fisnik inkurajon të menduarit mbi familjen në aspektin e formimit dhe të funksionimit të saj.

Edhe pse në Kuranin Fisnik thuhet se edhe krijesat e tjera janë krijuar çift (el-En’am 6/143.), aty nuk bëhet fjalë se ndërmjet tyre është vendosur dashuri dhe respekt. Domethënë se Allahu i Madhëruar e ka bekuar lidhjen bashkëshortore ndërmjet njerëzve me ndjenja të larta, si dashuria, besnikëria dhe mëshira. Ajo nuk është e lidhur vetëm me dëshira dhe pasione. Nisur nga kjo, dëshiron që bashkimin ndërmjet tyre ta bëjnë me një lidhje të shenjtë,

e cila quhet martesë. Kështu që, dashuria dhe mëshira, së pari arrin ata të cilët e kanë formuar vatrën e tyre me dashuri dhe mëshirë.

Allahu i Madhëruar dëshiron që kjo lidhje të begatohet me brezat që do të vijnë pas tyre. Ai dëshiron që nga kjo lidhje të lindin fëmijë, të cilët do të fitojnë lumturinë e të dy botëve dhe të formohen civilizime, të cilat mbështeten në dashuri dhe mëshirë. Sepse, sikur të mos ishin këto ndjenja të larta bashkë me faktorët materialë që i bëjnë njerëzit tërheqës për njëri-tjetrin, do të shtoheshin brezat e njerëzve, por nuk mund të formoheshin civilizimet.

Si domosdoshmëri e urtësisë hyjnore, njeriu nuk është krijuar në një lloj të vetëm, por përkundrazi, ai është nxjerrë në ekzistencë si bashkëshort i barabartë me tjetrin. Edhe pse zhvillohet dhe rritet me këtë formulë bazë, ai është krijuar në dy lloje me veçori të ndryshme fizike, me strukturë psikologjike të ndryshme dhe me ndjenja e dëshira të ndryshme.

Ndërmjet burrit dhe gruas ka vendosur një harmoni në mënyrë që të jenë dy bashkëshortë, të cilët e plotësojnë njëri-tjetrin si dy gjysmat e mollës. Nevojat fizike dhe psikologjike të njërit, plotësohen me veçoritë e tjetrit.

Bashkimi i njerëzve me njëri-tjetrin fillon me një lëvizje, e cila së pari lind në zemër. Këta sythe të miqësisë që çelin aty, lidhet me aktin e martesës gjë, e cila do të thotë: Dy të pjekur, të cilët janë rritur në vende të ndryshme, vendosin të jetojnë me njerëz të tjerë në një vend ndryshe nga

mjedisi ku janë rritur. Një njeri, i cili më parë konsiderohej i vogël, tashmë hyn në gjendjet private të tjetrit dhe në këtë kuptim kalon para prindërve.

Nga njëra anë, ai vendos të largohet nga shtëpia në të cilën është mësuar të jetojë deri atë ditë. Më së paku, ai vendos të marrë përsipër përgjatë gjithë jetës shërbimet personale të një personi. Tjetri vendos që, më së paku, të mbartë përgjatë gjithë jetës përgjegjësitë materialo-shpirtërore të një njeriu. Për shkak të dashurisë që Allahu ka vendosur në zemrat e tyre dhe e cila në fund synohet që të kthehet në mëshirë, dy njerëz marrin mbi supe përgjegjësi të mëdha.

Substancat prej të cilave është krijuar njeriu janë xhevahire të vdekura që gjenden në tokë, si karboni, sodiumi dhe kalciumi, por në trupin e tij janë vendosur aftësi si ndjenjat, ndërgjegjja dhe fuqia e të imagjinuarit. Po ashtu, ai nuk është një njeri i tipit të vetëm, i krijuar me një fuqi që t'i mbartë këto veçori prej substancave të pashpirta. Nga i njëjti njeri është krijuar edhe pala tjetër dhe këtyre grimcave të vogla që nuk shikohen me sy, u janë dhënë aftësi që ne nuk ua dimë natyrën.

Nëse kuptohen drejt gjërat delikate, për të cilat bëhet fjalë në ajetin që përbën temën tonë dhe, nëse përdoret në vendin e duhur energjia e njeriut, e cila është e stolitur me aftësi, si mendja, gjykimi, fuqia e imagjinatës dhe të kuptuarit, të gjitha këto kthehen në dashuri në fund të dëshirave. Bashkimet, që në fillim bëhen për shkak të dashurisë së madhe, me kalimin e kohës mund të kthehen në një klimë shpirtërore në të cilën sundon mëshira. Pastaj nga aty, ndiqet një rrugë, e cila të shpie në lumturinë e përhershme.

Në Ruhul-Bejan shkruan se në ajetin fisnik bëhet fjalë për martesën dhe përputhjen e shpirtit me nefsën, sepse Allahu i Madhëruar e ka krijuar nefsën (veten e njeriut) nga shpirti dhe në këtë mënyrë është bërë bashkudhëtare e tij. Siç e ka krijuar Havanë nga Ademi dhe e bëri bashkëshorte të tij, edhe nefset i ka bërë bashkëshorte të shpirtit, që të gjejnë qetësi te ato. Për këtë arsye, Havaja nuk iku nga Ademi në xhenet. Sikur nefsi të mos ishte krijuar nga shpirti, shpirti i cili është i butë dhe i bukur, nuk do të gjente qetësi te ajo."

Nëse mendojmë për miqësinë, mund të themi: Me kalimin e kohës bashkëshortët ushtrohen me njëri tjetrin, ndërsa shpirti ushtrohet me trupin. Për këtë arsye, ndarja e shpirtit nga trupi dhe ndarja e bashkëshortëve nga njëri-tjetri, është gjithmonë pikëlluese. Ndoshta këtë mund ta shpjegojmë me epërsinë që mëshira ka ndaj dashurisë. Nisur nga kjo, akti i martesës, i cili i bën bashkëshortë dy njerëz, është një hap madhështor i hedhur drejt së ardhmes, në emër të mbrojtjes dhe të lartësimit të nderit

të njerëzisë.

Mendon: Dy njerëz që më parë përmendeshin duke e lidhur emrin me prindërit e tyre, për shkak të kësaj, vijnë në një gjendje që brezi tjetër tashmë lidhet me ta. Me të vërtetë, bashkimet, që kanë pjesë nga Tevhidi kalojnë më me lehtësi nga dashuria në mëshirë dhe vatrën, të cilat formohen brenda kësaj kornize, formojnë bërthamën e bereqetshme të shoqërisë.

H. Pejgamber, sallallahu alejhi ve sellem, thotë: "Mirësinë më të madhe, pas devotshmërisë, besimtari e ka te gruaja e devotshme." (Ibn Maxhe, Nikah, 5/1857.)

Mirësia dhe begatia, për të cilat bën fjalë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), është e qartë se i përkasin çdo burri dhe çdo gruaje që e meriton cilësinë e devotshmërisë.

Populli ynë e ka formuluar me fjalën "në martesë ka mrekulli", përmbajtjen e praktikimit të këtij ajeti. Shoqëritë, të cilat nuk e dinë vlerën e mrekullisë, shihet qartë se në çfarë batakut janë zvarritur.

Të pastërtit janë për të pastërtit

Allahu i Lartësuar, thotë: "**Gratë e këqija janë për burrat e këqinj. Burrat e këqinj janë për gratë e këqija. Gratë e pastra janë për burrat e pastër. Burrat e pastër u kanë hije grave të pastra...**" (en-Nur 24/26.)

Këtë ajet fisnik, i cili ka zbritur në lidhje me ngjarjen e ifkut, në suren en-Nur, po përpiqem ta kuptoj brenda tërësisë së Kuranit Fisnik. Vëmendjen time po e tërheq sugjerimi që u bëhet besimtarëve për të qenë konsequentë ndërmjet tyre dhe për të qëndruar me të drejtët (Shik. Et-Tevbe 9/119.) në Kuranin Fisnik me disa kriterë që nuk e lejojnë miqësinë me çifutët dhe me kristianët. (Shik. El-Maide 5/51.) Pastaj po mendoj për të vërtetën madhështore që ka thënë i Dërguari i Allahut:

"Shpirtat janë si ushtri të rregullta." Me këtë, ai tregon se çdo njeri do ta kërkojë dhe do ta gjejë atë që i përshtatet atij.

Besimtari duhet të pastrohet që ta meritojë cilësinë "i pastër" dhe të pastrit patjetër duhet të kërkojnë të pastrit.

Roba mbron trupin, njeriu mbron njeriun.


Në suren el-Bakara, për të treguar pozitën që kanë bashkëshortët ndaj njëri-tjetrit, thuhet: "**Ato janë (si) petk për ju dhe ju jeni (si) petk për to.**" (el-Bakara 2/187.)

Roba e mbron njeriun nga i nxehti, nga i ftohti, nga disa rreziqe të tjera dhe nga sytë e këqinj. I mbulon vendet e turpshme. Të gjitha këto janë nga një shembull për çështjen që u diskutua.

Mbrojtja e njeriut ndaj njeriut është aq e madhe, saqë nuk mund të krahasohet me atë të rrobave.

Ndërmjet burrit dhe gruas ka vendosur një harmoni në mënyrë që të jenë dy bashkëshortë, të cilët e plotësojnë njëri-tjetrin si dy gjysmat e mollës.





FOTOJA E MUVAJIT

FESTIMI I MEVLUDIT
NË SHKODËR, SH. PICI 1937



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshurshmit, Mëshurplotit!*

“A mos vallë ti (o Muhamed), do ta shkatërrosh veten, ngaqë ata (banorët e Mekës) nuk duan të besojnë?” (Shu'ara, 3)

Koncepti i përgjegjësisë i sjell ndërmend çdo njeriu normal, thjesht një ndjenjë apo cilësi morale. Por, kur bëhet fjalë për përgjegjësinë e një peygamberi, duhet të jemi të vetëdijshëm se po flasim për një koncept shumë më specifik. Sepse përgjegjësia peygamberike është një gjendje që nuk mund ta përjetojnë të tjerët dhe, për pasojë, është e vështirë të perceptohet një përgjegjësi e tillë, e ngarkuar nga vetë Krijuesi i gjithësisë. Pra, siç është zbuluesja një e fshehtë midis Allahut dhe peygamberëve, e cila është e pamundur të kuptohet nga ne, ashtu edhe përgjegjësia profetike është enigmë për ne. Nga kjo pikëpamje, mund të themi se peygamberët janë të vetmit që e përjetojnë këtë gjendje. Njerëzit e tjerë vetëm mund t'i ndjekin ata, duke u përpjekur t'u ngjasojnë peygamberëve. Por Kurani dhe Hadithi na japin disa informacione për Peygamberin (a.s.), të cilat janë si një dritare për botën e brendshme të Peygamberit, që hapet për ne. Këto informacione janë shumë të rëndësishme për të kuptuar botën e brendshme të Peygamberit. Por cili ishte burimi i përgjegjësisë Peygamberike? Kur i hedhim një vështrim Kuranit, vëmë re se Allahu e cilëson vahjin (zbuluesin) si “fjalë të rëndë”, së pari, sepse vjen prej Krijuesit të gjithësisë dhe, së dyti, ishte një detyrë me përgjegjësi dhe vështirësi të mëdha. Ajetetë ndryshe e dëshmojnë qartë ndjenjën e madhe të përgjegjësisë së Peygamberit (a.s.), përgjegjësi kjo, e shoqëruar nga këmbëngulja dhe vazhdimësia për të përmbushur detyrën.

Mbas vdekjes së Muhamedit (a.s.), përgjegjësinë e përcimit të mesazhit islam në katër anët e botës, e morën sahabët, shokët e edukuar nën kujdesin e Tij.

Ndjenja e përgjegjësisë, që përjetonte Peygamberi (a.s.), ishte krejt ndryshe, sepse Ai shikonte atë që nuk e shikonin dot të tjerët, siç e konfirmon edhe vetë në hadithin: “*Sikur të dinit atë që di unë, do të qanit shumë dhe do të qeshnit pak.*” Ai e dinte shumë mirë se ç'do të thoshte të gjykohehe nga Allahu. Ishte shumë i përgjegjshëm për misionin e vështirë, të cilin nuk e mbajti dot as qielli, as toka, por që e pranoi njeriu. Ai ishte gjithmonë i shqetësuar për umetin e Tij, sepse në ditën e gjykimit do të jetë dëshmitar për ta. Një here, kur Abdullah ibn Mesudi po lexonte Kuran dhe arriti tek ajeti: “**Ditën kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga gjiri i tyre, Ne do të të sjellim ty (Muhamed) dëshmitar kundër këtyre. Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.**” (Nahl, 89) Peygamberi (a.s.), filloi të qante me dënesë.

Si rrjedhojë e kësaj përgjegjshmërie të lartë, fjalët e fundit të Peygamberit në hutben e lamtumirës, ishin: “A përçova mesazhin? O zot, ji dëshmitar.” Në të vërtetë, këtë pyetje Ai ia bënte vazhdimisht vetes, sepse e shqetësonte pa masë plotësimi siç duhet i detyrës. Sa herë që njerëzit mohonin mesazhin e Allahut, Ai bënte përgjegjës veten e tij. Dallimi ndërmjet Tij dhe ndjekësve të Tij të mëvonshëm, është se Ai mbajti veten përgjegjës për çdo gjë, kurse umeti mbajti përgjegjës të tjerët jo veten. Ai punoi pa pushim për ta kryer me përsosmëri detyrën e ngarkuar. Me këtë, na mësoi se çfarë do të thotë të sakrifikohe veten për njerëzimin. Ne, si besimtarë bashkëkohorë, duhet të rishikojmë pozicionin tonë përballë kësaj përgjegjësie të madhe që kemi marrë për sipër.

Një Hadith

*Transmetohet nga Abdullah Ibn Mesudi (r.a.)
se Resulullahi (s.a.v.s.) i ka pyetur shokët:*



*“Cili prej jush do më shumë pasurinë e trashëgimtarit, sesa pasurinë e vet?
Të gjithë me një gojë, thanë:
- Pasurinë tonë e duam më shumë se çdo gjë tjetër.
Atëherë, Pejgamberi (a.s.), tha:
- Pasuria juaj është ajo që shpenzoni në rrugë të Allahut, kurse pasuria që mblihdni, është e trashëgimtarëve.”*

Njerëzit shfaqin sjellje të ndryshme, për sa i përket shpenzimit të pasurisë së tyre. Dikush e dhuron pasurinë për bamirësi, dikush tjetër e shpenzon vetëm për familjen e tij, duke treguar kopranci në shpenzimin e saj për bamirësi. Siç dëshmon edhe Kurani, njeriu joshet shumë nga pasuria e kësaj bote. Për këtë arsye, një njeri që nuk ka marrë edukatë hyjore, pandeh se pasuria e kësaj bote është e përjetshme dhe përdor çdo lloj mjete për ta pasur atë. Por në fakt, çdo lloj pasurie mbetet në këtë botë.

Ajo që dihet në mënyrë kategorike, është se të gjithë do të vdesim dhe asnjëri prej nesh nuk do ta marrë pasurinë me vete në botën tjetër. Gjithë pasuria që mundohemi të mbledhim në këtë botë, u mbetet trashëgimtarëve. Nëse pasuria e fituar nuk shpenzohet në vendin e duhur, atëherë e gjitha do t’u mbetet trashëgimtarëve, që nuk dihet si do ta shpenzojnë.

Ajo pasuri që shpërndahet për bamirësi, rezervohet për në ditën e gjykimit si dëshmitare në favorin tonë. Të parët tanë, duke qenë të vetëdijshëm për këtë, garonin më njëri tjetrin për të bërë bamirësi dhe, si pasojë e kësaj gare, janë dhuruar me mijëra vakëfe në shërbim të njerëzve.

Ai që e do pasurinë e vet, e merr me vete dhe e vetmja mënyrë për ta marrë me vete në jetën tjetër, është ta japësh në rrugë të Allahut në këtë botë.

Gjithësecili prej nesh duhet të bëjë diçka për të dërguar mall në botën tjetër, qoftë edhe në sasi të vogla, sepse sasia e vogël, por sinqeriteti i pastër, sjell shpërblim të madh. Mirësia e njeriut kuptohe kur jep diçka nga vetja, sado e vogël qoftë.

Pengesa më e madhe për të dhuruar për bamirësi, është frika e varfërisë dhe kjo vjen si pasojë e besimit të dobët.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Ai që e do pasurinë, e merr me vetë në botën tjetër, duke e përdorur për bamirësi në këtë botë.
2. Nuk është një sjellje e mençur të mbledhësh mall vetëm për trashëgimtarët.
3. Hadithi na nxit të përgatisim me sa të kemi mundësi diçka për botën tjetër.



Nga morali shembullor i të dashurve të Allahut

TA NJOHËSH SHPIRTËRISHT PROFETIN (A.S.)

Një asket pyet një njeri të urtë:

“Kush është më i madh, Xhunejd Bagdadi apo Bejazid Bistami?”

I urti përgjigjet:

“Për të përcaktuar se kush është më i madh prej këtyre dy robërve të dashur të Allahut, duhet të jesh më i madh prej tyre...” (Ahmed Eflaki, Menakibu’l-Arifin, II, 225.)

Mendjet e cekëta, nuk mund ta kuptojnë kurrë ashtu siç duhet horizontin e urtësisë së të dashurve të Allahut. Përderisa mendja njerëzore është e paaftë të kuptojë urtësinë e të dashurve të Allahut, si mund ta kuptojë vlerën madhështore të Habibullahut?..

Vallë, sa kanë mundur ta shprehin Muhamedin (a.s.), librat e sires, që janë shkruar me mundësitë e kufizuar të fjalëve?! Mbi të gjitha, kur çdo kalem që ngrihet për të treguar atë, është i fuqishëm aq sa dashuria në zemrën e të zotit...

HAPËSIRA E PAFUNDME SHPIRTËRORE

Në kohën kur Mevlana Xhelaledin Rumi po u mbante ligjëratë nxënësve të tij, Shemsi Tebrizi i bëri një pyetje të çuditshme, me qëllim që ta sprovonte:

“Kush është më i madh Bejazid Bistami apo Muhamed Mustafai (a.s.)?”

Mevlana, i shokuar nga kjo pyetje, i përgjigjet me ashpërsi:

“Ç’është kjo pyetje e çuditshme?! A mund të krahasohet një profet madhështor, i dërguar si mëshirë për gjithë njerëzimin me një veli, pasuria dhe frymëzimi shpirtëror i të cilit vjen prej tij (profetit)!?”

Shemsi Tebrizi, pa e prishur qetësinë, e shpjegon kështu pyetjen e tij:

“Atëherë, përse Bejazidi kërkoi prej Allahut që ta hidhte në Xhehenem dhe t’ia rriste trupin aq shumë, sa të mos ngelte vend për gjynahqarët, por, sapo doli përballë një shfaqjeje të vogël hyjnore, tha: “Sa madhështor që jam! E madhëroj veten time!..”. Ndërsa Profeti (a.s.), ndonëse ishte dëshmitar i shfaqjeve të panumërta hyjnore, me një modesti të pashoqe, duke mos u mjaftuar me gradat e larta shpirtërore që kishte arritur dhe duke falënderuar gjithmonë, kërkonte, kërkonte dhe vazhdimisht kërkonte më shumë, me dëshirën e madhe për të qenë sa më afër Tij (Allahut)?..”

Ky shpjegim e mbështet Xhelaledin Rumiun në kufirin e dijeve të dukshme, që ndriçojnë vetëm mendjen. Duke qëndruar në këtë pikë, është e pamundur t’i përgjigjesh kësaj pyetjeje. Me një kontroll shpirtëror, Shemsiu e orienton atë në një pikë më të largët, sepse përtej botës së dukshme, ekziston një “botë e fshehtë”, pa anë e pa kënd. Në këtë mënyrë, me shpejtësinë e një rrufeje, Shemsiu e shëtit bashkëfolësin e tij drejt thellësive të horizontit shpirtëror në të cilin gjendet në mënyrë të pavetëdijshme.

Megjithëse nën ndikimin e kësaj ndodhie të papritur, Mevlana jep me lehtësi një përgjigje, sikur të ishte një nga mësimet e dijeve të dukshme, që e kishte mësuar përmendsh më parë:

“Fjala e Bejazidit, «Sa madhështor që jam! E madhëroj veten time! Unë jam sulltani i sulltanëve!..», është një shprehje e gjendjes së ngopur shpirtërore. Pra, etja e tij shpirtërore ishte shuar me një shfaqje hyjnore shumë të vogël. Madhësia e oqeanit ishte e pafundme, në krahasim me hapësirën e tij shpirtërore të kufizuar. Për këtë

arsye, shpirti i tij u ngop me një shfaqje të vogël dhe ra i velur. Ndërsa mendja e tij doli jashtë botës së saj.”

Për sa i përket Profetit (a.s.), atij i ishte treguar e fshehta, “elemneshrah leke sadrake” (el-Inshirah, 1) Me gjithëse shfaqjet hyjnore e rrethonin nga çdo anë, zemra e tij kishte gjerësinë e kozmosit dhe nuk tundohej lehtë. Për këtë arsye edhe shfaqjet e panumërta hyjnore nuk mjaftonin për të shuar ashkun e tij, por përkundrazi, etja i shtohej edhe më tepër. Ai dëshironte që në çdo çast të ishte gjithmonë e më pranë Zotit të tij. Çdo moment ngrihej nga një gjendje në tjetrën dhe në çdo ngritje bënte teube (pendohej) për gjendjen e mëparshme duke thënë:

“O Zot! Nuk munda të të njoh ashtu siç duhet dhe ashtu siç të takon... Nuk munda të të adhuroj ashtu siç e meriton...” (Munavi, Fejzu’l-Kadir, II, 520.)

Ja pra, Mevlana i nderuar i kaloi kufijtë e dijeve të dukshme duke u pjekur në shfaqjet e këtyre të fshehtave dhe urtësive. Ai u bë prej velive të mëdhenj, prej gojës së të cilëve, nën atmosferën shpirtërore dhe me dashurinë profetike, gurgulluan dhe rrodhën burime urtësie.

NËSE E KE VELIUN TË TILLË

Vajza e Sulltanit Selçuk, njëkohësisht edhe nxënësja e Mevlanës së nderuar, Gyrxhy Hatun, e dërgon piktorin më të famshëm të sarajit tek Mevlana, me qëllim që të pikturonte portretin e tij në mënyrë të fshehtë. Piktori i brengosur shkon pranë Mevlanës dhe i tregon gjithçka. Ndërsa Mevlana, duke buzëqeshur i thotë:

“Nëse mundesh, bëj atë që të është urdhëruar dhe ashtu siç dëshiron!”

Piktori filloi të pikturonte, por, kur përfundoi, vuri re se imazhi i vërtetë i Mevlanës nuk përngjante aspak me atë që ai kishte pikturuar. Kështu që, filloi ta pikturonte nga e para. Ai shpenzoi njëzet fletë duke u munduar të pikturonte Mevlanën, por gjithmonë pa sukses. Më në fund, e kuptoi se nuk mundej më dhe u detyrua të hiqte dorë nga kjo punë. (Këto piktura gjenden edhe sot në muzeun e Mevlanës.)

Kjo ndodhi, zgjon shpirtin e piktorit dhe e zhyt atë në mendime të thella, duke e bërë atë një shëtitës të botës së shpirtit. Më në fund, në zemrën e piktorit hapet një dritare, prej së cilës zhytet në përfytyrimin e Profetit tonë të dashur (a.s.) dhe nga gjuha e tij rrjedhin këto fjalë:

“Nëse është i tillë veliu i një feje, kush e di se si është profeti i saj?..”

ËSHTË PËRFAQËSUES I DENJË I DËRGUESIT!

Gjatë një ekspedite ushtarake, Halid bin Uelidi (r.a.), kalon natën tek një fis mysliman. Kryetari i fisit e pyet:

–A na tregon ndonjë gjë në lidhje me Profetin (a.s.)? Halidbin Uelidi (r.a.), thotë:

–Jam i paaftë për të treguar bukuritë e të Dërguarit të Allahut. Nëse dëshironi t’jua tregoj me detaje, kjo nuk është e mundur!



“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për të. O besimtarë! Lutuni për të dhe përsëndeteni me “selam”!”

(el-Ahzab, 56.)

Kryetari thotë:

-Na trego me aq sa di! Përshkruaje shkurt!

Atëherë Halidi (r.a.), thotë:

"I Dërguari është përfaqësues i denjë i Dërguesit!.."

(Munavi, V, 92/6478; Kastalani, Mevâhib-i Ledünniyye Tercümesi, İstanbul 1984, s. 417.)

Pra, meqenëse Dërguesi është Zoti i botëve, madhësitinë e të Dërguarit të Tij mendoje vetë!..

Shkurtimisht, asnjë lloj fuqie njerëzore nuk mjafton për të kuptuar madhësitinë e të Dërguarit të Allahut. Ne nuk mund ta vlerësojmë atë siç duhet, me mendjen tonë të kufizuar. Prandaj, për shkak të dobësisë së mendjes njerëzore në këtë çështje, Allahu Teala e prezanton atë (profetin) personalisht, duke u shprehur:

"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për të. O besimtarë! Lutuni për të dhe përshëndeteni me "selam"!"

(el-Ahzab, 56)

Me anë të këtij ajeti, Vetë Allahu Teala i bën të ditur mendjes njerëzore se Profeti (a.s.), është një krijim madhështor me cilësi të rralla, një vepër e mrekullueshme e Tij.

Për këtë arsye, të tregosh atë, është shkalla më e lartë e devotshmërisë ndaj Allahut. Pa e kuptuar dhe pa e njohur atë, pa ndjekur gjurmët e tij dhe pa përfituar prej ndjesive të tij shpirtërore, as besimi ynë nuk është i plotë, as Kuranin nuk mund ta kuptojmë dhe as devotshmëria jonë nuk është e përsosur...

Në një ajet fisnik urdhërohet:

"Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed), që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe." (esh-Shu'ara, 193-195.)

Jeta e tij profetike prej njëzet e tre vjetësh, është një tefsir më vete i Kuranit Kerim. Prandaj, të fshehtat dhe urtësitë e Kuranit mund të kuptohen vetëm duke përfituar prej ndjesive të tij shpirtërore.

RRUGA MË E MIRË PËR TA NJOHUR ATË

Më shumë se sa duke lexuar librat, Profetin (a.s.), mund ta njohim duke lexuar zemrat. Pra, duke përfituar prej botës shpirtërore të njerëzve të devotshëm dhe të diturve, që janë edukuar me moralin profetik. Ai

mund të lexohet në mënyrën më kuptimplote, vetëm me ndjenjat e shpirtit të besimtarëve të devotshëm. Aq sa mund t'i afrohem me devotshmëri, aq edhe mund ta njohim atë. Në një ajet fisnik urdhërohet:


"...ruajuni Allahut! Allahu ju mëson juve (atë që nuk e dini); Allahu është i Dijshëm për çdo gjë." (el-Bekare, 282)

Prandaj, të mësosh "Sijer-i Nebi" (historinë e Profetit a.s.), nuk arrihet vetëm me një lexim kronologjik të ngjarjeve. Ata që e dinë më mirë "Sijer-i Nebi", janë ata, jeta e të cilëve u përngjan më së shumti jetës së Profetit (a.s.). Ata që e njohin më mirë atë, janë ata që jetojnë me devotshmëri dhe përpikëri sunetin e tij, janë të dashurit e Allahut, të cilët jetojnë të përmalluar për atë diell të mëshirës. Ata ecin në gjurmët e të Dërguarit të Allahut, ashtu siç ecën hija mbas të zotit.

Ashtu siç është vërtetuar edhe në ajetet fisnike, Profeti (a.s.), nuk fliste kurrë nga vetja. Ai ishte vetëm përkthyesi, zbatuesi, shpjeguesi, ligjëruesi dhe përfaqësuesi i asaj që i shpallej prej Allahut. Edhe të dashurit e Allahu, të cilët e duan me gjithë shpirt të Dërguarin fisnik, nuk flasin prej vetes së tyre. Bota e tyre e brendshme është boshatisur nga gjërat e kota dhe kraharorët e tyre janë mbushur me frymën e udhëzimit të Profetit (a.s.), me moralin e të cilit edhe janë edukuar. Zemrat e tyre janë pasqyra që reflektojnë nurin e së vërtetës dhe, siç është shprehur edhe Profeti (a.s.): "...Allahu është bërë veshi, me të cilin dëgjojnë, syri me të cilin shikojnë, dora me të cilën punojnë, këmba me të cilën ecin, zemra me të cilën ndjejnë dhe gjuha me të cilën flasin". (shih. Buhari, Rikak, 38.)

Profeti ynë i dashur (a.s.), është një diell që mbush çdo gjë me emocione lumturie dhe me udhëzimin e tij ndriçon të gjitha botët. Edhe të dashurit e Allahut, të cilët janë trashëgimtarë të profetëve, me devotshmërinë e tyre janë bërë si drita e hënës, që reflekton dritën e diellit. Ekzistenca e dritës së hënës është e lidhur ngushtë me dritën e diellit, sepse nuri, bukuria dhe madhështia e dritës së hënës është një reflektim i vogël që vjen prej diellit...

Në veprën e tij "Gylistani", shejh Sadi shprehet në mënyrë krahasuese kështu, në lidhje me ndikimin e Profetit (a.s.), tek të dashurit e Allahut:



"Ti ke moral të lartë!" (Kalem, 4)

Një njeri shkoi në hamam dhe një nga miqtë e tij i dha një copë argjile me erë të këndshme për t'u pstruar. Prej argjilës përhapej një aromë e këndshme, që të ledhatonte shpirtin. Prandaj dhe njeriu e pyeti argjilën:

- Ah, moj e bekuar! Mos je gjë misk apo amber? Aroma jote ma kënaqi shpirtin...

Argjila i thotë:

- Unë nuk jam as misk dhe as amber, por veçse një copë tokë. Por gjendem poshtë rrënjëve të një trëndafili dhe çdo mëngjes lagem prej pikave të vesës që bien nga gonxhet e tij. Pra, edhe aroma e këndshme që të kënaqi shpirtin, vjen prej atij trëndafili...

Trëndafili është simboli i Profetit tonë (a.s.). Prandaj dhe gjëja më e rëndësishme, që duhet të mësojë njeriu në shkollën e kësaj jete të përkohshme, është:

Të njohë atë mbret të Trëndafilave.

Të përfitojë prej aromës së atij Trëndafili të bekuar dhe prej ndjesive të tij shpirtërore.

Të bëhet një pikë vese në petalet e tij...

DASHURIA PËR MUHAMEDIN (A.S.)

Aq sa dashuri gjendet në zemrat tona për Profetin tonë (a.s.), aq e njohim edhe ne atë. I dashuri i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Njeriu është bashkë me atë që do". (Buhari, Edeb, 96.)

Gjëja e vetme që bashkon zemrat, është dashuria. I lidh ato me njëra-tjetrën, ashtu siç lidhen instalimet elektrike. Kjo gjendje i ngjan parimit fizik, të "gypave komunikues". Për sa kohë që lidhja e dashurisë mes tyre vazhdon, ata fillojnë të ngjajnë me njëri-tjetrin. Dëshirat, urrejtjet, ndjenjat dhe mendimet e tyre, fillojnë të bëhen të përbashkëta.

Dy njerëz që e duan me të vërtetë njëri-tjetrin, i dhurojnë njëri-tjetrit atë që pëlqejnë më shumë. Dhurojnë lulet më të bukura dhe bëjnë punët më të pëlqyeshme. Ai që do, do edhe ata që e duan atë që do dhe urren ata që ai nuk i do. Nuk e harron dhe nuk e lëshon kurrë nga gjuha atë.

SEPSE KËSHITU VEPRONTE AI...

Djali i Omerit (r.a.), Abdullahu (r.a.), gjithë jetën e tij,

që prej fëmijërisë, e kishte ndjekur hap pas hapi të Dërguarin e Allahut (a.s.). Ai mendohej të bënte çdo gjë që bënte Profeti (a.s.), edhe pse mund të mos e kuptonte urtësinë e tyre.

Nëse e shihte të Dërguarin e Allahut të pinte ujë në një çezmë, shkonte edhe ai e pinte ujë atje. Nëse e shihte të Dërguarin të ulej nën hijen e një peme, ulej edhe ai herë pas here nën hijen e asaj peme. Nëse e shihte Profetin (a.s.), të ulej duke u mbështetur pas një shkëmbi, shkonte edhe ai dhe ulej, duke u mbështetur atje.

Njëherë, gjatë sezonit të haxhit, Abdullah ibën Omeri (r.anhuma.), ishte ulur në një shkëmb në rrëzë të "Xhebeli Rahme"¹. Kur e pyetën për arsyen e këtij veprimi, u përgjigj:

"Profeti (a.s.), pas haxhit të lamtumirës, ishte ulur mbi këtë shkëmb".

Kur ishte duke udhëtuar me një karvan, e ndaloi karvanin në një vend dhe shkoi tek një pemë, e cila ndodhej në një kodër pak më tutje dhe u kthye përsëri. Kur e pyetën për këtë veprim, ai u përgjigj:

"Një ditë, kur po kalonim këtej, Profeti (a.s.), shkoi pranë asaj peme dhe u kthye përsëri..."

Gjendja e këtij sahabi të dashuruar me Profetin (a.s.), të cilin e ndiqte si hija të zotin, është mbresëlënëse edhe në

momentet të fundi të jetës:

Ibën Omeri (r.anhuma.), u sëmur papritur, kur ndodhej në Meke. Sipas një transmetimi, ishte helmuar nga Haxhaxhi dhe po vuante shumë. Ashtu siç ishte, e morën dhe e futën në çadër. As nuk mund të fliste dhe as nuk mund të lëvizte dorën, por kërkonte t'u thoshte diçka atyre që kishte pranë. Mirëpo ata, nuk arritën të kuptonin se çfarë donte. Duke pritur ashtu pa rrugëzgjidhje, në çadër hyn një njeri i cili e njihte nga afër Abdullah ibën Omerin (r. anhuma.). Ata që gjendeshin aty, i treguan menjëherë se Abdullahu dëshironte të thoshte diçka, por ata nuk kishin mundur ta kuptonin. Njeriu i pyeti:

-Çfarë bëtë ju?

Ata u përgjigjën:

-E ndihmuam të merrte abdest.

Njeriu pyet përsëri:

1. Një kodër në lindje të sheshit të Arafatit, ku mblidhen çdo vit hahilerët.

-A e fërkuat me ujë pas veshit?

-Jo, harruam!..- thanë ata.

Njeriu tha:

-A e njihni se kush është ai? Gjithë jetën e tij u mundua të bënte gjithçka që bënte Profeti (a.s.) dhe ruhej nga gjithçka që ruhej ai.

Menjëherë e fërkuan me ujë pas veshit. Ndërsa Abdullah ibën Omeri (r.anhuma.), çlirohet, buzëqesh dhe e dorëzon shpirtin i qetë.

Ky pra ishte një nga sahabët, zemra e të cilit ishte mbushur me dashurinë për Muhamedin (a.s.). Siç tregonin kujdes të veçantë për çdo urdhër që dilte nga goja e Profetit (a.s.), ashtu tregonin kujdes edhe për çdo aludim apo shenjë që bënte ai. Madje, mjaftonte që ta shihnin vetëm njëherë duke bërë një vepër të mirë dhe nuk ishte nevoja që ai ta urdhëronte, por e ndiqnin atë sunet me përpikëri gjatë gjithë jetës së tyre.

Enes (r.a.), transmeton:

“Një ditë, e pashë Profetin (a.s.), të falte gjashtë rekate në namazin e duhasë. Që prej asaj dite, nuk e kam braktisur kurrë atë namaz.”

Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftë!), i cili na e ka sjellë këtë transmetim, me të njëjtat ndjenja, thotë:

“Pas fjalëve të Enesit (r.a.), as unë nuk e braktisa kurrë më atë namaz.” (Taberani, Eusat, II, 68/1276.)

Xhabiri (r.a.), transmeton:

“Një ditë, Profeti (a.s.), më kapi prej dore dhe më mori në shtëpinë e tij. Nxori një copë bukë dhe pyeti familjen:

- A ka ndonjë gjë tjetër (për ta shoqëruar bukën)?

Ata thanë:

- Nuk ka gjë tjetër, përveç uthullës.

I Dërguari i Allahut thotë:

-Sa ushqim i mirë është uthulla!

Që kur dëgjova këto fjalë të Profetit (a.s.), edhe mua më pëlqen ta përdor uthullën gjatë ushqimit”. (Muslim, Eshribe, 167-169.)

Ja pra, kështu ndryshonin shijet dhe kënaqësitë në

zemrat e mbushura me dashurinë për Muhamedin (a.s.). Një shembull tjetër i kësaj gjendjeje, është edhe dietari i madh i hadithit, Imam Neveviu (Allahu e mëshiroftë!). Edhe ai mundohej ta ndiqte Profetin (a.s.), me aq kujdes, sa që, gjatë gjithë jetës së tij nuk ka ngrënë kurrë shalqi (bostan), vetëm sepse nuk e dinte se si e kishte ngrënë Profeti (a.s.) dhe kishte frikë se mos vepronte ndryshe.

Edhe i nderuari Ahmedi Jesevi ishte i dashuruar pas Profetit (a.s.). Për shkak se Profeti (a.s.), ndërroi jetë në moshën 63 vjeçare, Ahmed Jesevi hoqi dorë nga shëtitja nëpër tokë pasi arriti këtë moshë dhe u mbyll në një vend që i përngjante varrit, duke kaluar aty dhjetë vitet e tij të fundit në një jetë askete.

Muezini i të Dërguarit të Allahut (a.s.), zëri i ëmbël i bahçeve të Xhenetit, Bilali (r.a.), pas emigrimit të Profetit (a.s.), në botën tjetër, nuk mundi të qëndronte më në

Medine. Ky sahab, që e donte kaq shumë Profetin (a.s.), gjithë jetën e tij e kaloi me shpirt të djegur prej mallit për Profetin (a.s.). Ai ndërroi jetë në Damask, në moshën 60 e ca vjeçare dhe në momentet e fundit ka thënë këto fjalë:

“Nesër do të takohem me miqtë e mi të dashur InshAllah. Do të takohem me Muhamedin (a.s.) dhe shokët e tjerë”.

Bashkëshortja e tij, nga një anë qante, duke thënë “Vaj medet për mua!”, por

nga ana tjetër gëzohej në shpirt, me mendimin “Sa mirë për Bilalin!” (r.a.), i cili do të takohet me Profetin (a.s.). (Dhehebi, Sijer, I, 359.)

Nëse jeta jetohet me një dashuri të tillë për Profetin (a.s.), vdekja dhe bashkimi kthehet në një gëzim dhe festë.

Për zemrat e dashuruara me Profetin (a.s.), vdekja është një çast gëzimi dhe lumturie, një “sheb-i arus” (natë dasme). Sa mbresëlënëse është gjendja e bashkëshortes së Profetit (a.s.), nënës së besimtarëve, Aishes (r.anha.):

Profeti ynë i dashur (a.s.), ndërroi jetë në dhomën e nënës sonë, Aishes (r.anha.) dhe u varros po aty. Nëna jonë, Aisheja (r.anha.), e cila pati fatin e madh të ishte bashkëshortja e të Dërguarit të Allahut, nuk e braktisi dhomën e saj edhe pasi Profeti (a.s.), ndërroi jetë. Ajo vazhdoi të jetonte në krye të varrit të Profetit (a.s.), si një kujdestare besnike. Dy vjet e tre muaj më vonë, ndërroi



jetë edhe babai i saj Ebu Bekri (r.a.), i cili u varros në të njëjtën dhomë me Profetin (a.s.). Tashmë, aty kishte vend vetëm për një varr tjetër. Prandaj dhe Aisheja (r.anha.), atë vend e ndau për veten e saj. Mirëpo, në momentet e fundit të jetës së tij, Omeri (r.a.), kërkoi leje prej Aishes (r.anha.), që atë vend t'ia linte atij. Dhe ashtu ndodhi... Aisheja (r.anha.), duke shfaqur virtytin e lartë të bujarisë, ia lëshoi vendin Omerit (r.a.).

Sipas një transmetimi, kur në dhomë ndodheshin vetëm varri i Profetit (a.s.) dhe varri i Ebu Bekrit (r.a.), Aisheja (r.anha.), mund të lëvizte lirshëm brenda në dhomë. Por, pasi në atë dhomë u varros edhe Omeri (r.a.), për shkak të ndjenjës së madhe të turp-it, Aisheja (r.anha.), e ndau dhomën me një perde.

Shumë mbresëlënëse janë edhe këto dy amanete që la pak para se të ndërronte jetë nëna jonë Aisheja (r.anha.), e cila jetoj lumturinë e të qenit gjatë gjithë jetës pranë të Dërguarit të Allahut.

1. Kur të vdes shpejtojini punët e xhenazes dhe më varrosni, qoftë edhe natën.

2. Kur të bartni xhenazen time për në varr, në një qoshë të xhenazes digjni degë hurme të thata.

Sipas zakoneve të vjetra arabe, natën e dasmës, kur nusja përcillej për tek dhëndrri, dasmorët digjin degë hurme të thata.

KUJDESI NDAJ SUNETIT TË PROFETIT (A.S.)

Treguesi më i rëndësishëm i njohjes dhe dashurisë ndaj Profetit (a.s.), është zbatimi me përpikëri i sunetit të tij. Nëse në zemër nuk ekziston dashuria për Profetin (a.s.), zbatimi i sunetit të tij, është diçka që bëhet për sy e faqe dhe të privon prej përfitimeve dhe begative shpirtërore.

Në lidhje me rëndësinë e zbatimit me dashuri të sunetit profetik, një dijetar i madh mysliman, shpreh:

“Shkëputja një nga një prej suneteve të Profetit tonë të dashur (a.s.), i ngjan këputjeve një nga një të fijeve të litarit, i cili më në fund këputet plotësisht. Litari është i fortë, kur është i plotë. Por, nëse fijet e tij zgjidhen një nga një, ai litar nuk mund të quhet më i fortë. Largimi një nga një i suneteve prej jetës sonë, - Allahu na ruajtë! - bën që lumturia jonë në botën tjetër të ngelet e varur në fije të pambukut”.

- bën që lumturia jonë në botën tjetër të ngelet e varur në fije të pambukut”.

Prandaj dhe aftësia më e madhe e të dashurve të Allahut dhe të diturve që e njohin më së miri të Dërguarin e Allahut (a.s.), është të jetuarit e sunetit të tij me një dashuri dhe kujdes të jashtëzakonshëm.

Padyshim që në mesin e njerëzimit, më i merituari për t'u dashur, është personaliteti më shembullor që na ka falur Allahu Teala, Habibi i Allahut, Muhamed Mustafai (sal-lallahualejhiuesel-lem). Bota e tij shpirtërore është si një bahçe Xheneti, ku gjenden lulet më të bukura, më të rralla dhe trëndafilat me aromë më të këndshme. Prandaj, në këtë pikë jemi të detyruar t'i bëjmë disa pyetje vetvetes:

Sa po përfitojmë prej fladëve shpirtërore, që vijnë prej asaj bahçeje të Xhenetit?

Sa i ngjan jeta jonë familjare jetës së tij familjare?

Sa i zbatojmë rregullat që vendosi ai në lidhje me tregtinë?

Sa i zbatojmë rregullat që vendosi ai në lidhje me jetën shoqërore?


Zemra e tij rrihte fort për të mjerët, të pashpresët, jetimët dhe ata që prisnin udhëzim. Po ne, sa të ndjeshëm jemi ndaj tyre?

Sa e përfaqësojmë ne, si umet i atij njeriu me moral të lartë, çiltërsinë, pastërtinë e

shpirtit dhe zemrës, mirësjelljen, delikatesën dhe estetikën e islamit?

Allahu Teala na bëftë robër të devotshëm dhe një umet që e meriton të quhet umeti i Muhamedit (a.s.)! Na bëftë prej atyre që e lexojnë me syrin e zemrës Profetin (a.s.), të cilin Allahu i Madhëruar ia ka falur njerëzimit si personalitetin më shembullor deri në ditën e kijametit! Na bëftë prej atyre që frymëzohen prej tij dhe që jetojnë me sunetin e tij! Na bëftë prej atyre që në ditën e kijametit do të mblidhen nën sanxhakun e tij, do të shijojnë prej ujit të Keutherit dhe do të kenë fatin të arrijnë shefatin (ndërmjetësimin) e tij!

Amin!..



INTEGRITETI

mendje - shpallje

Alltan Murat Ynall

Në Kuran dhe në traditën e mendimit Islam, mendja konsiderohet si një nga burimet e dijes. Në shumë ajete të Kuranit Fisnik, njerëzve u bëhet thirrje që të përdorin mendjen:

“Jeta e kësaj bote është vetëm lojë e argëtim, kurse bota tjetër, pa dyshim që është më e mirë për ata që i frikësohen Allahut. Pra, a nuk po mendoni?” (el-En’am, 32.)

“Thuaj: “Sikur të kishte dashur Allahu, unë nuk do t’jua kisha lexuar dhe as që do të bënte Ai që ta mësoni ju atë. Unë kam jetuar një kohë (të gjatë) në mesin tuaj para profetësisë, a nuk po mendoni?” (Junus, 16.)

“Vallë, a i urdhëroni njerëzit që të bëjnë të mira e veten po e harroni, ju që lexoni Shkrimet?! A nuk arsyetoni?” (el-Bekare, 44.)

Të vërtetat logjike dhe morale, njeriu mund t’i gjejë me anë të mendjes. Ai sheh krijimin e vetes. Ai shikon dhe e kupton se sa mirësi e madhe është çdo gjymtyrë e cila i është falur. Shikon, mahnitet dhe nuk mund ta fshehtë mahnitjen e tij. Njeriu sheh edhe gjithësinë: diellin, hënë, yjet, malet, pemët, zogjtë, lumenjtë etj... Ndërsa mediton, bën komente me aq sa kupton. Mirëpo, ai e di shumë mirë se fuqia e mendjes dhe shqisat e kufizuara që i janë falur, nuk mjaftojnë për të kuptuar plotësisht gjithësinë. Si mund t’i mohojë të vërtetat mbinatyrore (jashtë kufijve të fizikës) njeriu që mediton? Madje, ai edhe si natyrë, zotëron ndjesinë dhe potencialin e kuptimit të të vërtetave.

Historia e Ibrahimit (a.s.), është shembulli më konkret, i cili na tregon se njeriu mund ta zbulojë të vërtetën vetëm duke u bazuar në natyrën e krijimit të vet (në fitrat e tij). Ibrahimit (a.s.), e kuptoi shumë qartë se hëna dhe dielli kurrë nuk mund të jenë hyjni. Prandaj, deshi

t’i tregonte një shoqërie të zhytur në idhujtari, se ekzistenca e Allahut mund të provohet edhe në mënyrë racionale. Deshi t’i tregonte se, të pranosh më shumë se një Zot, është një sjellje e cila bie ndesh me mendjen dhe logjikën.

“Kur ra nata, ai pa një yll dhe tha: “Ky është Zoti im!” Por, kur perëndoi ylli, ai tha: “Nuk i dua ata që perëndojnë. Kur pa Hënë duke lindur, tha: “Ky është Zoti im!” Por, pasi ajo perëndoi, ai tha: “Nëse Zoti im nuk më udhëzon në rrugën e mbarë, me siguri do të bëhem njëri nga të humburit”. Kur vërejt Diellin duke lindur, ai thirri: “Ky është Zoti im, ky është më i madhi!” Por, pasi dielli perëndoi, ai tha: “O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim! Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!” (el-En’am, 76-79.)

Me këtë ngjarje, Kurani na tregon që mendja, në mënyrë të pavarur nga shpallja, mund të zbulojë se gjithësia ka një krijues, se jeta ka një kuptim dhe se asgjë nuk është lënë të lëvizë në mënyrë të pakontrolluar. Kjo tregon se njeriu, edhe nëse nuk ndikohet direkt nga shpallja, ka potencialin që me mendjen e tij të besojë se gjithësia është krijuar nga një fuqi krijuese. Të mendosh të kundërtën e kësaj, do të kërkonte shpjegimin e një sekuence (zinxhir ngjarjesh). Por mendja e njeriut nuk mund ta pranojë kurrë sekuencën.

Është e vërtetë që mendja luan një rol ndërmjetës në pranimin e ekzistencës së Allahut. Vallë, vetëm nga gjykimi i mendjes përbëhet besimi? A mund ta pranojë mendja të vërtetën që është përtej saj (mendjes), si racionale dhe të logjikshme?

Edhe nëse nuk arrin të konceptojë përbërjen, mendja arrin ta pranojë të vërtetën, e cila është përtej saj. Aftësi-

të e mendjes njerëzore, janë të kufizuara. Prandaj, nuk mund të pritet që mendja, e cila zotëron aftësi të kufizuara, të dijë dhe të konceptojë gjithçka. Por nuk është e thënë që, nëse mendja pranon të vërtetën që është përtej saj, të shumëzohet me zero. Pra, të humbë rolin e saj.

Duhet të rikujtojmë se të vërtetat janë disa llojesh. Lloji i parë: Të vërtetat racionale. Këto janë të vërteta të cilat pranohen brenda rregullave të mendjes dhe logjikës. Pra, që pranohen pa u diskutuar fare. P.sh. "Gjysma e dhjetës është pesë", "aty ku nuk ka dritë, është errësirë" etj. Lloji i dytë: Të vërtetat irracionale. Këto janë të vërteta, të cilat bien ndesh me mendjen dhe logjikën dhe pranohen si budallallëqe. P.sh., "Jeta mund të vazhdojë edhe pa diellin" ose "dy herë dy nuk bëjnë gjithmonë katër", etj.

Ndërsa lloji i tretë: Të vërtetat mbiracionale. Megjithatë disa të vërteta kalojnë jashtë kufijve të mendjes, ato pranohen si të mundura. P.sh., besimi se Allahu në çdo moment vazhdon të krijojë gjithësinë, megjithatë kjo gjë nuk mund të provohet me anë të pesë shqisave tona. Pra, të vërtetat mbi-racionale nuk refuzohen. Ata që e dinë se mendja është e kufizuar, nuk janë si ata që refuzojnë çdo gjë që u del përpara dhe që nuk pranojnë asgjë, të cilën nuk e shohin. Ebu Bekri (r.a.), ka thënë: "Edhe kuptimi i dobësisë, është kuptim". Pra, edhe kur njeriu pranon se ka gjëra që nuk mund t'i kuptojë, tregon një lloj të kuptuari (është i vetëdijshëm).

"Kur ra nata, ai pa një yll dhe tha: "Ky është Zoti im!" Por, kur perëndoi ylli, ai tha: "Nuk i dua ata që perëndojnë. Kur pa Hënën duke lindur, tha: "Ky është Zoti im!" Por, pasi ajo perëndoi, ai tha: "Nëse Zoti im nuk më udhëzon në rrugën e mbarë, me siguri do të bëhem njëri nga të humburit". Kur vërejt Diellin duke lindur, ai thirri: "Ky është Zoti im, ky është më i madhi!" Por, pasi dielli perëndoi, ai tha: "O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim! Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!"

(el-En'am, 76-79.)

Si
shembull,
mund të marrim
edhe botëkuptimin
e hyjnore në Islam. Nuk
është e mundur që mendja
e cila është e përkohshme dhe
e kufizuar, të shpjegojë Allahun
Teala, i cili është, i pafillim, i pafund
dhe i pakufizuar. Prandaj, pranimi i të
vërtetave mbiracionale, nuk bien ndesh
me mendjen. Përkundrazi, në këtë mënyrë,
mendja pranon se është e kufizuar dhe
për këtë arsye, ajo do të punojë brenda një
kornize filozofike më realiste dhe duke shpëtuar
prej presioneve rrethore, do të marrë rrugën
drejt lirisë.

Mbiracionalja dhe racionalja, mund të bashkëjetojnë pa e mohuar njëra-tjetrën. Për shkak se racionalizmi modern nuk ka mundur t'u shpëtojë paragjykimeve reduktive dhe shekullariste, të vërtetat mbiracionale i sheh si besëtytni metafizike dhe i refuzon. Botëkuptimi shekullarist botëror, i cili është krijuar për të refuzuar hyjnoren dhe mbinjerëzoren, me qëllim që të mos kundërshtojë parimet e veta, refuzon edhe të vërtetat mbiracionale. Ata që e pranojnë mendjen si matësen dhe vlerësuesen e çdo gjëje, mundohen që çdo gjë, të cilën nuk e nxë fusha e sajuar prej mendjes, ta paraqesin si një besim të pakuptimtë.

Ka edhe prej atyre që mendojnë se ka përplasje midis mendjes dhe shpalljes. Mbrojtësit e këtij botëkuptimi të importuar nga perëndimi në botën islame, pretendojnë se në Islam duhet të fillojë një proces racionalizimi ashtu siç është bërë në perëndim. Dëshmuam se ajetet e Kuranit Fisnik iu nënshtruan një tefsiri (komentimi) shkencor nën dritën e shkencës moderne. Këto janë rezultat i dëshirave për racionalizim, të njëjtë si në perëndim. Në fillim, modernizimi i Islamit, pastaj racionalizimi... Ky është shkaku që këta njerëz nuk kanë arritur të krijojnë një lidhje të qëndrueshme dhe të drejtë midis mendjes dhe shpalljes.

Racionalizmi modern, mendon se midis shkencës dhe vlerave morale nuk ka asnjë lidhje dhe se këto duhen shqyrtuar të ndara nga njëra-tjetra. Por, nëse shkenca dhe vlerat morale e estetike ndahen nga njëra-tjetra, do të përballemi me një koncept të pakuptimtë të gjithësisë. Botëkuptimi i reduktimit të çdo lloj të vërtete në koncepte fizike, të çon në pretendimin se gjithësia

nuk ka asnjë kuptim të veçantë.

Ata që e ndajnë diturinë (shkencën) dhe moralin në vija të mprehta, veprojnë çdo gjë pa u shqetësuar nga ana morale. Jeta e tyre është e zhveshur nga vlerat morale dhe feja, prandaj ata veprojnë vetëm sipas parimeve të mendjes. Ata që shkojnë pas dëshirave, janë të privuar nga aftësia e formimit të jetës në një lloj mënyre tjetër.

Mirë, po a nuk e panë ata që veprojnë në bazë të parimeve të mendjes se si mendja ka marrë formën e një arme vdekjeprurëse? Armët e asgjësimit në masë, milionat e gjymtuar, qytetet e djegura dhe të shkatërruara... A nuk janë të gjitha këto rezultatet tragjike të hyjnizimit të mendjes?

“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij?” (el-Furkan, 43.)

Islami dëshiron që mendja, e cila i është dhënë njeriut si mirësi, të pajiset me dituritë e shpalljes. Dituria e dhënë me anë të shpalljes, nuk përbën pengesë në funksionimin e mendjes. Përkundrazi, i jep mendjes orientimin e duhur dhe bëhet pengesë që ajo (mendja) të përdoret si një mjet që shkatërron çdo gjë që ka përreth. Kështu që, mendja merr një kuptim të ri. Madje, bëhet vendi ku bashkohet dituria deduktive me diturinë e shpalljes.

Mendja, është një aftësi e cila e bën njeriun objekt të shpalljes. Detyra e mendjes është përrulja përballë shpalljes, sepse shpallja flet mbi mendjen. Për këtë arsye, në Kuran gjenden shumë ajete të cilat nxisin për përdorimin e mendjes.

Shpallja është një burim i mbinatyrshëm diturie. Ajo i paraqet njeriut një dituri, e cila qëndron mbi kuptimin njerëzor. Shpallja nuk është një fenomen i rëndomtë, por një lidhje hyjnore, e cila formohet jashtë botës fizike.

“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!” (Muhamed, 24.)


Nëse nuk sigurohet integriteti mendje - shpallje, largimi nga natyra e pastër njerëzore është i pashmangshëm. E thënë ndryshe, nëse je larguar nga natyra e pastër njerëzore, tashmë je larguar edhe nga integriteti

mendje - shpallje. Vallë, a mund të themi se “Njerëzit që janë shkëputur nga shpallja, janë pa mend?” Për të shpëtuar nga hegjemonia e një diturie që e shumëzoi me zero atë që nuk e koncepton dot mendja, duhet të pranohet shpallja. Për sa kohë që nuk pranohet shpallja, bëhen të pakuptimta edhe të vërtetat, për ekzistencën e të cilave nuk dyshohet dhe që janë brenda rregullave të pranuar nga mendja dhe logjika. Mendja, e cila nuk ushqehet nga atmosfera e shpalljes, është larg nga vlerat morale. Vetëm nën integritetin mendje - shpallje mund të formohet një lidhje e ekuilibruar midis veprimeve racionale dhe vlerave morale. Nëse të vërtetat që arrihen me anë të ideve individuale, nuk vlerësohen nën dritën e shpalljes, është e mundur që mendja të bëjë parim racional dhe legjitim çdo lloj poshtërsie, krimi, presioni dhe padrejtësie. Megjithatë procesi i racionalizimit perëndimor po vazhdon, amoraliteti, krimi dhe padrejtësia po përparon çdo ditë e më shumë dhe për këtë jemi të gjithë dëshmitarë.

Përfundimet që nxirren në bazë të ideve individuale, nuk e çojnë njerëzimin në paqe dhe mirësi. Njeri i mençur është ai, i cili lidh të djeshmen, të sotmen dhe të nesërmen. Ai që mendon të nesërmen, përgatitet për botën tjetër, pa i ardhur vdekja. Ai që shkon mbas epsheve dhe dëshirave, nuk mund të quhet i mençur. Njeriu mund të arrijë mendimin e drejtë, vetëm duke u mbështetur tek shpallja.

Mendja, e cila vepron jashtë diturisë së shpalljes, e ka humbur funksionin e vet. Dhe mendja, e cila e ka humbur funksionin e saj, është larguar nga natyra e pastër. Jeta mund të marrë kuptim vetëm duke u jetuar në natyrën e pastër njerëzore. Gjithçka që është jashtë natyrës së pastër, nuk mund ta bëjë të lumtur njeriun. Prandaj, nuk mund të flasim për paqe dhe qetësi në një shoqëri, ku njeriu nuk është i lumtur, sepse lumturia, paqja dhe qetësia arrihen vetëm me përmendjen e Allahut.

“Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmedet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (er-Ra’d, 28.)





Dr. Myzafer Jan

Mbi Lutjen dhe shekullarizimin

Si pasojë e sëmundjes së kohëve moderne, njeriu është i distancuar nga e shenjta dhe shpirtërorja, është i huaj me veten dhe me Krijuesin e vet dhe është në ndjekje të një mënyre të rëndomtë jetese. E vërteta dhe urtësia, thuajse janë lënë në raftet e së kaluarës. Në këtë kontekst, njeriu modern sikur e ka lënë veten të lirë në vorbullën e botës. Njeriu është bërë qendra e gjithçkaje të kësaj bote të humbur. Egoja e njeriut thuajse është hyjnizuar. Vendin e Zotit sikur e ka zënë mbinjeriu (superman).

Njeriu është përballur me problemet epistemologjike dhe ontologjike, ku duhet të zgjedhë mes ekzistencës dhe mosekzistencës. Shekullarizmi, i cili përbëhet prej këtyre problemeve, është një nga çështjet më jetike të njeriut modern. Shekullarizmi është një prej problemeve më gjithëpërfshirëse, i cili është pjesë e përbashkët e religjionit, filozofisë, politikës dhe sociologjisë. Disa e përkufizojnë si jeta sociale e religjionit dhe si vetëdija dhe pavetëdija e individit.

Kurse disa të tjerë si *“tëhuajësimi i vetes, si pasojë e vetëperceptimit si i pavarur nga Zoti”*. Ajo çfarë kuptojmë ne me shekullarizmin, është pikërisht kjo e dyta. Pra, përtej diskutimeve të shekullit të 19-të, në kontekstin religjion-politikë të shekullarizmit që praktikohet në Perëndim, me konceptin shekullarizëm kemi synim të trajtojmë manifestimin psiko-social të tij, shpërbërjen që është krijuar në raportin njeri-Zot, në kuptimin ekzistencialist dhe apolitik, pra, procesin e humbjes së cilësisë si një vlerë të ndërvarur duke fshirë nga jeta e individit kuptimin e së shenjtës/religjionit.

Shekullarizmi, ashtu sikurse mund të kuptohet edhe


nga shprehjet e mësipërme, nuk është ekzistenca në këtë botë duke përmbushur nevojat e saj, por duke lënë mënjanë rrugëtimin për t'i gjetur kuptim aventurës së jetës. Shekullarizmi është domethënia për të konvertuar në mënyrë jetese në planin e një sërë vlerash (paradigma) të përshtatshme, shkëputjen e marrëdhënieve dhe distancimin nga transcendentja, nga e përtejshmja.

Zoti, ndërkohë që botën e ka krijuar të bukur dhe tërheqëse, edhe njeriun e ka pajisur në atë formë që ai të jetë i afeksionuar nga këto bukuri. Bota shfaqet si një vend ku njeriu mund të ushqejë dëshirën dhe ndjesinë për të pasur, për t'u kënaqur dhe për të sunduar tjetrin. Andaj dhe Zoti i Madhëruar e përmend këtë fakt në raste të ndryshme: **“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara.”** (Ali Imran, 14.)

Nëse duhet të flasim për disa shembuj të Kuranit që bëjnë fjalë për shekullarizmin, në mesin e tyre mund të veçojmë rastin e Faraonit dhe Karunit. Faraoni simbolizon njeriun që ushtron dhunë mbi njerëzit me fuqinë që mori në botë. Njeriu që mburrej para Zotit dhe që në njëfarë mënyre ishte vetëshpallur Zot, një udhëheqës tejet mizor. (Bekara, 49; Araf, 141; Junus, 83.)

Ndërsa Karuni në Kuran, është një person që i përket fisit të Hz. Musait, një person që mburrej me pasurinë. (Kasas, 76 - 82.)

Karuni është një person që i pëlqente të binte në sy, një person që kalonte me mburje në mesin e njerëzve. Kur kritikohej që të mos mburrej me pasurinë e po-



*Kur robërit e Mi
(besimtarë) të pyesin
për Mua, (thuaju se)
Unë jam afër, i përgjigjem
lutjeve të lutësit,
kur ai më lutet Mua.
(Bekare, 186)*

pullit, ai thoshte se ajo ishte pasuri që ai vetë e kishte fituar, në sajë të dijes së tij. Pra, Karuni kishte filluar të pretendonte se ishte pronari i pasurisë dhe mohonte kontributin, ndihmën dhe urtësinë që i kishte dhënë Allahu për pushtetin ekonomik të tij.

Krahas shembullit të Faraonit dhe të Karunit, Kurani bën fjalë edhe për një personazh që mendërisht dhe shpirtërisht ishte i dhënë pas jetës së kësaj bote. (Araf, 175 - 176.). Megjithëse këtij personi Zoti i jepte dije (*ajat*) lidhur me kuptimin, qëllimin dhe natyrën e jetës, ai kishte mbetur i rrënjosur tek jeta e kësaj bote, duke gjëmuar dëshirat dhe kënaqësitë e kësaj bote dhe kishte ngelur pa kthjelltësinë mendore dhe ekuilibrin shpirtëror që ka një besimtar.

Problemin e shekullarizmit, të cilin Kurani na e paraqet përmes këtyre tre shembujve të ndryshëm, e sheh të shfaqur në histori në nivele të ndryshme në shumë popuj. Në kuptimin e gjerë, shekullarizmi është mburrja dhe krenaria ndaj vetes, shpërdorimi i pasurisë, deviacionet seksuale, ndarjet e padrejta dhe kolonizimi. Ajo çfarë duhet të bëhet përballë këtyre devijimeve materiale dhe shpirtërore të kësaj natyre, është të bëjmë pjesë të jetës sonë vlerat këshillore të njerëzve, që Zoti u ka dhënë nga dija e Tij. Këto vlera, japin kodet e duhura lidhur me kuptimin e jetës dhe porosisin thjeshtësinë, drejtësinë, solidaritetin, të qenit i qëndrueshëm, këshillojnë të ndash me tjetrin, jetën familjare dhe lëmshën.

Sikurse dihet, Islami është feja e rrugës së mesme dhe myslimanët janë një popull/ymet që jetojnë mbi këtë ekuilibër. Ashtu sikurse e ka shpjeguar edhe Profeti ynë i dashur, njeriu duhet ta jetojë këtë jetë sikur nuk do të vdesë kurrë dhe të punojë për botën e përtejme sikur do të vdesë të nesërmen. Andaj dhe njeriu duhet ta vazhdojë jetën mbi një ekuilibër të tillë dhe t'u shmanget ekstremeve. Njeriu duhet të vijojë jetën, ndërkohë që vazhdon marrëdhënien me Zotin e tij. Njëkohësisht, ai duhet t'i përdorë me drejtësi dhuntitë që i ka dhënë Zoti në këtë botë. Këtu, feja i ofron njeriut një etalon se si duhet ta vëreje ai jetën: Duhet të jetojë në këtë botë si një gjallesë e kësaj bote dhe i distancuar nga ekstremet.

Megjithatë, ky ekuilibër nuk është arritur të mbahet gjithmonë. Në periudha të ndryshme, njeriu ka bërë dhunime dhe mizori të paimagjinueshme, për shkak të interesave vetjake. Natyrisht që njeriu do të përdorë dhuntitë e botës për të mbijetuar. Të mendosh të kundërtën e kësaj, është në kundërshtim me mendjen dhe me urtësinë hyjnore. Andaj, njeriu i nevojitet botës për të jetuar. Kjo gjë dëshmon marrëdhënien jetësore të njeriut me botën. E rëndësishme në këtë pikë është se dhuntitë e kësaj bote nuk duhet të jenë vetëm në dorën e një populli, kategorie apo klase të caktuar, por duhen

shpërndarë në një mënyrë të drejtë, duke kontribuar për paqen mbarëbotërore të njerëzimit. Përndryshe, duke u lidhur në këtë mënyrë me botën, është gjithnjë e mundshme që njeriu të hyjë në një rrugë të rrezikshme. Rrjedhimisht, marrëdhënia e njeriut me botën shfaqet nga dimension i përdorimit të saj dhe bëhet qëllim më vete. Atëherë, jeta e kësaj bote merr një kuptim tjetër dhe tejkalon çdo qëllim hyjnor.

Duaja (lutja) zë një vend të veçantë si një mënyrë zgjidhjeje, si një gjendje zgjimi dhe në kuptimin e të mbajturit të gjallë në mënyrë të vazhdueshme të kontaktit me të vërtetën, përballë të gjitha këtyre shqetësimeve që rrjedhin nga shekullarizmi. Në një kuptim, duaja është rrëfimi i dobësisë së njeriut me të gjithë qenien drejt Krijuesit, duke shprehur madhërimin dhe respektin ndaj Tij. Kështu, duaja është një dialog që krijohet mes njeriut dhe Zotit. Njëkohësisht, mund të thuhet se është edhe një shprehje e një marrëdhënieje të drejtpërdrejtë, për të njohur mëshirën dhe dashurinë e Allahut për njeriun.

Duaja është të kujtuarit se Allahu është gjithnjë me ne, është kontakti me Krijuesin dhe ngjitja në këtë vetëdije. Për t'u realizuar vëmendja dhe mëshira hyjnore, hapi i parë duhet hedhur nga njeriu. Zoti i Madhëruar, duke thënë: **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër dhe u përgjigjem lutjeve të lutësit.”** (Bekare, 186), thekson se duaja është një marrëdhënie shpirtërore që krijohet mes Tij dhe njeriut dhe këtë marrëdhënie duhet ta nisë njeriu.

Pra, duaja është shprehja e përmallimit të thellë që ndjen njeriu për t'i gjetur përgjigje vetes së tij, brenda heshtjes së tmerrshme të Gjithësisë.

Duaja është përpjekja për të kontaktuar me Krijuesin, që është mbrojtësi dhe ndihmuesi i secilit dhe është përgjigja e njeriut për lidhjen dhe dashurinë e tejmbushur të Allahut.

Duaja është rrugëtimi i mendjes drejt një bote jomateriale; është prekja e parimeve të larta si të pandryshueshme; është ngjitja e shpirtit drejt Zotit; është shprehja e dashurisë dhe përvetësisë ndaj qenies që ka krijuar mrekullinë, që quhet jetë; është një përpjekje për të arritur kontakt me një qenie që ka krijuar gjithçka dhe që është burim i përsosmërisë, fuqisë dhe bukurisë; është një përgjigje që i jep njeriu dashurisë dhe lidhjes që shpërthen gjithnjë tek Allahu.

Lidhur me këtë, Allahu i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë): “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”** (Ali Imran, 190 - 191)

Duaja nuk është një formalitet që duhet kryer apo një magji e papërcaktuar që nuk i dihet mbarëvajtja e as që është e panjohur domethënia e saj. Duaja nuk është as radhitja e disa fjalive, klisheve apo fjalëve të zbukuruara, por është krijimi i një lidhjeje të sinqertë mes Zotit dhe njeriut. Për sa kohë që edhe gjendja shpirtërore, dëshirat dhe shqetësimet e njeriut janë të ndryshme, forma e duasë është e ndryshme. Prandaj, gjatë duasë nuk është e rëndësishme forma apo fjalët, por sinqeriteti. Njeriu që ndjen madhështinë e Allahut, që i druhet dënimit të Tij dhe që dëshiron pëlqimin e Tij, i drejtohet Atij me fjalë të sinqerta, që i dalin nga zemra.

Njeriu që e ka pranuar Atë si mik dhe ndihmës, ia shpreh Atij çdo hall e shqetësim. (Jusuf, 86.)

Njeriu mund të bëhet egosit, duke hequr dorë nga Zoti dhe mbivlerësuar fuqinë e tij, për të zgjidhur problemet dhe shqetësimet e veta, kur e ndjen veten të sigurt dhe të suksesshëm. (Isra, 67; Lukman, 32) Në këtë kontekst, duaja zë një vend mjaft të veçantë, për të mbajtur gjallë ndjenjën fetare dhe besimin, në funksion të përballjes së kësaj dobësie të njeriut.

Në çdo situatë, njeriu duhet t'i drejtohet Zotit dhe asnjëherë të mos shkëpusë kontaktin me Të. Kështu, kur njeriu i drejtohet Allahut në disa situata të vështira (Mumin, 60.), shpëton nga egoizmi dhe pragmatizmi i përdorimit të Zotit në situata të vështira.

Kur njeriu neglizhon drejtimin etik dhe të shenjtë, bëhet një krijesë shpirtërisht e verbër dhe pengesë për të qenë i dobishëm për shoqërinë. Në këtë pikë, duaja dhe ibadeti janë një mundësi e madhe për të përballuar kushtet e vështira të jetës, për t'u mëkëmbur në jetën moderne, për t'u qetësuar dhe për të arritur prehjen shpirtërore, duke qëndruar ballë për ballë me Krijuesin. Shkurtimeisht, duaja është procesi i mëvetësimit të vetmisë së njeriut. Më shumë se një shprehje e venitjes nga jeta dhe e pashpresës, është një ekzistencë dhe rilindje.

Duaja është një krijim më vete.

Islami është Teuhid

Adil Akojunllu

Eështë e lehtë të besosh ekzistencën e Allahut... Ai që mediton sadopak mbi krijesat e Tij dhe sheh bukurinë, ekuilibrin dhe madhështinë e gjithësisë, patjetër që beson tek Allahu.

Por, të besosh në njëshmërinë e Tij dhe të mbrosh këtë besim (besimin e teuhidit), nuk është edhe aq e thjeshtë.

Ebu Bekri (r.a.), tregon:

- Profeti ynë i dashur tha: *"Shirku është më i fshehtë se milingona, e cila lëviz midis jush"*.

Unë i thashë:

-O i Dërguar i Allahut! A nuk është shirk adhurimi i dikujt tjetër, përveç Allahut ose adhurimi i dikujt tjetër, së bashku me Allahun?

I Dërguari i Allahut tha: *"Allahu të dhëntë atë ç'është më e mira për ty, o Siddik! Shirku është më i fshehtë se milingona, e cila lëviz midis jush. A të të njoftoj për atë që i largon të mëdhatë dhe të voglat e saj, apo të madhen dhe të voglën e saj?"*

-Sigurisht o i Dërguar i Allahut,- i thashë.

Pastaj i Dërguari i Allahut tha: *"Çdo ditë thuaj tri herë: "O Allah! Strehohem tek Ti nga shirku, me vetëdije dhe kërkoj faljen Tënde prej atyre që nuk i di. Shirku është të thuash: "Më ka dhënë filani dhe Allahu". Gjithashtu, e tillë është edhe të thuash: "Mos të ishte filani, do të më kishin vrarë"!"*

Nëse e vëmë re me kujdes, këto fjalë i drejtohen Ebu Bekrit (r.a.). I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e paralajmëron Ebu Bekrin, sepse ka rrezik të bjerë në shirk. Por duke iu drejtuar Ebu Bekrit (r.a.), i jep këtë mesazh umetit të tij: Mos thoni se "unë nuk bie në shirk". Edhe Ebu Bekri (r.a.), mund të bjerë. Edhe ju mund të bini... Jini të kujdesshëm dhe vigjilentë ndaj shirkut!

Allahu i Madhëruar urdhëron: **"Vërtet mendojnë një-rëzit, se do të lihen të thonë "Ne besojmë", pa u vënë në provë?!"** (el-Ankebut, 2.)

Po nuk mund të shpëtojmë me të thënë "besuam"

1. Imam Mervezi, Musned-i EubekirSidik (ter. AhmedDavudoglu) h. 17, 18.

ose "ne jemi myslimanë". Kjo nuk mjafton. Do të sprovohemi. Do të sprovohemi me urdhra dhe ndalesa. Por sprovë më e vështirë për njeriun, do të jetë në çështjen e teuhidit dhe shirkut, sepse Zoti ynë na ka njoftuar se do të na i falë të gjitha gjynahet, përveç gjynahut të shirkut: **"Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia falur kujt të dojë"**. (en-Nisa, 48.)

Ebu Dherri (r.a.), tregon:

- Profeti ynë (a.s.), ka thënë: *"Më erdhi Xhibrili dhe më tha: "Përgëzoje umetin tënd, se do të hyjë në xhenet kushdo që vdes pa i bërë Allahut shirk ndonjë gjë."*

Unë, i hutuar, pyeta:

- Edhe nëse bën amoralitet ose vjedh?

- Ai u përgjigj: *"Edhe nëse bën amoralitet edhe nëse vjedh"*.

Unë përsëri:

- Pra, edhe nëse vjedh ose bën amoralitet? *"Po, edhe nëse vjedh, edhe nëse bën amoralitet"*- tha ai.

Herën e katërt, Profeti (a.s.), tha: *"Edhe sikur të zvarritet, Ebu Dherri do hyjë në xhenet"* (Buhari, Teuhid, 33)

Veçoria më e rëndësishme e Islamit, është teuhidi. Ndërsa veçoria më e rëndësishme e myslimanëve, është se janë muuahidë (besimtarë të teuhidit). Ata njohin vetëm një Allah. Pasi kanë besuar dhe janë dorëzuar tek Ai,

nuk i bëjnë shok në adhurim asnjë prej krijesave.

Shoqëritë e vjetra idhujtare, nuk e mohonin Allahun. Ata besonin në ekzistencën e Allahut, por në të njëjtën kohë, i bënin shok Atij. Edhe sot, pjesëtarët e shumë prej feve të ndryshme, megjithëse e besojnë ekzistencën e Allahut, i bëjnë shok në adhurim. (Nureddin Es-Sabuni, Akaidi Maturidijje)

Në kohën tonë ka edhe prej atyre myslimanëve, të cilët e besojnë Allahun, duke i bërë shok Atij. Por ata as që janë të vetëdijshëm se e kanë ndotur besimin e tyre me shirk.

Allahu i Madhëruar urdhëron: **“Shumica e tyre nuk besojnë në Allahun, pa i shoqëruar Atij njëkohësisht (idhuj të rremë) në adhurim”.** (Jusuf, 106.) Me këto

fjalë, Allahu Teala kërkon t'i paralajmërojë robërit e vet në lidhje me shirkun. Ndërsa Ibën Abbasi (r.a.), në lidhje me këtë ajet, thotë: “Pra, kur i pyet se kush i krijoi ata, qiejt dhe tokën, ata përgjigjen duke thënë, “Allahu”. Ja pra, ky është besimi i tyre. Por kur vjen puna tek adhurimi, ata adhurojnë dikë tjetër përveç Allahut. Ndërsa, ky është shirku i tyre”. (Taberi, 13, 51)

Myslimanët, të cilët bëjnë dave (ftojnë në Islam) në ditët e sotme, pa marrë parasysh axhendat të cilat i caktojnë të tjerët, duhet të caktojnë vetë axhendat e tyre dhe të organizojnë punën e tyre, duke vënë gjithmonë në plan të parë çështjen e teuhidit dhe shirkut. Puna për kurimin e sëmundjes së shirkut, është një nga detyrat më të rëndësishme të çdo myslimani që beson Allahun, sepse **“shirku është një padrejtësi shumë e madhe.”** (shih: Lukman, 13.) Padrejtësia më e madhe! Kurrë nuk duhet harruar se pas çdo perdeje padrejtësie qëndron një idhull i hyjnizuar.

Edhe idhujt e kohës sonë janë bërë modernë. Tashmë, ata nuk na dalin më përballë si gurë të gdhendur. Gjithçka (besim, mendim, filozofi, zakon, traditë, modë), që nuk e pranon shpalljen hyjnore si udhëzues të jetës, që i largon njerëzit nga “sirat-i mustakim” (rruga e drejtë) me hir apo me pahir dhe që shkel kufijtë dhe rregullat, të cilat Mëshiruesi i ka vendosur për robërit e Tij, është idhull.

Dëshirat dhe epshet e hyjnizuara janë idhuj. (shih: el-Xhathije, 23.)

Përveç Allahut, çdo gjë, shenjë, simbol, flamur, figurë, bust, varr apo njeri, të cilit i atribuohet fuqia po hyjnizohet, është idhull.

Allahu Teala, me këtë ajet: **“A mos vallë ata i veshin Atij si ortakë idhuj që nuk mund të krijojnë asgjë, ndërkohë që vetë janë të krijuar?!”** (A'raf, 191) i fton robërit e Tij të mendojnë.

“O njerëz, është sjellë një shembull, andaj dëgjojeni atë: “Idhujt që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse bashkohen të gjithë për këtë. E, nëse miza u merr atyre diçka, ata nuk do të mund t'ia marrin. I dobët është përgjëruesi (adhuruesi), por edhe ai të cilin i përgjërohen (idhulli).” (el-Haxhxh, 73.)

“Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërrroheshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i lartësuar mbi çka ia veshin Atij!”. (el-Enbija, 22.)

Ky rregull, ekuilibër dhe përsosmëri, e cila vazhdon që kur është krijuar gjithësia, dëshmon për ekzistencën e një krijuesi të vetëm. Megjithëse çdo pjesë e gjithësisë është e pavarur, midis tyre ka një ekuilibër dhe lidhje të veçantë. S'ka fuqi tjetër, përveç Allahut. Çdo gjë vepron brenda një sistemi të përsosur, i cili dëshmon vetëm për një Allah.

Nëse i shohim ato që ndodhin në gjithësi dhe nëse mendojmë në lidhje me to, nuk mund ta mohojmë kurrë se ato kanë vetëm një krijues. Lidhja që ka atomi me diellin², lidhjet e gjallesave me njëra-tjetrën, ndihma e gjallesave me njëra-tjetrën...etj., janë dëshmi të qarta se nuk ka fuqi, hyjni dhe Zot tjetër, përveç Allahut.


“Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij, s'ka asnjë zot tjetër, përndryshe, çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!” (el-Mu'minin, 91.)

“Zoti juaj është një Zot i vetëm! S'ka zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Atij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!” (el-Bekare, 163.)

Teubeja (pendimi tek Allahu), e cila është pastruesja e çdo të keqeje, në të njëjtën kohë është e vetmja gjë, e cila mund ta pastrojë edhe gjynahun e shirkut:

“Kush punon vepër të keqe ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.” (en-Nisa, 110.)

2. Masa e diellit përbën 99,97% të masës së përgjithshme të tij. Edhe pjesa më e vogël e materies, “bërthama e atomit”, njësoj si dielli përbën 99,97% të masës së përgjithshme të vetë atomit. Edhe përreth diellit, edhe përreth bërthamës së atomit rrotullohen satelitë. Edhe mënyra dhe drejtimi i rrotullimit të tyre është i njëjtë. Njëri është sistemi më i madh lëvizës, ndërsa tjetri sistemi më i vogël lëvizës. Midis tyre ka një ngjashmëri dhe proporcion të mahnitshëm.



Rëndësia e këndimit të Mevludit

Sami Muçej

Më ka rënë në dorë, si dhuratë e Myftinisë, libri “Fetva bashkëkohore dhe konsultime”, të Muhamed Seid Ramadan el-Butit. Në këtë libër autori është munduar t’u japë përgjigje të sakta besimtarëve myslimanë në shkallë botërore.

Duke lexuar me kënaqësi pjesë të ndryshme, të paraqitura në këtë libër (nëpërmjet pyetje-përgjigjeve), më tërhoqi vëmendjen pyetja e një besimtari mysliman.

Pyetje: *Më ka rënë në dorë një broshurë e Shejh Bin Bazit rreth pretendimit se manifestimi i ditëlindjes “Mevludi” i Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem, është haram. Po ashtu, manifestimi i gjysmës së muajit Shaban apo i vitit të ri hixhrij... dhe se këto janë bidate. Si thoni ju?*

Përgjigje: Manifestimi i ditëlindjes së gëzuar të Pejgamberit është aktivitet shoqëror, i cili ka dobi të madhe fetare, nëse në të nuk ka gjëra të shëmtuara.

Çështja e ligjshmërisë së kësaj, është si ligjshmëria e manifestimit që mbajti Arabia Saudite para disa viteve, pra kalimi i 100-vjetorit të vdekjes së Shejh Muhamed Abdul Vehabit.

Nëse manifestimi i lindjes së Pejgamberit është bidat (risi), atëherë manifestimi i lindjes së Muhamed bin Abdul Vehabit dhe përkujtimi i tij, është e udhës që të jetë bidat dhe i ndaluar. (shik. fq. 215-126 të këtij libri.)

Në qytetin e Shkodrës, në të gjitha fshatrat që e rrethojnë, përtej kufirit, në Tuz e Ulqin, në Kosovë e më gjerë, prej 100 vjetësh përkujtohet ditëlindja e Profetit, duke përdorur mevludin në gjuhën shqipe të Hafiz Ali Ulqinakut dhe botime të tjera po në gjuhën shqipe. Jo vetëm kaq, mevludi është kënduar shpesh edhe në familjet shkodrane.

Në shekullin e kaluar, shumë teologë dhe hoxhallarë të përmendur të qytetit të Shkodrës, që sot nuk jetojnë, kanë marrë pjesë në këto aktivitete.

Mund të përmendim Haxhi Muhamed Bekteshin, Hafiz Shefqet Boriçin, Hafiz Abdullah Nezirin, Hafiz Sabri Bushatin, Hafiz Bakallin, Hafiz Esat Myftinë dhe Shejh Qazim Hoxhën.

Më kujtohet mevludi që u këndua në xhaminë e Parrucës, në vitin 1946, me një pjesëmarrje të jashtëzakonshme, ku përpara xhematit ishin rreshtuar një pjesë e mirë e hoxhallarëve të qytetit të Shkodrës, të cilët në pamjen e jashtme, të jepnin një kënaqësi të veçantë. Ne, grupi i medresistëve, shoqëronim grupin e kënduesve të mevludit me ilahi e salavate.

Grupi këndues i mevludit, i paarritshëm, i përbërë nga Hafiz Gogoli, Hafiz Xhevdet Zylja, Hafiz Man Durrësi, Hafiz Xhemal Çanga dhe Hysni Puka, me zërin e tyre shumë melodioz, në këndimin e mevludit, të ilahive dhe salavateve, i lanë mbresa të jashtëzakonshme brezit që e jetuan atë periudhë.

Këto vitet e fundit, në Shkodër e më gjerë, qarkullon ideja se përkujtimi i ditëlindjes së Profetit Muhamed (a.s.), “mevludi”, është bidat dhe i ndaluar. Kështu, në disa xhami,

në sajë të ndërhyrjes, ka filluar të zbehet ky aktivitet.

Më ka takuar rasti të ndjek një program kushtuar ditëlindjes së Muhamedit (a.s.), që po zhvillohej në një xhami (në një televizion lokal). Në këtë aktivitet merrnin pjesë grupmosha të ndryshme. Grupi që drejtonte këtë aktivitet, qëndronte përpara xhematit, duke lexuar e recituar pjesë të ndryshme që i kushtoheshin Profetit Muhamed (a.s.).

Këto lloj programesh, me sa kuptoj unë, ndryshojnë në formë, por jo në përmbajtje, duke e krahasuar me atë tradicionalin. Por cili është ndryshimi në formë, që u përmend më sipër?

Kam dëshirën të paraqes procedurën dhe përmbajtjen e këtij aktiviteti, që praktikohet me dekada në Shkodër: Programi fillon me një pjesë të Kuranit, vazhdon me një ose dy ligjëratë, që i kushtohen figurës së ndritur të Profetit. Në vazhdim, këndohet salavati e mevludi, pastaj këndohen me radhë katër pjesët kryesore të mevludit. Në pjesën e parë thuhet se çdo punë duhet të fillojë me emrin e Allahut.

Në pjesën e dytë, ku bëhet fjalë për Hz. Ademin, Zoti e dënoi shejtanin, sepse nuk e respektoi (nuk iu përlu si melekët, pra e bëri lanet). Në pjesën e tretë, vargjet i kushtohen lindjes së Profetit (Libri i Mevludit shqip, fq. 186-188, nga F. Luli dhe I. Dizdari).

Në pjesën e katërt "Erdhi në dynja", përshkruhet me vargje atmosfera e gëzueshme e lindjes së profetit. Të gjitha pjesët e mevludit shoqërohen me ilahi e salavate.

Në fund, këndohet lutja (duaja), ku vargjet paraqesin mëshirën e Allahut dhe shefaatin e Pejgamberit.

Duke dalë nga xhamia, te porta, xhemati qeraset me karamete e llokume. Si konkluzion, ndryshimi qëndron nga forma, por jo nga përmbajtja, gjë që nuk shkel asnjë normë fetare islame.

Meqë jemi tek zëri, do t'i referohemi librit "Vargu i Profetëve" nr. 3, të Osman Nuri Topbashit, kapitullit Hazreti Dauti, "këndimi i bukur i fjalës së bukur." (fq. 27-33 të këtij libri.)

Ja se ç'thuhet për zërin: Zëri është një prej dhuntive më të mëdha që Allahu i Lartë u ka ofruar njerëzve. Ç'zbrazëtitë do të ndihet në gjithësi, po të mos ishte zëri negativ apo pozitiv? Zëri është fuqia ndikuese dhe nxitëse më e madhe. Tek njerëzit zëri është një mjet komunikimi, por, kur ky zë në raste të veçanta shoqërohet me melodi tërheqëse, kthehet në një kënaqësi shpirtërore. Ashtu si midis njerëzve, zëri prodhon ndikime pozitive ose negative, edhe midis kafshëve këtë rol luan. P.sh., ulërima e luanit në pyll u shtie drithma në zemër gjithë kafshëve të dobëta, ndërsa gjarpëri, si kafshë më e ftohtë, del nga shporta e nis të kërcëjë nën fyellin e një fakiri indian.

Po tek njerëzit mund t'i referohemi Profetit të nderuar

Hz. Muhamedit, në momente të caktuara. Kur çështjet e kësaj bote i shkaktonin rëndesë në shpirt, i thoshte Bilalit: "O Bilal! Na këndo një ezan, që të lehtësohemi."

Për zërin e bukur, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), urdhëron: "Stoliseni Kuranin me zërin tuaj!" Sepse, meqë Kurani është më e bukura e fjalëve edhe bukuria e madhështia e zërit njerëzor me anë të tingullit të Kuranit, del në shesh, sepse me çdo zë ndihet ngopja, kurse me zërin e Kuranit kurrë!

Jam dëshmitar si këndues i mevludit në moshë të re e më vonë, pas vitit 1990, për të shpjeguar të mirat dhe sukseset që kemi pasur duke e zhvilluar këtë aktivitet nga një xhami në tjetrën. Kemi arritur të këndojmë mevlude në zona malore, si në Domen, Urë e Shtrenjtë, Reç, Krebe, Vallas, Bobot, si dhe përtej kufirit, në Tuz e Ulqin.

Për të mos u zgjatur, do të përmend vetëm 2-3 raste:

Do të këndohej mevludi në xhaminë e fshatit Bobot, në shpat të malit Tarabosh, buzë kufirit. Rruga nga qendra Oblikë për në Bobot bën një orë e gjysmë në këmbë. Fshati kishte pak banorë. Sot të gjithë kanë zbritur në fushë. Kur

arritëm në xhaminë e këtij fshati, ishte mbushur plot me xhemat. Kishin ardhur të ftuar nga

krahinat përreth si miq, nipa e mbesa, për të marrë pjesë në këtë aktivitet. Kjo ditë ishte kthyer në festë, si në bajram. Çdo familje ishte përgatitur për të shtruar drekë në respekt të Resulullahut. Kjo traditë është në të gjitha fshatrat. Kështu p.sh., në fshatin Trush ka një pjesëmarrje të jashtëzakonshme. Për këtë arsye, aktiviteti zhvillohet në oborrin e xhamisë. Drekat për të gjithë miqtë shtrohen në të gjitha familjet trushjane.

Një rast tjetër i veçantë ishte kur grupi ynë, me në krye ish myftiun Haxhi Faik Hoxha, shkuam të këndonim mevlud përtej kufirit, në fshatin Dinoshë, disa km larg Tuzit. Pjesëmarrja në këtë aktivitet ishte e madhe, por karakteristikë e veçantë e këtij fshati ishte se, me të mbaruar mevludi, në oborrin e xhamisë çdo familje (djallë, vajzë apo i moshuar) shpërndanin karamete e llokume, duke krijuar një mjedis hareje e gëzimi.

Po cila është dobia e këtij aktiviteti, që bëhet një herë në vit? Një sasi e konsiderueshme e pjesëmarrësve nuk janë të rregullt në kryerjen e obligueshme të namazit e, sidomos, në faljen e xhumasë, që është një obligim farz i pazëvendësueshëm. Por këta persona, duke marrë pjesë një herë në vit, përfitojnë sadopak nga Islami. Zëri melodioz në këndimin e mevludit, të ilahive e salavateve, emocionon pjesëmarrësit, duke shtuar dashurinë për Allahun e Lartë dhe të Dërguarin e tij, Rasulullahun.

Në përfundim të këtij shkrimi rezulton se mevludi sherif nuk është bidat (haram ose risi), por një aktivitet shoqëror, i cili ka dobi të madhe fetare.



Mbështetja tek Zoti

Mustafa Islamogllu

Një ditë, **Bejazid Bistami** (k.s.), po fliste mbi dorëzimin tek Zoti, *tevekkulit*.

Disa nxënës preferuan të jetonin të veçuar nga njerëzit duke iu dorëzuar Zotit.

Pa marrë asnjë ushqim me vete, duke u mbështetur vetëm tek Zoti, filluan të bënin një jetë askete.

Iu përkushtuan tërësisht adhurimit dhe devocionit ndaj Allahut.

Pasi kaloi pak kohë, frika se mund të qëndronin pa ushqim, filloi t'u shqetësonte mendjen dhe zemrën.

Ditët kalonin, por atyre nuk u vinte asnjë ndihmë e asnjë ushqim nga askund.

U shfuqizuan fizikisht, mbetën pa forcë a takat.

Iu ndërruan ndjenjat dhe mendimet.

Si mund të duronin në këtë gjendje?

Si mund të rezistonin në atë mënyrë?

Përfundimisht, me ç'panoramë do të përballëshin?

Pasi menduan gjatë, iu drejtuan Bejazid Bistamiut (k.s.), me një kërkesë:

- Zotëri, nëse na jep leje, duam të dalim të marrim pak ushqim.

Atëherë, Bejazid Bistamiu (k.s.), iu drejtua kështu:

- Nëse e dini se ku ndodhet rrisku juaj, shkoni, kërkoheni!

Pas kësaj përgjigjeje, nxënësit e zgjuar dhe inteligjentë menduan në këtë mënyrë:

Atëherë, le t'i bëjmë dua Allahut të na e plotësojë këtë nevojë dhe të na e zgjidhë këtë problem.

Bejazid Bistami (k.s.), për të provuar durimin e tyre, u drejtua përsëri:

- Nëse mendoni se Ai ju ka harruar, atëherë bëni dua.

Nxënësit thanë me vete:

Le të ulemi duke iu dorëzuar Zotit dhe të presim, të mos flasim.

Këtë herë, mësuesi i tyre u tha:

- Mos u përpiqni të sprovoni Zotin.

Nxënësit mbetën të pashpresë për zgjidhjen e problemit dhe iu drejtuan mësuesit të tyre:

- Zotëri, cila është zgjidhja, çfarë të bëjmë?

Veliu i madh i zonës së Horasanit, njëri nga rrathët e zinxhirit të artë, ai që lindi në qytetin Bisatam të Iranit dhe që ndërroi jetë po në të njëjtin qytet, Bejazid Bistami (k.s.), u dha këtë përgjigje që u hapi horizontin:

"Zgjidhja vjen pasi heq dorë nga të kërkuarit e zgjidhjes."

Pra, zgjidhja vjen atëherë kur heq dorë nga dëshirat e tua, që do të thotë t'i nënshtrohesh përcaktimit të Zotit.

Ismail Hakki Burseviu (k.s.), i cili rrëfen këtë ngjarje në *Tefisiri i Ruhul-bejan*, më pas jep këto këshilla:

“O trim! E vërteta e mbështetjes tek Zoti arrihet në momentin kur njeriu lë mënjanë dëshirat e tij.

Mosshikimi dhe mosbesimi i atyre gjërave që vep-ron.

Mbështetja tek Zoti është hyrja në zonën e pëlqimit dhe nënshtrimit ndaj caktimit hyjnor. Drejtimi i syve nga gjykimet e Zotit, për të parë se çfarë po shfaqet në skenën e Tij.

O trim! E vërteta e mbështetjes tek Zoti arrihet kur shikohet jo përmes vështrimit të gjendjes, por kur shikon përmes vështrimit të Atij që ka krijuar gjendjen.

Kur njeriu arrin këtë status, lihet pranë tij çelësi i thesarit të vendit të vet dhe ai njeri krijon pasuri shpirtërore.

Njeriu i mençur, lë mënjane relacionin me të tjerë përveç Zotit dhe i merr përsipër shqetësimet dhe vuajtjet për të arritur tek Ai që e dashuron.

Veprat e vështira janë vepra që mund t’i bëjnë vetëm njerëzit e veçantë të Allahut.

Kjo gjë është cilësi e profetëve *ulul-adhm*.

Vetëm ata e kanë të lehtë t’u bëjnë ballë vështrësive.

O trim! Ajo çfarë të duket e rëndë, ajo çfarë të thyen mesin, nuk është asgjë tjetër përveç gjynahut tënd.

Mësoje që njeriu nuk ka mundësinë e drejtpërdrejtë të fitojë dhuntitë.

Allahu i Madhëruar e ka lidhur gjithçka me një shkak.

Ka vendosur nga një kriter për secilën.

Njeriu duhet të njohë këto kritere, të gjejë shkaqet dhe t’i kërkojë ato.

Por, nëse Allahu dëshiron, edhe pa dëshiruar ata vetë, u jep atyre njerëzve që kanë fituar pëlqimin e Tij, që i ka

më pranë, më të zgjedhurit, njerëzve të sinqertë.

Përfundimet e bukura janë për njerëzit e veçantë.

Disa të mëdhenj kanë thënë kështu:

“Kërkesa buron nga edukata.”

Sepse Allahu i Madhëruar të ka krijuar që të kërkosh vetëm prej Tij.

Ti, qysh në krye të herës, je i varfër dhe i skamur.

Atëherë, kërko nga Allahu që është bujar, mos u bëj koprrac në të kërkuar.

Allahu i Madhëruar është i zoti i gjithçkaje.

O trim! Ai që ndjek epshin dhe kënaqësitë e tij nuk mund të arrijë qëllimin.

Ai që heq dorë nga respekti dhe edukata, mbetet larg mëshirës së Zotit.

Andaj dhe të mëdhenjtë kanë thënë:

“Adhurimi e shpie njeriun në Xhenet, kurse adhurimi me respekt e shpie te Zoti i Madhëruar.”

Ai që arrin te Zoti përmes respektit, nënshtrimit dhe mbështetjes tek Ai, arrin çdo gjë që dëshiron.

Allahu i Madhëruar ka njohuri për gjithçka.

Ai di çdo detaj dhe enigmë të gjithçkaje.

Kush e di se Allahu di gjithçka dhe mjaftohet në dijen e Tij, lë mënjanë ato çfarë ai mendon se di.

Duke kujtuar (dhikr) Allahun, harron të kujtojë gjithçka tjetër.

Braktis mendimet e kota dhe hipokrizitë.

Bëhet i sinqertë në çdo punë.

Përsa kohë që ky shpirt është në trup, lutemi që Allahu i Madhëruar, të na bëjë prej të devotshmëve dhe të sinqertëve, të na përfshijë tek njerëzit e Tij të veçantë dhe të na hapë dyert e punëve të mbara dhe të triumfeve të reja.

Amin!



Në demokrasit detyra sociale e grues

Këndojësit t'onë në "Zanin e Naltë" në numrat e vjetve të kaluëm kanë pasun kënduë do artikuj mbi të drejtat e grues; ato të drejta të kulluëme nga burimet e kthellte morale, para syve t'atyne qi dinë të thellojnë problemat e jetës familjare - pa dyshim - do të jenë pritur me pelqim; por nuk duhet harruë se fryma e kestreme e feministëve okzidental, ka tërhequn pas vetiut shum mendime të së rinjëve t'onë, të cilët sa do i dobishëm të jetë, po kënduen një shkrim qi mvishet në ngjyra fetare, nuk kujdesohen m'e studjuë, dhe mbas mëndjes së këtyne, të drejtën e të folunin mbi kto problema me qi duhet t'a kenë kurdoherë Dije-tarvet European, neve sot e gjetëm të pelqyëshme t'endim mendimet e shkrimtarëve të ndjerë okzidentale, tue i dhanë çashtjes një randësi të posaçme për anelizimin e mendimeve mâ lirishtë.

I zoti Beses n'a urdhnon: "Kerkoni dituninë edhe në kinë me qënë" pra edhe neve kù lindë e ke prendonë jemi të detyruëm me marrun mendimet e dobishme për përparimin e vertetë të kësaj jete.

Mos të kujtoj brezi i ri se për përparimin e njerëzisë, për mbarëvajtjen e jetës sociale, e të tjera, brënda në kufië të moralit nuk jemi përkrahësit e zhvillimit gjithëmbarshtëm.

Neve e dimë mâ shum se të tjerët qi me përdredhjen e kohës ndryshohen edhe urdhatat; por këto urdhata landore duhet të përputhen kur do herë, me nevojat shvillimtare tue mprojtun shtyllen e moralit, i cili është i vetmi faktor për përmbajtjen e jetës familjare, dhe indirektë për rregullimin e jetës sociale.

Ni pra, me kuptimet okzidentale kjoftë të shofim mâ poshtë në ket artikull ç'mejton një shkrimtar i ndjerë e i shquëm European për detyrë sociale të grues në jetën demokratike: "Përparimi i mendimevet dhe themelimevet të reja, është tue tërhequn vrejten e Botës mbi të shquemit e detyrës sociale të grues brënda në familje, në jetën e përgjithshme, aqi mâ shumë edhe në jetën politikore".

Me të vërtetë qi këjo detyrë ka një randësi shumë të madhe. Gruaja është krijuëm me një fuqimadhështore të cilën sikur-se mund t'a keq-perdoronyë, mundet t'a përdorin edhe në një mënyrë të dobishme për të gjithë; kaqi sa, me histori mund të verretohet pretenca qi thonë se vlefte e një Kombi bazohet me atë të gravet, sa mâ tepër t'atyne qi janë të martuëme ose Mëma.

Por natyrisht vlefte e gravet të martuëme dhe qi ndodhen Mëma është e bazuëm me vëndin q'u ka dhanë Ligji, n'edukatën qi marrin dhe si mbas sjellimeve qi shofim; gruja n'ato vëndra qi ka qënë nën zgjedhe, i ka shpërblyëm tue i lanë në plagësi e prapavajtje.

Sikur se ka pas thanë Sokrati qimoti në pikë pamjen mo-

rale gruja dhe burri janë një; Gruja kur të jetë e zonja me kryëm detyrat q'i ngarkon natyra në familjen, e, posaçrisht në stervitjen e të vogjelvet me një trajtë të pelqyshme, me të vertetë bâhit një dhe si e bazueme me burrim.

Mëma qi është shtylla e dashunisë dhe e respektit, para syve të djemëve të vetë mund të jetë-ase mâ mirë me thanë-duhet të jetë shëmbëlla gjallënore e detyrës dhe e vetëdijes morale; bijët para mëmës së vetë, duhet të jenë në kujdesi të madhe për mos m'u gjindë në do një lëvizje qi të quhet turpëni; Zonja e shtëpisë duhet të jetë gati-ndihmuëse dhe, shok besnik për Zotninë e vetë, por si një këshilltar qi përfitohet nga mendimi i tij; ajo shtëpinë duhet t'a përshëmbëllënjë në formë të një folesë së dashun, tue qënë vet stolija kryesora të bâhet shkaku i dëfrimit dhe shtylla e nderit të së shoqit.

Me qi do të marrohet, dhe ka me m'u bâ mëmë, duhet me i dhanë grusë një edukatë të përputhun me detyrat qi kanë me u-drejtuyëm dhe duhet treguëm një kujdesi mâ e madhe se për burrat në të stervitunit e saj.

Nga gruja nuk kerkojmë një shkelqim menduër të gjanë sa një i burrit; se pa çmuëm dispozitat naturaletë mendjes së saj - vetëm tue bamë ca perjashtime - themi se grueja, ma tepër se ç'do gjâ është një krijesë ndijësi, qi me delikatesën e këtyne përmbushet së tepermi të metat e dijenivet.

Per neve, ka një randësi ma të madhe nga të qenunit shum e ditun, ma mirë të ketë gruja edukatë dalluëse drejt të vertetës, e veprimeve të sakta tue pasun një fuqië morale të qendruëshme deri sa të jetë e përgatitun per mirë-kqyrjen e detyravet q'i ngarkonë natyra.

Gruja mbasi të jetë kështu si e dashuna (Hanriett)i e Mollierit edhe <<pa mos dijtë gjuhen Greke>> nuk ka ndalim të mos ketë <<përfutje vështrimi>>; Ajo duhet të jetë e kuptushme dhe e ditun per t'i shoqënuem burrit të vetë në mendime, per të stërvitun fëmijnë, dha ma pastaj tue kpyrë kujdesit e tyne mësimore t'u ndihmojë në studime.

Por të gjitha kto duhet të rregullohen në një mënyrë qi, gruja të merret krejtë me punrat e shtëpisë, dhe sigurimi i ushqimit familjar t'i ngarkohet burrit; dhe me të vertet kështu duhet të jetë !.

Por mjerisht ndrimi i kushtëve të aktivitetit ekonomik, ka dhanë një perfundim të kunderët drejtë kësaj qenëje të deshirueme; është tue u shtuem sasija e gravet, dhe e vajzavet qi janë të detyruëme me u ushqû me djersën e mundimit, ose per me punuë jashtë sa qi t'i vinë në ndihmë ushqimit të familjeve të tyne; kjo gjindje i ka dhanë shkak humbjes së shkelqimit dhe të defrimit familjar qi e shpjeguëm ma naltë.

Mbas mendjed s'onë kjo gjindje, ky të qenun është kundra moralit dhe interesit vitalë së kohës tanishme. Grat dal nga

dalë tue konkurencuë burrat në shumë mjeshtрина, po shkaktojnë zbritjen e fitesave ditore; nga kjo drejt per drejtë ose tërthurazi prap vetë ato janë qi po damtohen.

Si pra me ja gjetun barim shërimtar të kësaj sëmundjeje? Kjo është një çashtje delikate; per veç mirë-qellimeve të ligjëvenësve, nuk po shifet deri tash ndonji përfundim i randësishëm; per kundrazi ligji i formyluë mbi sherbimet e të vogjelvet dhe të gravet, në tezgjahe Fabrika, Kamina, dha perfundime krejtë të kunderta nga rezultati qi pritesh.

Pra edhe këtu bari i sherimit është moralisht: duhet me i mësuëm djemët të punojnë, të sterviten në moderacion dhe në ekonomië, dhe grat po në ketë mënyrë por rreth deshirës së kufizuëme qi të sherbejnë kryesisht në punërat shtëpijake; jemi të mendjes se kursimet qi do të bajnë ksodore burr e grua do t'i permbushin së tepermi fitesat e vogla qi mund të bajnë, pikë së pari në dam të shndetit gruës për së dyti në dam të jetës morale e materiale së familjes së tyne.

Gruja qi shkonë një jetë të rregullshëm tue mos u-ndamë nga shtëpija, e tue kqyrë punërat e dorës q'i kanë hije, ç'farin ndalimi muntë të ketë qi, kurë të gjëjë kohë të ngeshme, mos t'i shtojë ndo-një send fitimeve të shoqit të vetë: po të jetë kështu burrat do të fitoshin ma tepër, dhe shumica kësodore do të delte ma fituese.

Për veç këtyne n'a ngel jeta e përgjithshme, e, jeta politike; kemi disa vjetë qi ndodhemi kundrejtë pretencavet të feministëve, qi kërkujnë të ketë gruja gjithë të drejtat politike e qytetnore.

Për këtë ç'mendim duhet me u dhanë? Sa për neve nuk ka kur fare shkaku, qi gruja plotësisht mos të përfitonjë nga të drejtat qytetnore. Nuk jemi n'ato kohërat qi të pretendojmë se gruja- është ma e ulshëme nga burri në pikë-pamje mendore, dhe qi t'a pranojmë se ajo nuk ka mendje të saktë!.. "1"

Ngjarjet dhe përparimi i mendimevet tue djerrun këtë llogje të zvirhdshme e pa kuptim filluën të modifikohen drejtë kësaj pikë pamjeje edhe Ligjët; grat qi kanë arritun moshën e shëngjetimit pranohen me dishmuë ndër Lidhnira; ato qi merren me tregëti kanë të drejtë vote në të zgjedhunit e nëpunësve komercial: një gruës me burrë e martuëme po i njifet zotësia e pasunisë qi ka fitue vetë; në ketë mënyrë tue vazhduë të njoftunit e të drejtavet civile, m'u në fund është i domosdoshëm themelimi i barazimit qytetnuër midis gruës e të burrit.

Po qi mejtue të drejtat politikore, të themi se neve nuk kuptojmë prej këtyne ç'ka me fitue gruja? Kur se përkundrazi janë në shesh gjanat qi do të hupin.

Gruja tue pasun të drejtë vote e, tue u zgjedhun vetë, do të detyrohet m'u trazuë në polemikat dhe përpjekjet politike; vallë këtë a ka me qënë e zonja t'a kryej në krye pa mos cënuë dinjitetin e perestizhin si të vetin e të familjes sajë? Kur politika pergjithësisht është e rrezikshme, e pa durueshme edhe për burrat; gratë si do t'i durojnë ato përpjekje? Në kanë grat të meta nga të drejtat e tyne, ato t'i kërkujmë në moralitë e, në sjellumet e kohës qitashme: do të thohet se të marrunit pjesë të gruës në jeten politike ka me i shduk këto të meta; Por këjo a është e vertetë?

1. Mendimi i Dijetarit European.

Për neve kjo pikë është krejt e dyshimshëme; sa ma tepër kemi frikë se grat qi do të zgjidhen, dhe do të bahen kandidatë mbassi të dalin nga demogogjit politike e të kthehen në jetën familjare, do t'i kenë të dobëtueme së tepërmi shquanjësit qi duhen një mëme ase një gruje të martuëme, - kur se përkundrazi, gruja tue mos u nda nga jeta familjare e mund të bajnë efektët politike ma të dobishme, të cilat kujtojmë në mënyren e dytë duhet të jetë më e zonja me i siguruë.

Nuk ka ndonji ndalim per një gruë, m'u bamë njeri i Shteti, dhe tue u interesuë në punëra politike, me dhanë mendimin e vet për modifikimet qi duhen me u bënë në formolim të ligjëve. Gruja qi është sterviste e fëmive të vet, tue kuptuë të tanë responsabilitetin e detyrave, ka me i u mësuem atyne, rrojten në liri, dhe vajzave ka me i u sigurie veset e shquensit qi stolisin qenjen e tyne.

Ato gra, qi duhet të jenë këshilluëse të dishme në gjana mystike të vllazneve dhe të burrave të vet, tue perhedhë nder keta besime, dashuni, nderime, natyrisht kanë me i dhanë efekte ma të lumnushme mbi mendimet e urdhnimit e tyne; nga ky shkak grat në si ç'do perjudhë historike, kanë kryëm një detyrë me randësi; gjanat e mdhaja të mira ase të liga qofshin janë shpikun kurdoherë me ndihmën e saj.

Fatkeqsija shifet këtu, se ky efekti qi bajnë gratë mbi sjellimet e burrave, më fortë po duket në formë të shemtuëme të lakmive tersore. Por një gruë qi stervitet mbrenda qarkut të rregullavet themeltare qi treguën shkurtazi, nuk ngelë ndonji ndroitësi e dyshimi: fundi i fjalës idea qi duhet me u rekomanduë për edukatën e gruës është kjo: - Me i pshtuë gratë sa të jetë e mundun nga të qenunit të detyruëme me punë e me u munduë jashta shtëpis, ato para ç'do gjaje sa ma shum duhet me i stervitë per jetën familjare; me i u kthellue shëndetin e trupit me lëvizje igjenike; duhet me u futë në mendje rregullat igjenike dhe mëndyren e sundimit shpijak; tue u çelë mendjen, e tue ju shtuëm fuqinë dalluëse, duhet me i ndritëshue me tanë shkëlqimin e ditunisë për me i dhanë ndergjegjës një rrugë të saktë, dhe randësi të madhe dashunis atdheut, qi kësodore të bahen mjeti i nderit e i dhimsunis së burave, e para themeluëse stervitse të kombin të tyne.

Ato gra qi me kuptimin e ambël e të butë të fjalës sterviten në ketë mënyrë, nuk ka nevojë per jetën politike qi është jash-të jetës familjare; me gjith qi nuk i presin krejtë marëdhanjet nga kjo jetë politike prap sypr qarkut permbledhuës xen një vend të naltë.

Ato janë vet qi do të pregatitin djemt, të cilët do të mejtojnë lirisht; për mirë-sjellim të jenë respektuësa kundrejtë të drejtave të tjetrit dhe, kështu të përmirësojnë të mbetat e jëtës politike.

Gruëja edhe me një rrugë tjetër mund të trazohet në jetën e përgjithshme a nuk i ka hije vetëm e vetem asaj rregullimi e sundimi i institutave socjale ndihmtare? A nuk i perket atyne mbasi të stervitin djemtë patrijot e ushtar, tue mejtue në kohen e paqës bregat e mjerimit e luftës me u gjetun barin e sherimit sa e sa plageve të randa morale e materjale?.....

Po e shofin qi ketë detyrë të bukur ka kohë qi e kanë çmuë gratë, e përfundimet e dobishme qi janë përmbledhun deri tash na japin shpresa të mbëdhna në kohen e ardhme.

Shqiptarja në ndërtimet osmane

Si dje, ashtu edhe sot, lufta e një populli për liri dhe pavarësi të plotë, siç është rasti i Shqipërisë, është kundërshtuar mes të tjerash edhe në planin ideologjik dhe shkencor. Sipas kësaj qasjeje, shqiptarët nuk mund të flisnin gjuhën e tyre, sepse ajo nuk ishte shkruar prej kohësh dhe nuk mund të kishin shtetin e tyre, sepse nuk kishin prodhuar asnjëherë një kulturë të tyre materiale dhe shpirtërore, qoftë edhe pse nuk kishin qenë përgjegjës për këtë gjë, pasi nuk kishin qenë të pavarur.

Nevoja për të vërtetuar shqiptaren tek objektet e kultit dhe për të ruajtur xhamitë, që konsideroheshin me vlera arkitektonike dhe artistike, qoftë edhe pas asgjësimit të objekteve të kultit, qe reagim ndaj konceptit tendencioz se shqiptarët nuk kanë pasur shtet dhe, si rrjedhim, as art dhe kulturë. Si rrjedhojë edhe të gjitha vlerat krijuese në këto fusha, midis tyre edhe qytetet shqiptare, kanë qenë vepra të pushtuesve të ndryshëm. Efekti i veprës së tyre çon në mënyrë të padiskutueshme në nënvlef-tësimin e aftësive krijuese të popullit shqiptar.

Ideja e shqiptares në arkitekturën osmane, në formën që ne e njohim atë sot, ka ardhur më shumë se një konstatim dhe studimi i mirëfilltë shkencor ka qenë rezultat imperativ i nacionalizmit shqiptar.

Rasti i qasjes së studiuesve shqiptarë është i kundërt me atë të homologëve të tyre ballkanikë, që kanë shkruar në lidhje me ndikimin e artit dhe kulturës osmane mbi vendet e tyre.

Në dallim me këto qasje, në studimet shqiptare nuk është ngritur asnjëherë për diskutim çështja e ndikimit turk në zhvillimet e arkitekturës osmane, përkundrazi, përherë çështja është trajtuar vetëm nga këndvështrimi shqiptar, më saktë si shqiptarizimi i kulturës osmane nëpër shekuj.

Nevoja e kësaj qasjeje lidhet me debatet nacionale, që kanë përshkruar marrëdhëniet mes shteteve ballkanike. Dihet tashmë se shtetet ballkanike (Bullgaria, Serbia, Greqia) patën kërkesat e tyre në lidhje me shtrirjen e shteteve të tyre mbi treva të pastra etnike shqiptare, ndërkohë që Perandoria Osmane vazhonte të këmbëngulte për të zgjatur jetën e pushtetit të saj

në tokat shqiptare, edhe kur dukej qartë se ajo tashmë kishte marrë rrokullimën.

Ideja e elementit shqiptar në arkitekturën osmane në Shqipëri haset që në gjysmën e dytë të shek. XIX. Kështu, Ali Emiri, i cili e vizitoi Shqipërinë në vitin 1896, mes të tjerash do të shkruante, në lidhje me xhamitë e Tiranës:

“Xhamitë këtu janë të hijshme dhe sipas stilit karakteristik të Shqipërisë, madje mund të thuhet se stili i arkitekturës osmane, i njohur nëpër botë, është njësoj me stilin karakteristik shqiptar dhe të dy bashkë kanë nxjerrë një model të ri të veçantë. Shembujt më të bukur të kësaj arkitekture janë xhamia e Sulejman pashës (Mulleti) dhe Et’hem beut në Tiranë.”

Të gjitha xhamitë kanë komponentët e tyre funksionalë, mihrabin, minberin, mahfilin, minare, portikun (hajati) etj. Nga ana arkitektonike ato nuk janë kudo njësoj. Dallime të rëndësishme kanë gjithashtu nga përmbajtja e tyre artistike.

Në kompozimin arkitektonik dhe artistik të xhamive kanë ndikuar niveli kulturor dhe kërkesat artistike të popullsisë lokale. Përveç ndryshimeve në hapësirë, xhamitë kanë pësuar ndryshime edhe në kohë.

Prirja e studiuesve të huaj për ta konsideruar arkitekturën e krijuar në hapësirat shqiptare më shumë një zgjatje të ndikimit kulturor të vendeve pushtuese dhe sundimtare mbi Shqipëri, do të refuzohej nga historia zyrtare. Rrëzimi i kësaj qasjeje nënkuptonte nxjerrjen në pah të pikëpamjes, sipas së cilës, shqiptarët, jo vetëm që mbrujtën objektet e kultit me shumë elemente vendase, por u shkua edhe më larg, duke u pretenduar se nëpërmjet arkitekturës vendase shqiptarët, në një farë mënyre, shprehnin dhe zhvillonin një kundërshtim që shkonte deri në rebelim kundër trysnisë së forcave pushtuese, duke mbajtur në këtë mënyrë gjallë frymën e nacionalizmit shqiptar.

Të gjitha objektet e kultit islam, të njohura deri më sot në Shqipëri, i takonin arkitekturës turke osmane, me përjashtim të xhamisë së kuqe brenda kalasë së Beratit, e cila është edhe faltorja më e hershme myslimane, e diktuar deri më sot. Ajo ndodhet në qytetin e Beratit,

pranë akropolit të kalasë dhe njihet si Xhamia e Kuqe.

Tradita vendase në ndërtimin e objekteve të kultit mendohet se arriti kulmin në periudhën e tretë të zhvillimit të arkitekturës së xhamive. Një prej dukurive që shërben për të provuar veprimtarinë e fuqishme të traditës lokale në këtë periudhë dhe largimin gjithnjë dhe më shumë nga frymëzimet artistike të qendrës së perandorisë, është kalimi pa u përfillur i stilit të “periudhës së zambakut” (lale devri), i cili lulëzoi në arkitekturën turke në Stamboll, në fund të shek. XVII dhe në shek. XVIII. Si rrjedhim, etapa e tretë e zhvillimit të arkitekturës së xhamive në trojet shqiptare karakterizohet nga kërkimet dhe arritjet vetjake të arkitekturës klasike shqiptare të xhamive.

Si arsye kryesore Michael Kiel parashtron mungesën e një kontakti të drejtpërdrejtë të Shqipërisë me artin e kryeqytetit të Perandorisë Osmane në këtë periudhë.

Ky arsyetim i Michael Kiel-it nuk është bindës. Në këtë kohë kontaktet e qyteteve shqiptare me Stambollin kanë qenë më të mëdha se më parë, nëpërmjet marrëdhënieve të shtrira në të gjitha sferat.

Në etapën e tretë, e cila mund të cilësohet si koha e formimit të stilit klasik shqiptar, në arkitekturën e xhamisë dallojmë dy shkallëzime të ecurisë së saj. Ato janë periudha e kërkimeve dhe eksperimentimeve të traditës vendase, e cila nga pikëpamja kohore arrin deri në periudhën e lulëzimit të arkitekturës shqiptare osmane të xhamisë, të cilën e përfaqësojnë mjaft mirë shumë ekzemplarë, duke pranuar si shembull të parë xhaminë Kubelije në Kavajë (1735) dhe si shembull përmbyllës, xhaminë e Peqinit (1822).

Eksperimentimet në etapën e tretë u bënë në përgjithësi mbi bazën e tipologjisë së mëparshme të xhamive, domethënë, të dy tipave tashmë të përmendura. Më përfaqësuese për stilistikën arkitektonike vendase u zgjodh me prioritet tipi monumental me kupolë.

Arkitektura shqiptare-osmane e xhamisë fitoi dallime cilësore në disa drejtime, si: në gjetjen e përmasave më racionale, në formulimin planimetriko-hapësinor të sallës së faljes, hajatit dhe minares, në lidhjen e xhamisë me mjedisin urban ku u ndërtua, në gjuhën plastike të fituar nga përdorimi i teknikave tradicionale, në preferencat kromatike, ornamentale dhe dekorative që shihen në fasadat dhe në brendinë e tyre.

Në shumë monumente të artit dhe të arkitekturës të shekujve XVIII-XIX, veçanërisht në objektet e kulteve islame dhe të krishtera, mund të shihen elemente arkitektonike të frymëzuara nga dukuritë klasike bizanti-

ne, një frymëmarrje artistike, kjo në thellësi të kohës, e cila mund të cilësohet edhe si stil neoklasik shqiptar. Si elemente të këtij orientimi, në arkitekturën e faltoreve islame mund të dallohen siluetat e portikëve me arkada në hajatet e xhamive (Kavaja, Tirana, Shkodra, Peqini), në finesën e punimit të gurit në sipërfaqen e fasadave, në finesën dhe motivet arkitektonike apo zbukurimeve, me të cilat janë realizuar kolonat, kornizat e dritareve, kapitelet, kornizat e portaleve.

Përkim të plotë me shijen vendase paraqet gjithashtu në këtë kohë, piktura murale në brenditë dhe eksterierët e shumë xhamive, jo vetëm në ato të ndërtuara në këtë periudhë (xhamia e Et’hem beut në Tiranë, xhamia e Beqarëve në Berat, xhamia e Peqinit), por edhe në xhamitë më të vjetra, të cilat gjatë shekujve XVIII dhe XIX u rindërtuan (xhamia e vjetër në Tiranë, xhamia e Pazarit në Krujë dhe xhamia e Hynqarit në Berat).

Me sa duket, në traditën vendase më shumë se ndërtimit të xhamisë, rëndësi e veçantë i kushtohet minares që do të ndërtohej, e cila duhej të ishte sa më e arrirë.

Zbukurimi i ambienteve të brendshme dhe të jashtme të xhamisë me kaligrafi arabe, piktura floreale, xhami, kopshte, madje edhe skena betejash duhet parë si një nevojë e komunitetit mysliman shqiptar ndaj artit të krishterë në këto vise.

Nga pikëpamja urbane, një tjetër tipar i arkitekturës shqiptare osmane të xhamisë ishte konsolidimi i bashkëjetesës së binomit xhami-kullë sahati, brenda hapësirës së kulijes. Në këtë çështje duhet të ketë ndikuar padyshim afërsia mes viseve shqiptare dhe shteteve perëndimore.

Një tjetër karakteristikë e xhamive janë kullat e sahateve, të cilat bliheshin në shtete perëndimore. Në shekullin XVII kullat me sahat gjendeshin në Elbasan, Krujë, Berat dhe Shkodër, ndërsa në shekullin XVIII në Durrës dhe Korçë, kurse në shekullin XIX ngrihen në çdo qytet, madje edhe në fshatra.

Kuptohet që kaligrafë të ndryshëm, që patën kaluar nëpër tokat shqiptare me detyrë, kanë gjetur kohën dhe durimin të lënë zbukurimet e tyre kaligrafike nëpër xhamitë e Shqipërisë. Këtë zakon e përshkruan Evlija Çelebiu në veprën e tij, kur flet rreth xhamisë së Sinan Pashës në Elbasan, ku shkruan se: “Mbi muret e kësaj xhamie nuk ka asnjë vend të pashkruar, sepse çdo udhëtar që ka kaluar këndeje nga Anadulli, Arabia apo Persia ka shënuar mbi të pjesë poezish me kaligrafi, hadithe etj., të cilat, po t’i shkruash, bëjnë një libër të tërë.”

Filozofia Islame

Me përkthimin në arabisht që iu bë veprave të rreth tetëdhjetë shkencëtarëve dhe filozofëve mbarëbotërorë, gjatë afro 300 viteve jetë të institucionit më serioz kërkimor të kohës, **Bejtul-Hikme**, u shfaqën mjaft shkencëtarë, mendimtarë dhe filozofë të mëdhenj nga mesi i myslimanëve. (M. Kaya, "Felsefe", Islam Ans., v. 12, fq. 313.) Ndër ta mund të përmendim: **Abdul-latif el-Bagdadi, el-Biruni, el-Kindi, er-Razi, Farabi, Ibn Sina, Mulla Xhami, Mulla Sadra, Nasiruddin Tusi, Sherif Xhurxhani, Suhreverdi el-Maktul, Ibn Baxhxhe, Ibn Miskevehj, Ibn Tufejl, Ibn Rushd, Gazali** etj.

Këta filozofë myslimanë krijuan sisteme dhe metoda të ndryshme filozofike, ndër të cilat më të shquarat janë: *shkolla meshshai* (aristotelizmi islam), *shkolla ishraki* (peripatetizmi islam), *shkolla e Ihvan-i Safasë*, *shkolla e filozofisë së natyrës* etj.

Ka pasur diskutime lidhur me emërtimin e kësaj filozofie. Duke u bazuar në gjuhën dominuese të përdorur nga filozofët myslimanë, disa e kanë titulluar "*Filozofia arabe*". Disa të tjerë, duke iu referuar kontekstit gjeografik, e kanë emëruar "*Filozofia e Lindjes*". Kurse disa të tjerë, kryesisht orientalistë, duke pasur parasysh edhe qëndrimin e tyre ndaj kësaj filozofie, si një filozofi joorigjinale, kanë përdorur emërtimin "*Filozofia në islam*". (Për më gjerë, shih: A. F. el-Ehwani, *Filozofia islame*, përkth. N. Ibrahim, Zëri islam, Prizren, 2002, fq. 17 - 24.)

Vetë filozofët myslimanë, si **Farabiu, Ibn Sinai, Ibn Tufejli, Suhreverdiu** dhe **Raziu** kanë përdorur konceptet "*Urtësia e Lindjes*", "*Filozofia e Lindjes*", "*Filozofia e Ndrëqimit/Illuminate*" dhe "*Filozofia e Dritës/Nur*". Natyrisht, këtu nuk duhet të kuptojmë sensin gjeografik të fjalës "*Lindje*", por atë metafizik. "*Lindja*" këtu simbolizon Islamit si botëkuptimi i fundit që ka lindur. Andaj dhe ne, duke iu referuar edhe preferencës së shumicës së studiuesve të historisë së filozofisë, kemi parapëlqyer të përdorim konceptin "*Filozofia islame*".

Filozofia islame, në një kuptim të ngushtë, është tërësia e filozofisë së filozofëve myslimanë. Si çdo mendim tjetër në botë, edhe filozofia islame nuk është tërësisht e pavarur dhe origjinale, ndaj ajo është filozofi eklektike. Ajo çfarë e bën të tillë këtë filozofi është të bazuarit në Kuran dhe në thëniet profetike dhe ndikimi nga filozofia greko-helene.

Në këtë kontekst, filozofia islame është një manifestim i shumë cilësive të këtyre dy burimeve. Megjithatë, filozofia islame nuk është as interpretimi logjik i religjionit e as një përsëritje e filozofisë greko-helenistike. Filozofia islame është një mendim racional me bazë mendimet e

ndryshme, të marra kryesisht nga filozofët dhe filozofitë si: Platoni, Aristoteli, pitagorizmi dhe neoplatonizmi, që filozofët myslimanë i kanë vlerësuar si të përputhshme me fenë islame ose, nën direktivën e arsyes, janë përpjekur t'i interpretojnë ato si të përputhura me doktrinat islame. Kjo veçori e bën eklektike këtë filozofi. Por, një filozofi krijuese eklektive.

Veçoritë kryesore të filozofisë islame mund t'i radhisim në këtë mënyrë:

Reflektimi filozofik i filozofëve myslimanë është nën ndikimin e besimit islam. Këtë e vërejmë në referimet që ata u bëjnë shpeshherë ajeteve të Kuranit apo doktrinateve teologjike islame, ndërkohë që trajtojnë çështjet filozofike. Andaj mund të themi, se përgjithësisht filozofia islame mbart në vete nuancat e shpalljes hyjnore (*vahj*). Sado që dikush mund t'i vlerësojë si në kundërshtim me shpalljen hyjnore disa nga mendimet e filozofëve myslimanë, vetë ata filozofë kanë pasur bindjen se pikërisht ato mendime janë brenda kornizës së shpalljes hyjnore. Andaj, filozofia islame, për arsye të vetë natyrës dhe strukturës së saj, nuk është një filozofi materialiste dhe mekaniciste. Fjala vjen, në filozofinë islame ekziston koncepti *krijim*. Ekzistenca e një koncepti të tillë, mbi të gjitha është me burim nga feja islame. Ashtu sikurse në filozofinë islame, edhe në atë greke ekziston koncepti *Zot*. Mirëpo ky koncept, në këto dy filozofi është i ndryshëm. **Aristoteli** e koncepton *Zotin* thujse vetëm si një fuqi fizike, që ndodhet brenda Gjithësisë, detyra e të cilit ishte të bënte lëvizjen e parë. Kurse sipas filozofit mysliman **Farabiu**, *Zoti* është një gjallesë transcendentë, jashtë materies dhe e pavarur prej saj. Shkaku se përse **Farabiu** kishte një nocion tjetër të *Zotit*, nga ai i **Aristotelit**, mbi të gjitha është për arsye të influencës së botëkuptimit islam mbi *Zotin*.

Natyrisht, ndikimi i filozofëve nga hyjnorja është i ndryshëm. Kështu edhe raporti i rrymave filozofike islame me hyjnore është i ndryshëm. Për shembull, hyjnorja tek **gazelizmi** është më e pranishme sesa tek filozofia e **Ibn Sinait**.

Në filozofinë islame bëhet fjalë për dy lloje racionalizmas. I pari është racionalizmi që edhe ne njohim, pra, veprimi i arsyes ndaj së jashtmes. Ndërsa racionalizmi i filozofëve të mëdhenj islamë, si: **Farabiu, Ibn Sinai** dhe **Ibn Rushti** është me bazë **Aristotelin**, por edhe me ndikim të dukshëm islam. Pasi është një racionalizëm përmes koncepteve kuranore: "*kalb*", "*fuad*", "*elbab*", "*sadr*" dhe, po të përfshijmë këtu edhe *akl-i mead* (mendja që arsyeton të përtejmen) e sufistëve filozofë, **Mevlana** dhe **Junus Emre**, kjo do të thotë se në botën islame bëhet fjalë për një racionalizëm që arsyeton të jashtmen dhe të brendshmen një-

kohësisht. Racionalizëm që, krahas mendjes dhe shqisave, vë në funksion dhe një gamë vetish të tjera. Kjo mund të quhet "intelektualizëm", në kuptimin filozofik të fjalës ose "racionalizëm shpirtëror". Burimi i një racionalizmi të tillë është Islami. Këtë lloj racionalizmi kryesisht e kanë pëlqyer filozofët dhe mendimtarët e **gazelizmit, peripatetistët** dhe mistikët filozofë, si **Mevlana** dhe **Ibn Arabiu**.

ÇËSHËTJA E ORIGINALITETIT TË FILOZOFISË ISLAME

Orientalistë, si **T. J. De Boer**, mendojnë se filozofia islame është një vazhdim i thjeshtë i filozofisë greke. Kjo kategori studiuesish mendojnë se filozofia islame nuk është një filozofi origjinale. Mirëpo, çdokush që lexon filozofinë islame, lindor apo perëndimor qoftë, mjafton të jetë objektiv, do të pranojë origjinalitetin e saj. Për shembull, **Wilhelm Dilthey**, thotë se historia e shkencës dhe filozofisë islame nuk është një kopje e filozofisë greke. Ajo, thotë ai, ka një krijimtari të veçantë. Madje **Dilthey**, u kujton perëndimoreve dhe evropianëve se duhet t'u jenë mirënjohës këtyre myslimanëve për shkencën moderne që kemi sot. (Dilthey, *Einleitung in die Geisteswissenschaften*, fq. 292 - 294.)

Le ta vërejmë autenticitetin e filozofisë islame përmes këtyre pikave që po radhim:

1. NOVACIONET NË SISTEM

Filozofia islame, aq sa mban në vete vazhdimësinë e filozofisë greko-helenistike, po aq ka edhe rryma dhe sisteme që janë zhvilluar për të kundërshtuar këtë filozofi. Shembujt më të mirë për këtë janë **gazelizmi, peripatetizmi** dhe "**filozofia lindore**" (*Hikmetul-Meshrakijjin*).

2. TEORITË DHE QASJET E REJA

Filozofia islame ka prodhuar teori dhe qasje të pafund, përballë çështjeve të reja, të cilat nuk i kanë trajtuar filozofitë e mëparshme. Është e pamundur t'i përmendim të gjitha. Por le të marrim shembull disa prej tyre: qasja e ndarjes në dy pjesë e qenies, e domosdoshme dhe e mundshme, teori që ka nisur me kalamistët (apologët myslimanë) dhe **Farabiun**. Edhe koncepti i të domosdoshmes ndahet në dy pjesë, e domosdoshmja logjike dhe ajo ontologjike. Këtë koncept, i pari e ka përmendur **Gazaliu**. Sot dyshimi metodik, që njihet si *dyshimi kartezian* i **Dekartit** dhe *okazionalizmi*, që njihet si një formulim i **Malebranche**, të gjitha këto kanë burim **Gazaliun** dhe disa kalamistë para tij.

3. KRITIKA NDAJ FILOZOFËVE DHE FILOZOFIVE TË KALUARA

Një tjetër provë, që tregon se filozofia islame nuk është thjesht një vazhdimësi e filozofisë greko-helenistike, është se edhe filozofët myslimanë, madje ata më ihtarët e traditës së filozofisë greke, siç ishin **Kindiu**, **Farabi** dhe **Ibn Sinai**, kanë kundërshtuar tërësisht ose pjesërisht disa rryma apo mendime të filozofëve grekë dhe helenë, duke përfshirë këtu edhe **Aristotelin** dhe **Platonin**. Për shembull, **Farabi** ka kundërshtuar vazhdimisht **Pitagorën**, **Aristipen**, **Aristifun**, **Epikurin**, **Diogjenin** dhe

Fironin. Gjithashtu, ai ka kritikuar kryesisht këto rryma filozofike: **Skepticizmin** dhe **Stoicizmin**.

Kurse **Zekerija er-Razi**, **Ebul-Berakat el-Bagdadi** dhe pas tyre, **Davudul-Kajseri**, kanë vlerësuar si joshkencore, jo të sakta dhe kanë kritikuar konceptet kryesore të metafizikës aristoteliane; *koha* dhe *hapësira*, *aksidenca* dhe *substancia*, *lëvizja* dhe *pasiviteti/qetësia*. Fjala vjen, **Farabi** ndahet nga **Aristoteli** në çështjen e *substancës* dhe formësimit të *formës*. Gjithashtu **Farabi**, duke thënë se materia e merr *individualitetin (dhati)* nga Zoti, *mendja universale* dhe Zoti nuk janë e njëjta gjë, duke mos shikuar Zotin si qendër e Gjithësisë dhe në shumë çështje të tjera, ai ndahet dukshëm nga mësuesi i tij i filozofisë, **Aristoteli**.

4. ZHVILLIMI I TEORIVE DHE MENDIMEVE TË FILOZOFËVE TË MËPARSHËM

Autenticitetin e filozofisë islame dhe kontributin në mendimin njerëzor të saj, e shohim edhe në zhvillimin e teorisë dhe mendimeve greko-helene, që kanë bërë filozofët myslimanë. Le të japim si shembull **Kindin**, se si ai zhvilloi teorinë e **Aristotelit** dhe të **Alexandre d'Aphrodisias**, mbi kategorizimin e mendjeve. **Aristoteli** flet për dy lloje mendjesh: *Mendja teorike* dhe *mendja praktike*. Më pas, **Alexandre** shton dhe një lloj tjetër të mendjes a. *Mendja materiale*; b. *Mendja e rregullt* (intellect-habitus); c. *Mendja aktive*. Kurse **Kindi** bën edhe një shtesë tjetër: a. *Mendja aktive* (el-akl bil-fil); b. *Mendja potenciale* (el-alk bil-kuvve); c. *Mendja e rregullt* (el-akl bil-meleke) dhe d. *Mendja teorike* (el-akludh-Dhahir).

5. KRITIKA, SI NJË KOMPONENT IDENTIFIKUES I FILOZOFISË ISLAME

Filozofët myslimanë nuk kritikuan vetëm filozofët apo filozofitë greko-helene. Ata kritikuan edhe qasjet filozofike të njëri-tjetrit. Kjo do të thotë se shumica prej tyre, nuk bënë thjesht disa shtesa të njëri-tjetrit, por kanë qenë aq kritikë të njëri-tjetrit, saqë kanë krijuar sisteme të ndryshme filozofike. Fjala vjen, **Suhreverdi** dhe **Ibn Tufejli** kanë kritikuar në atë formë **Farabiun**, **Ibn Sinian** dhe **Ibn Baxhxhen**, saqë kanë arritur në **peripatetizëm**. **Gazali** në krahun tjetër, ka kritikuar po ashtu **Farabiun** dhe **Ibn Sinain**, saqë i ka paraprirë një lëvizjeje të re të mendimit islam, duke krijuar kështu **gazelizmin**. **Ibn Rushdi**, me kritikën që i ka bërë **Farabiut**, **Ibn Sinait** dhe **Gazaliut**, ka arritur në një racionalizëm shumë të thekur.

Mjafton vetëm ky detajim kaq i shkurtër mbi filozofinë islame, për të kuptuar dhe pranuar se mendimi filozofik islam zë një vend të veçantë në historinë e mendimit njerëzor. Ai ka karakteristikat e tij të veçanta dhe ka një autenticitet dhe krijimtari specifike. Nëse do të përfshinim në filozofinë islame edhe kalamistët, mistikët myslimanë, madje edhe metodistët e jurisprudencës islame (usulul-fikh), çështja e origjinalitetit të kësaj filozofie do kthjellohej edhe më tepër.

“Dhe Ai nga uji (fara) krijoi njeriun, dhe e bëri atë të ketë fis dhe miqësi.
Zoti yt ka mundësi të jashtëzakonshme”.

(Furkan, 54)

“Ai i fal femra apo meshkuj vetëm atij që do; ose u fal çift,
meshkuj e femra. Por atë që do, e lë pa fëmijë (steril);
Ai është i dijshtëm, i fuqishëm.”

(Shura, 49-50)

QËNDRIMI I SHERIATIT ISLAM NDAJ STERILITETIT, FEKONDIMIT ARTIFICIAL DHE PËRCAKTIMIT TË GJINISË SË FËMIJËS

HYRJE

Çështjet në fjalë janë disa fenomene bashkëkohore, për të cilat kanë diskutuar një numër i madh i dijetarëve bashkëkohorë dhe që, doemos, duhet të kenë zgjidhjen e tyre sipas të drejtës islame. Por, para se të fillojmë në trajtimin e këtyre çështjeve, e shohim të arsyeshme të kujtojmë se sa i ka kushtuar kujdes sheriati islam ruajtjes së gjenealogjisë së njeriut, si krijesa më e përsosur në këtë univers.

Sheriati islam e konsideron ruajtjen e gjenealogjisë së njeriut si njërën prej pesë interesave vitale, e cila kursesi nuk lejohet të cenohet. Në të drejtën islame, gjenealogjia konsiderohet si begati e dhuruar prej Allahut, me anë të së cilës njerëzit kanë mundësi të njihen mes vete dhe të kenë miqësi dhe marrëdhënie bashkëjetese shoqërore. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Dhe Ai nga uji (fara) krijoi njeriun, dhe e bëri atë të ketë fis dhe miqësi. Zoti yt ka mundësi të jashtëzakonshme.”**¹ Njohja e gjenealogjisë prej njerëzve, mundëson që ata të formojnë familje dhe se gjenealogjia nuk mund të ruhet ndryshe, veç me anë të martesës legjitime. Po ashtu, njohja e gjenealogjisë është e domosdoshme në çështjet e trashëgimisë.

E drejta islame i ka kushtuar rëndësi të madhe ruajtjes së gjenealogjisë, ndaj në mënyrë shumë të qartë dhe të prerë e ka ndaluar prostitucionin dhe e ka konsideruar si njërin prej mëkateve më të mëdha. Po ashtu, sipas të drejtës islame, është e ndaluar që dikujt t'i përshkruhet gjenealogjia dhe t'i përcaktohet dikush si prind, pa qenë prind i tij. Transmetohet nga Se'ad bin Vekasi (r.a.), se i Dërguari (s.a.v.s.), ka thënë: **“Kush e paraqet veten si fëmija i dikujt, të cilin nuk e ka baba, për të xheneti është**

1. Kaptina el-Furkan: 54.

i ndaluar.”²

Feja islame i konsideron fëmijët si begati, zbukurim dhe sprovë për njeriun. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote, kurse veprat e mira (fryti i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi dhe shpresa më e mirë te Zoti yt.”**³, **“Dhe, dijeni se pasuria e fëmijët tuaj janë vetëm një sprovë dhe te Allahu është shpërblimi i madh.”**⁴.

Pa dyshim se martesë dhe lindja e fëmijëve janë dy cilësi të lavdëruara dhe fisnike, ku martesë krijon në mes bashkëshortëve ndjenjë e dhembshurisë dhe dashurisë prindërore, ndjenjë e cila bëhet shkak për të vazhduar lloji njerëzor. E drejta islame, përveç se kërkon martesën në mënyrë të prerë, kërkon lindjen e fëmijëve dhe shumimin e llojit njerëzor. I Dërguari (s.a.v.s.), përveç se nxit në martesë, kërkon që myslimani të zgjedhë për bashkëshorte atë femër që ka mundësi të lindë. **“Të martosh një grua që nuk është e hijshme, por që ka mundësi të lindë, është më mirë se sa të martosh një grua të bukur, por që është sterile”**⁵. **“Martohuni me ato që janë të dashura dhe që lindin, se unë do të mburrem me ju në ditën e kiametit, para popujve të tjerë”**⁶.

STERILITETI

Për shkak të sterilitetit të njërit apo të dy bashkëshortëve, ata nuk mund të lindin fëmijë. Prandaj duhet analizuar nëse sheriati islam e konsideron sterilitetin sëmundje? Kur i shikojmë dhe analizojmë se çfarë përcaktimi i kanë

2. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

3. El-Kehf: 46.

4. El-Enfal: 28.

5. Transmeton Taberaniu dhe Dejemliu.

6. Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

dhënë dijetarët islamë sëmundjes, do të mund të arrijmë deri të përfundimi se edhe sterilitet konsiderohet një lloj sëmundjeje, që duhet të trajtohet. Sipas dijetarëve islamë sëmundja është një pengesë jo e zakonshme në trup që i shkakton probleme njeriut. Prandaj edhe steriliteti është një proces jo i zakonshëm për njeriun dhe me shumë të drejtë mund të konsiderohet si sëmundje.

Pasi steriliteti konsiderohet si sëmundje, atëherë, sipas shariatit islam, lejohet trajtimi dhe shërimi nga kjo sëmundje, kuptohet, nëse është e mundur. Lejohet trajtimi i sterilitetit, nëse bëhet në përputhje me parimet dhe rregullat e shariatit, pra në atë mënyrë që trajtimi të mos i shkaktojë pacientit dëme anësore, në aspektin shëndetësor dhe që mënyra e trajtimit të mos vijë në kundërshtim me "Dëmi duhet të eliminohet, por jo duke shkaktuar dëm tjetër të ngjashëm me të apo edhe më të madh se ai". Për këtë, juristët islamë kanë thënë: "Kur ndodh që njeriu detyrohet të hajë ndonjërin prej ushqimeve që është haram, atij i lejohet sa për ta kaluar urinë dhe krizën e jetës, por në këtë gjendje nuk i lejohet të përdorë helm, ngase dihet se ai është vdekjeprurës. Pra, nëse trajtimi i sterilitetit shkakton dëm tjetër të ngjashëm apo edhe më të madh, atëherë nuk lejohet me shariat trajtimi.

Të gjithë dijetarët janë unanimesë se lejohet trajtimi i sterilitetit, përderisa mund të realizohet pa shikuar në pjesët gjenitale. E kur ndodh që gjatë trajtimit duhet të shikohet në pjesët gjenitale, atëherë dijetarët kanë divergjencja mes vete dhe ndajnë mendime të ndryshme.

Një pjesë e dijetarëve janë të mendimit se steriliteti nuk lejohet të trajtohet, nëse kërkohet që gjatë trajtimit të shikohen organet gjenitale, sepse, sipas shariatit islam, të shikuarit në pjesët gjenitale është vepër e ndaluar. Andaj sipas këtyre dijetarëve, nuk lejohet të shikohet në pjesët gjenitale për trajtimin e sterilitetit, vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur është në rrezik jeta e njeriut.

Dijetari i mirënjohur hanefit Ibn Abidini (r.a.), ka thënë: "Mjeku mund të shikojë vendin e sëmurë, aq sa është e domosdoshme, prandaj edhe nevoja e jashtëzakonshme përcaktohet sipas domosdoshmërisë. Duhet mësuar femrën që të dijë të mjekojë femrën, me arsyetimin se shikimi në trupin e tjetrit nga gjinia e njëjtë, është e keqja më e lehtë. Më pas, Ibn Abidini ka bërë transmetimin nga librat e njohur hanefitë: "Kur ndodh që sëmundja është në gjithë trupin e njeriut, përveç në organin gjenital, atëherë lejohet të shikohet në trup, për shkak të domosdoshmërisë së shërimit. E nëse ndodh që sëmundja është në vetë organin gjenital, atëherë duhet mësuar ndonjë femër se si të trajtojë sëmundje të tilla. Po qe se ndodh që nuk gjendet femër mjekje dhe ekziston frika se pacientja do të shkatërrohet apo do të ketë pasojë të mëdha, atëherë lejohet ta mjekojë mashkulli, por, sa të jetë e mundur, të largojë shikimin dhe ta përqendrojë

atë vetëm në vendin ku duhet trajtuar sëmundja".

Në një prej librave të njohur të medh'hebit shafitë "Mugnil Muhtaxh Ila Mearifeti Elfadhil Minhaxh", thuhet: "Lejohet prekja dhe shikimi, kur është fjala për gjakosje, hixham (hedhje e kupave) dhe shërim. Andaj, kur ndodh që duhet bërë trajtim i domosdoshëm duke shikuar në organin gjenital, atëherë lejohet që mashkulli të trajtojë femrën dhe anasjelltas, por me kusht që gjatë trajtimit të jetë dikush i afërm i pacientit (mahrem) apo ndonjë burrë a grua besnike. Kjo lejohet, kur nuk ka femër mjekje për ta trajtuar femrën. Mjeku, që është mysliman, ka përparësi në trajtim të femrës, ndaj mjekut që është dhimij (jomusliman, që jeton nën mbrojtjen e shtetit islam), mjekja jobesimtare ka më shumë përparësi për trajtimin e femrës ndaj mjekut mashkull mysliman..."⁷.

Një pjesë e dijetarëve janë të mendimit se femra duhet të kontrollohet tek gjinekologu dhe të ketë nën kontroll shtatzëninë, për shkak se kjo është në të mirën e frytit dhe vetë asaj. Prandaj, ky veprim është një interes dhe e mirë, për shkak se femra është e qetë për shëndetin e saj dhe të frytit që ka. Këta dijetarë e mbështesin mendimin e tyre në rregullën e shariatit "Pengimi i së keqes i para-prin veprimin të së mirës".

Nga fjalët e mësipërme të juristëve myslimanë del në pah se dukja e organeve gjenitale nuk lejohet kurrsesi, përveç në raste të jashtëzakonshme.

Lind pyetja: a është, vallë, steriliteti rrezik përherëshëm për jetën e femrës, duke qenë se nuk i shkakton asaj dhimbje të mëdha dhe të padurueshme? Përgjigja është se steriliteti nuk është sëmundje që rrezikon jetën e femrës dhe nuk i shkakton dhimbje të padurueshme asaj. Në raste të tilla, si myslimani ashtu edhe myslimania, duhet të durojnë, t'i kenë frikën Allahut të Madhëruar, të jenë të kënaqur me caktimin e Allahut të Lartësuar, të mos i tejkalojnë ligjet e Allahut dhe ta kenë të qartë se lumturia nuk është vetëm në lindjen e fëmijëve, sepse ndodh që fëmijët të jenë shkak i mundimit dhe i jolumturisë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Sipas kësaj, mund të nxjerrim si përfundim se kontrolli gjinekologjik duke shikuar në organin gjenital, kur nuk është i domosdoshëm, është veprim i ndaluar (haram). Por nuk duhet kuptuar se është e ndaluar shkuarja të gjinekologu për të bërë trajtime të atilla ku nuk shikohet në organin gjenital dhe në pjesët e turpshme. Allahu e di më së miri.

FEKONDIMI ARTIFICIAL

Pa dyshim, fenomeni i fekondimit artificial është shumë i përhapur në kohën tonë dhe natyrshëm do të lindë pyetja nëse lejohet, sipas së drejtës islame. Para se të

7. Hashijetu Ibn Abidin 5/237.

8. Mugnil Muhtaxh: 3/133.

ofrojmë mendimin e dijetarëve myslimanë rreth këtij fenomeni, do të përmendim disa prej mënyrave të fekondimit artificial.

1. Fekondimi artificial, duke injektuar spermën e burrit në brendësi të mitrës së gruas.

2. Fekondimi artificial, duke marrë spermën e mashkullit dhe vezoret e femrës, për t'i fekonduar në epruveta e për të mbjellë frytin në mitrën e gruas.

Fekondimi artificial bëhet sipas këtyre metodave:

a. **Metoda e parë.** Merret sperma e bashkëshortit dhe injektohet në brendësi të bashkëshortes në mënyrë që të mund të fekondohen natyrshëm siç ndodh me marrëdhënie seksuale. Kjo metodë përdoret, kur sperma e bashkëshortit nuk mund të arrijë natyrshëm deri në vendin e duhur për t'u fekonduar.

b. **Metoda e dytë.** Merret sperma nga ndonjë burrë i huaj dhe i vendoset femrës në brendësi, me qëllim të arritjes deri tek fekondimi, ngase sperma e burrit legjitim nuk është në gjendje të bëjë fekondimin.

c. **Metoda e tretë.** Merret sperma e burrit dhe vezoret e gruas dhe vendosen në epruvetat laboratorike e, pasi të arrihet fekondimi merret, fryti dhe vendoset në mitrën e gruas për t'u zhvilluar dhe lindur në mënyrë të natyrshme.

ç. **Metoda e katërt.** Merret sperma e burrit dhe vezoret e një femre të huaj dhe vendosen në epruvetë për t'u fekonduar. Kur arrihet fekondimi, vendoset fryti në mitrën e gruas legale. Kjo mënyrë përdoret, kur vezoret e femrës nuk janë në gjendje të fekondohen, ndërsa mitra ka mundësi të rritë dhe të lindë fëmijën.

d. **Metoda e pestë.** Merret sperma e burrit dhe vezoret e në gruaja të huaj, bëhet fekondimi në epruvetë dhe, pas fekondimit, merret fryti dhe vendoset në mitrën e ndonjë gruaja të martuar. Ky veprim zbatohet, kur gruaja është sterile, por edhe nuk mund ta rritë frytin në barkun e saj.

e. **Metoda e gjashtë.** Merret sperma e burrit dhe vezoret e gruas dhe vendosen në mitrën e një gruaja të huaj, me qëllim që ajo ta lindë fëmijën. Kjo metodë përdoret, atëherë kur gruaja i ka vezoret e shëndosha, por mitra e saj nuk mund ta bartë frytin deri në lindje apo gruaja nuk ka dëshirë për ta lindur foshnjën vetë.

Konsiliumi i juristëve myslimanë, pas një studimi të hollësishëm të metodave të fekondimit artificial, sjell këto konkluzione:

KUSHTET PËR TU ZBATUAR FEKONDIMI ARTIFICIAL

1. Që fekondimi artificial të jetë nevojë e domosdoshme, pra, kur burri dhe gruaja kanë nevojë për fëmijë dhe nuk kanë mundësi ta lindin natyrshëm.

2. Që vezoret e gruas dhe sperma e burrit të jenë prej dy bashkëshortëve legjitimë, duke mos pasur ndonjë përzjerje prej spermës apo vezoreve të dikujt tjetër, ngase fekondimi do të jetë i ndaluar rreptësisht, për shkak të përzjerje së gjenealogjisë.

3. Nuk lejohet të paguhet ndonjë grua për ta bartur frytin deri në lindje, kur merren vezoret dhe sperma e bashkëshortëve e vendosen te një grua e huaj.

4. Që fekondimi artificial të bëhet prej mjekeve apo mjekëve myslimanë, që janë të besueshëm, duke i marrë të gjitha masat e duhura që të mos ketë përzjerje të spermës apo vezoreve të huaja.

KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME

1. Zbulimi i pjesëve të turpshme të femrës është vepër e ndaluar, sipas shariatit, përveç në raste të jashtëzakonshme, kur ka mundësi të lejohet shikimi në pjesët e turpshme.

2. Lejohet zbulimi i pjesëve të turpshme, kur ndodh që ka dhimbje dhe sëmundje që duhet trajtuar patjetër. Por në këtë rast, do të shikohet ajo pjesë që doemos duhet shikuar për trajtim.

3. Kur femra detyrohet të kërkojë trajtim, për shkak të sëmundjes që ka, atëherë duhet kërkuar që ta trajtojë ndonjë mjekë myslimane e, nëse nuk ka të atillë, atëherë lejohet ta kontrollojë femra jomyslimane. Nëse edhe kjo nuk është e mundur, atëherë lejohet të trajtohet nga mjeku mysliman besnik e, po qe se edhe ky nuk gjendet, atëherë lejohet ta trajtojë edhe mjeku jomysliman. Kur të trajtohet, femra nuk duhet të mbetet e vetmuar me mjekun, por duhet të jetë prezent bashkëshorti apo ndonjë grua tjetër.

KONKLUZIONE QË KANË TË BËJNË ME FEKONDIMIN ARTIFICIAL

1. Gruas dhe burrit që nuk kanë mundësi të lindin apo të kenë fëmijë, për shkak të ndonjë sëmundjeje, u lejohet të kërkojnë shërim në mënyrat e lejuara edhe me anë të fekondimit artificial.

2. Metoda e parë, që përmendëm më lart, është e lejuar, me kusht që të plotësohen rregullat që përmendëm për këtë rast. Pra, kjo zbatohet, kur vërtetohet se është më së e nevojshme kjo mënyrë e fekondimit për të arritur deri tek lindja.

3. Përsa i përket metodës së tretë, edhe kjo është e lejuar në aspektin parimor, por ekzistojnë disa dyshime në aspektin e fekondimit në epruvetë. Andaj, kjo metodë, në parim, është e lejuar, por duhet të plotësohen kushtet e përmendura më lart dhe duhet përdorur vetëm në raste të jashtëzakonshme.

4. Në metodën e parë dhe të dytë lejohet fekondimi artificial, për shkak se prejardhja e fëmijës është prej të

dy prindërve të njëjtë dhe në këtë mënyrë, realizohet e drejta e trashëgimisë dhe ruajtja e gjenealogjisë.

5. Katër metodat e tjera, të cilat mund të realizohen në dy mënyrat e fekondimit artificial, janë të ndaluar rreptësisht, sipas së drejtës islame. Këtu nuk ka asnjë mundësi të lejimit, për shkak se sperma dhe vezoret nuk janë të bashkëshortëve legjitimë.

Sipas këtyre shpjegimeve juridike, konsiliumi i juristëve myslimanë është i mendimit që myslimanët të mos i praktikojnë, madje, as edhe metodën e parë dhe të dytë që, sipas tyre, konsiderohen të lejuara, për shkak të dyshimeve dhe hamendjeve të shumta, përveç se në raste të jashtëzakonshme dhe të domosdoshme.

Ky është qëndrimi i konsiliumit të juristëve myslimanë të Ligës së Botës Islame, mbajtur në Meke, seksioni i VII në katër seminare të ndara, mbajtur prej datës 28.04.1405, deri më 07.05.1405, sipas vitit hënor.

PËRCAKTIMI I GJINISË SË FËMIJËS

Përcaktimi i gjinisë së fëmijës mund të realizohet me anë të tri metodave:

Metoda e parë. Përdorimi i ushqimeve natyrale. Kjo metodë është e lejuar dhe nuk ka kurrfarë të keqeje.

Metoda e dytë. Ndërrhyrja mjekësore për të bërë zgjedhjen e gjinisë në mitër. Kjo metodë nuk lejohet, vetëm në raste të jashtëzakonshme për të bërë shërimin e sëmundjeve trashëguese. Kjo metodë ndalohet, sepse, me anë të ndërhyrjes mjekësore, kërkohet të bëhen disa veprime të ndaluara, siç është: masturbimi, shikimi në pjesët e turpshme dhe mundësia e përzierjes së spermës dhe vezoreve të huaja, të cilat ruhen në banka të veçanta.

Metoda e tretë: Përcaktimi i gjinisë gjatë fekondimit artificial. Në këtë rast lejohet përcaktimi i gjinisë, kur ndodh që fekondimi artificial të jetë i lejuar.

Konsiliumi i juristëve myslimanë në Ligën e Botës Islame, seksioni i IX, i mbajtur në Meke më datë 22-27, Sheval, 1428 h. /3-8 shkurt 2007, pas një studimi të hollësishëm të kësaj çështjeje, sjell këtë konkluzion:

Të gjithë janë të mendimit se në parim çdo mysliman duhet të jetë i kënaqur me caktimin e Zotit. Të jetë razi me caktimin e fëmijës së tij, qoftë djalë apo vajzë dhe se duhet ta falënderojë Allahun e Lartësuar për zgjedhjen që i ka përcaktuar atij. Në Kuranin Fisnik përmendet zakoni i keq i kohës së injorancës: **“Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij prishet dhe bëhet plot mllef. Fshihet prej njerëzve, për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua (e konsideron bela e jo dhuratë prej Zotit). Mandej, (mendon) a do ta mbajë atë, ashtu i përrulur apo do ta mbulojë (të gjallë)**

në dhe. Sa i keq është ai gjykim i tyre”⁹⁹. Nuk ka kurrfarë të keqeje, që njeriu të dëshirojë të ketë djalë apo vajzë, duke u mbështetur në faktin se Kurani jep sinjal të: disa prej të dërguarve të Allahut kanë bërë dua që t’u lindë djalë. Duke u bazuar në këto shpjegime, konsiliumi sjell këto konkluzione:

1. Lejohet zgjedhja e gjinisë së fëmijës me anë të metodave të natyrshme, siç është përcaktimi i ushqimeve të veçanta, përcaktimi i kohës së kryerjes së marrëdhënieve seksuale. Arsyeja e lejimit është se këto janë mënyra të lejuara.

2. Nuk lejohet ndërhyrja e mjekut në zgjedhjen e llojit të gjinisë, veç në raste të jashtëzakonshme, kur është i domosdoshëm trajtimi i sëmundjeve trashëguese, të cilat godasin meshkujt apo anasjelltas. Në raste të tilla, lejohet ndërhyrja e mjekut, por më kusht që të respektohen rregullat e sheriatit dhe ndërhyrja duhet të jetë me vendimin e komisionit prej mjekëve specialistë që, së paku, duhet të jenë tre dhe, që në fillim, duhet të sillt raportin mjekësor e më pas, ky raport t’i jepet komisionit që të japë fetva (përgjigje juridike islame).

3. Duhet doemos, të formohen komisione për inspektimin direkt dhe të saktë nga vetë spitalet dhe qendrat mjekësore, me qëllim që të mos lejohet ndonjë veprim jolegjitim.

PËRFUNDIM

Pas gjithë këtyre shpjegimeve, mund të sjellim si konkluzion se myslimani dhe myslimania duhet të largohen nga fekondimi artificial, vetëm për të plotësuar dëshirën për të pasur fëmijë, ngase Allahu di më së miri kujt t’i japë vajzë e kujt djalë apo cilin të lërë steril. Kjo, se ky veprim, sado që të jetë i sigurt, ka hapësirë për dyshime, ndaj le të ndodhë fekondimi dhe përcaktimi i llojit të gjinisë, vetëm në raste të domosdoshme dhe të jashtëzakonshme, të detyrueshme për një trajtim të atillë.

LITERATURA:

1. Dr. Muhammed el-Barri: Ahlakijatu Telkihil Istn’iji.
 2. Dr. Muhammed el-barri: Halkul Insan Bejne Tibbi Vel Kur’an.
 3. Dr. Bekri Ebu Zejd: Fikhu Nevazil.
 4. Dr. Zuhejr Sibai: Et-Tabibu Edebuhi ve Fikuhu.
 5. Dr. Muhamed Halid Mensuri: El-Ahakamu Tibbijeti el-Mutel-lekatu Bin-Nisai.
 6. Mustafa Zerka: Et-Telihu Sinaiju.
 7. Mexhmuatul Fetva Sherijeti es-Sadireti An Kitail Iftai vel Buhuthi Sher’ijeti. Kuvajt.
 8. Mexhel-Ietul Fikhil Islamijj nr. II, pjesa e I, nr. III pjesa e I.
 9. El-Mexhel-Ietul Fikhjetu el-Muasiretu.
 10. Dr. Jusuf el-Karadavi: Fetava Muasireh.
 11. Dr. Jusuf el-Karadavi: El-Halalu vel Haramu.
 12. Mahmud Sheltuti: Fetava Muasireh.
 13. Muhammed Burhanu Din es-Sunbehliju: Kadaja Fikhjetun Muasiretun.
 14. Prof. Dr. Vehbete Zuhajli: el-Fikhul Islamijju ve Ediletuhu.
 15. Zejd Subhi Dhijab: Ahkamu Ukmil Insan fi Sheriatil Islamijeti.
 16. Abdul Hamid Mahmud Tuhmaz: El-Ensabu vel-Evladu.
9. En-Nahl: 58-59.

EBU FEREXH EL-ISFEHANI DHE VEPRAT E TIJ "EL-EGANI", ENCIKLOPEDIA KLASIKE E MUZIKËS ARABE

Ebu Ferexh el-Isfehani lindi në vitin 897, në qytetin e Bagdadit. Gjyshi i tij Muhamed b. Ahmedi qe njëri nga paria e njohur e qytetit të Samerras, ndërsa xhaxhai i tij, Hasan b. Muhamedi, një nga sekretarët e rëndësishëm të halifit abasi, Mutevekil Alellah. Familja e tij, një nga familjet më aristokratike të Bagdadit, u njoh si Isfahani (Isfahanasit) ndoshta për faktin se gjatë periudhës së raprezaljeve të dinastisë emevite qenë detyruar të emigrojnë dhe të jetojnë në qytetin e Isfahanit (ku gjendet).

Ebu Ferexhi i mori mësimet e para në vendlindje, ndërsa më pas shkoi në Kufe, ku mësoi dhe zhvilloi njohuritë e tij në lidhje me gjuhën dhe letërsinë arabe, historinë dhe hadithin. Pasi u kthye në Bagdad, ai i avancoi edhe më shumë njohuritë e tij në shkencat e gramatikës dhe letërsisë arabe, në histori, tefsir, hadith, muzikë, astrologji dhe mjekësi. Nga veprat e tij mësojmë se ai pati shëtitur nëpër qytete të ndryshme të rëndësishme, si Basra, Kufe, Raka dhe Antakia.

Pasi e përfundoi ciklin e mësimëve, Ebu Ferexh u kthye në Bagdad ku filloi të jepte mësim në fusha dhe shkencat të ndryshme, aq sa fama e tij u përhap ngado dhe në rrethet e tij të diturisë nisën të vinin edhe studentë nga jashtë Bagdadit. Në tubimet e tij të mësimdhënies merrnin pjesë edhe muhadithët e njohur, Darekutni, Ebu Ishak Taberi, Ali b. Ahmed Rezaz, Ebu Zekerija Jahja b. Malik b. Aiz Endelusi, si dhe gjuhëtarët dhe letrarët e njohur arabë, Ali b. Dinar dhe Ebu Ali Muhasin Tenuhi. Pikërisht Ali b. Dinar, do të merrte leje prej tij që të raportonte veprën e njohur të Ebu Ferexhit, Kitabu'l-Egani.

Dijetarët e kohës merrnin pjesë edhe në kuvendimet e Ebu Ferexhit, pasi ai kishte njohuri të gjera në fushën e gjuhës dhe të letërsisë, dijeni të shumta në fushën e historisë, si dhe ishte orator dhe hokatar në bashkëbisedim.

Kur miku i tij Hasan b. Muhamed Muhellebi u emërua si veziri i prijësit buvejhi, Muizudevle, Ebu Ferexhin e mori si nedim të tijin, detyrë të cilën ai e vazhdoi për trembëdhjetë vjet, gjatë të cilave nuk i mungoi asnjëherë përkrahja morale dhe financiare e vezirit.

Ebu Ferexhi gëzonte edhe mbështetjen e Emevive të Andaluzisë, madje veprat e tij u bënë të famshme më parë në Andaluzi, sesa në pjesën tjetër të botës islame.

Ebu Ferexhi qe edhe poet i njohur dhe kritik i sprovuar për letërsinë arabe, por ai u bë i njohur më shumë si historian i kulturës arabe, më saktë i muzikës arabe. Ai i ushqente dhe kujdesej për kafshët shtëpiake që mbante, një mace, një gjel dhe një dele, për të cilat pati shkruar nga një elegji kur i patën ngordhur.

Mendimi se Ebu Ferexhi i përkiste sekti shia nuk është i saktë. Si bashkëkohësit e tij Ibn Nedim dhe Ibn Nuajm el-Isfahani, të njohur si bibliografë, ashtu edhe dijetarët e hadithit, Darekutni, Ali Rezaz dhe Ibn Duma, nuk patën shkruar asgjë në lidhje me këtë çështje dhe patën raportuar prej tij. Studimi i librave që ai shkroi, të cilat kanë mbërritur deri në ditët e sotme, nuk përmbajnë të dhëna që do të tregonin se Ebu Ferexhi mbronte apo shprehte ndonjë pikëpamje të tillë.

Në vitet e fundit të jetës Ebu Ferexhi pati probleme me shëndetin, pasi u paralizua dhe filloi të humbte edhe mendjen. Vdiq në vitin 967, në Bagdad.

Burimet kanë regjistruar faktin se Ebu Ferexhi pati shkruar rreth tridhjetë vepra të ndryshme në lidhje me historinë arabe, poezinë dhe poetët arabë, muzikën dhe muzikantët, si dhe në lidhje me disa tema të tjera, por vetëm katër prej tyre kanë mbërritur deri në ditët e sotme.

Ato janë *el-Egani*, *Mekatilu't-Talibijn*, *Imau'sh-shevair* dhe *Kitabu edebi'l-gureba*.

el-Egani është vepra kryesore dhe më e rëndësishme e Ebu Ferexhit, e cila e bëri të paharrueshëm autorin e saj. Në këtë vepër trajtohen këngëtarët dhe kompozitorët arabë që jetuan gjatë pushtetit 90-vjeçar emevit dhe në periudhën e parë të pushtetit abasi, meloditë dhe kompozimet e tyre. Në këtë vepër, Ebu Ferexhi jep të dhëna rreth motivit të këngës, kompozimit dhe kompozitorit, sikurse jep të dhëna rreth tekstit të poezisë, fjalëve të panjohura, që gjenden në to, jetës së poetit dhe kompozitorit, personit të cilit i dedikohej kompozimi, si dhe këngëtarët që u bënë të njohur me interpretimin e saj.

Për mbledhjen e këtyre të dhënave Ebu Ferexhi ka përdorur burimet e shkruara që ka hasur, ngjarjet që ka parë me sytë e tij apo që ka dëgjuar prej të tjerëve. Vepra e tij *el-Egani*, mes të tjerash, ka rëndësi edhe për faktin se Ebu Ferexhi citon në të veprat që ka konsultuar, një pjesë e të cilave nuk kanë mbërritur deri në ditët tona, regjistron si dëshmitar okular ngjarje që kanë ndodhur në vitet që ka jetuar, si dhe përcjell zakonet dhe traditat e asaj kohe.

Vepra e tij gëzoi simpatinë e njerëzve të letrave, që kur u shkrua dhe deri në ditët e sotme. Vetë Ibn Halduni e pati vlerësuar shumë pozitivisht veprën e tij. Megjithatë, vepra e tij u kritikua për faktin se ai raportonte gjithçka në të, pa u treguar i kujdesshëm në lidhje me raportuesit, që mund të ishin të njohur edhe si gënjeshtarë (kadhib), i regjistronte informacionet ashtu siç ishin, pa u treguar përzgjedhës në lidhje me to, rrëfente gjëra negative për periudhën dhe disa personalitete të atyre periudhave me një gjuhë shumë të pështjelluar dhe që nuk përputhet me imazhin e përgjithshëm ndaj tyre, shkruante të njëjtën poezi apo tregonte të njëjtën ngjarje për persona dhe poetë të ndryshëm.

Ashtu siç do të pohonte edhe ai vetë në hyrje të veprës së tij, veprën *el-Egani* nuk e kishte shkruar me qëllim që të nxirrte në dritë një vepër historike, por më shumë një vepër labirintesh për lexuesin.

Megjithatë vepra e tij, ashtu siç do të shkruante edhe Ibn Halduni, që "një kryevepër, të cilën nuk e hiqte nga duart asnjë letrar", për shkak të

informacionit të pasur dhe ndonjëherë të rrallë që përmbante, në lidhje me zhvillimin historik të muzikës arabe.

Kopjet e ndryshme të veprës *el-Egani* gjenden në bibliotekat kryesore të botës. Për herë të parë u botua në vitin 1285 H në Bulak, në njëzet vëllime. Në vitin 1888, orientalisti gjerman Rudolf Brünnoë, botoi në Leiden, një vëllim, në të cilin përmbledhi tekstet që nuk gjendeshin në botimin e Bulakut, por gjendeshin në kopje dorëshkrimesh të ndryshme të veprës.

Në vitin 1900, orientalisti italian, I. Guidi botoi në Paris një vëllim indeks të përmbajtjes së veprës në fjalë, të cilin e titulloi Xhedavilu kitabil-egani.

Botimi i fundit i plotë i veprës u realizua në Kajro, në njëzet e katër vëllime, mes viteve 1970 dhe 1974. Përveç kësaj, veprës i janë bërë edhe pesë botime të tjera kritike në vitet më pas.

Vepra e tij është botuar në formë të shkurtuar (muhtasar), dhjetë prej të cilave njihen deri më sot, më e vjetra prej të cilave i përket shek. XI. Gjithashtu, të dhënat që ndodhen në veprën Egani në lidhje me gratë, me personalitetet, me këngëtarët dhe skllavet artiste, me figurat politike të periudhës emevite dhe abaside dhe me kuzhinën arabe, janë botuar si vepra më vete.

Mekatilu't-Talibijn flet në lidhje me viktimat e Ehli bejtit, duke filluar prej vrasjes së Xhafer b. Ebu Talibit, në vitin 629 dhe deri në periudhën e sundimit të halifit Muktedir Bilah, periudhë e cila përfundoi në vitin 932. Në këtë vepër jepet bibliografia, shkak i vrasjes, vrasësit dhe mënyra se si u ekzekutuan. Një botim kritik i veprës u botua në vitin 1949 në Kajro nga Sejid Ahmed Sakr.

Imau'sh-shevair, në të cilën flitet për skllavet poetë. Vepra është botuar në vitin 1984 në Bejrut, nga Nuri Hamudi Kajsi dhe Junus Ahmed Samerrai, të cilët kanë hequr nga origjinali shprehje dhe pjesë që i kanë konsideruar jashtë edukate.

Kitabu edebi'l-gureba, vepër në të cilën janë përmbledhur vjershat e personave në kurbet, në lidhje me mallin dhe vështirësinë e kurbetit. Vepra është botuar në vitin 1972 në Bejrut, nga Salahudin Munexhidi.

Profeti i mëshirës

Allahu (xh.sh.), thotë në Kuran: **“Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha botët.”** (Enbija, 107) Muhamedi (a.s.), nuk u dërgua vetëm për popullin apo familjen e tij, por për të gjithë njerëzit.

Fjala mëshirë është përmendur në Kuran më shumë se dyqind e gjashtëdhjetë e tetë herë. Në shumicën e këtyre vendeve, fjala mëshirë është përmendur në trajtë emri. Për shembull, në ajetin 37 të sures Bekare, në të cilin Allahu thotë: **“Me të vërtetë, Allahu i pranon shumë pendimet, Ai është Mëshirëploti.”** Ndërsa në trajtë foljeje, fjala mëshirë është përmendur katërmëdhjetë herë. Për shembull, në ajetin 149 të sures A'raf, Allahu thotë: **“Ata thanë: “Nëse Zoti ynë nuk na mëshiron dhe nuk na fal, me të vërtetë do të jemi të humbur!”** Fjala “mëshirë” përmban mirësinë, dhembshurinë, dashurinë, miqësinë, lumturinë, përmirësimin, edukimin, udhëzimin etj.

Allahu i Madhëruar i dha botës njeriun që do të dinte t'i shlyente plagët e saj, t'i lehtësonte zemërimin; të cilit do t'i vinte keq për gabimet e njerëzve dhe do të gëzohej, teksa shihte se ata do të gjenin rrugën e udhëzimit; i cili do t'i ndihmonte të dobëtit dhe do të luftonte përkrah tyre, siç lufton nëna për të mbrojtur fëmijën e saj. Me këto misionë u dërgua Muhamedi (a.s.), në zemrën e të cilit Allahu mbolli diturinë dhe urtësinë, në karakterin e të cilit futi mirësinë, në natyrën e të cilit nxori në pah lehtësinë dhe butësinë, ndërsa nga duart e të cilit buronin bujaria dhe fisnikëria, aq sa e bëri atë profet, njeriun më të mëshirshëm, më shpirtmadh dhe më zemërgjerë. Prandaj, Allahu i Madhëruar thotë rreth tij: **“Ti ishe i butë ndaj tyre, sepse Allahu të dhuroi mëshirë. Po qe se ti do të ishe i vrazhdë**

dhe zemërfortë, njerëzit do të largoheshin prej teje...” (Ali Imran, 159)

Allahu (xh.sh.), e filloi krijimin e gjithësisë me atë të mëshirës. Fjala e parë që i tha njeriut, ishte fjala “Mëshirë!”. Librin e Tij, që ia shpalli njerëzimit, e filloi me mëshirë. Të gjitha suret e Kuranit, përveç sures Tevbe, fillojnë me **“Bismil-lahir-rahmanir-rahim”** “Me emrin e Allahut, Mëshiruesit Mëshirëbërësit”.

Pejgamberi (a.s.), ishte i mëshirshëm dhe i butë. Ai ishte i mëshirshëm edhe ndaj fëmijëve. Enesi (r.a.), thotë: “Nuk kam parë njeri më të mëshirshëm ndaj fëmijëve, se sa Pejgamberin (a.s.)”. Transmetohet prej Ebu Hurejres (r.a.), që thotë: “Pejgamberi (a.s.), po përqaftonte nipat e tij të dashur, Hasanin dhe Husejnin, në prani të Akra Ibn Habis Et-Temimit. El-Akra u çudit dhe i tha: “Unë kam dhjetë fëmijë dhe asnjërin nuk e kam puthur ndonjëherë!” Pejgamberi (a.s.), e shikoi dhe i tha: “Ai që nuk mëshiron, nuk do të mëshirohet.” Kurse në një transmetim tjetër, thuhet: “Ç'të bëj me ty, në qoftë se Allahu ta ka zhveshur zemrën nga mëshira?” (Buhari, Muslim.)

Kjo mëshirë nuk ka qenë e veçantë vetëm ndaj fëmijëve, por ndaj gjithë besimtarëve. Allahu (xh.sh.), thotë: **“Ju ka ardhur i Dërguari nga lloji juaj. Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, jua dëshiron të mirën, që ju të shkoni rrugës së drejtë, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.”** (Tevbe, 128.)

Pejgamberi (a.s.), shkoi në Taif për t'i thirrur njerëzit në Islam. Populli i Taifit e gjuajti me gurë. Atë çast, vjen Xhibrili (a.s.) dhe i thotë: “A dëshiron ta shkatërroj këtë popull?” Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj: “Jo, i lutem Zotit të vërtetë që t'i bëjë pasardhësit

e tyre njerëz që do ta adhurojnë Allahun dhe nuk do t'i bëjnë shokë Atij.” (Buhari, Muslim.)

Mëshira e përsos natyrën e njeriut dhe e bën atë të jetë i ndjeshëm ndaj dhimbjeve të krijesave. Aty ku ndodhet mëshira, ekziston paqja, respekti dhe marrëdhëniet e mira.

Një grua çifute e kishte bërë zakon t'i hidhte plehurat përpara Profetit (a.s.), sa herë që e shihte atë rrugës. Një ditë, profeti nuk e pa më gruan dhe pyeti për të. I thanë se ishte e sëmurë. Ai shkoi në shtëpinë e saj ta pyeste për shëndetin dhe u lut që ajo të bëhej më mirë. Ajo u trondit nga sjellja e profetit (a.s.) dhe pranoi Islam.

Njerëzimi, sidomos në ditët e sotme, ka nevojë të madhe për këtë cilësi madhështore, që nxit në plotësimin e të drejtave të prindërve dhe të të afërmeve, në ndihmë të të dobtëve, jetimëve, si dhe në ruajtjen e të drejtave të çdokujt tjetër. Ajo bën që gjaku i myslimanëve të mos derdhet padrejtësisht dhe pasuria e tyre të ruhet nga shkatërrimi.

Në momentet më të rënda, në luftën e Uhudit, idhujtarët u munduan ta vrisnin Pejgamberin (a.s.) dhe e detyruan atë të drejtohej drejt një kurthi, një grope të hapur. I rrethuar nga të gjitha anët me armiq, Pejgamberi (a.s.), u plagos rëndë, aq sa u dëmtua në fytyrën e bekuar që ia mbuloi gjaku dhe iu thyen dy dhëmbët e përparmë. Sahabët u zemëruan dhe i thanë: “Lutu kundër tyre (idhujtarëve), o i Dërguar i Allahut”, ndërsa ai u përgjigj: “Unë nuk jam dërguar për të mallkuar, por vetëm për mëshirë.” Ai i ngriti duart nga qielli dhe njerëzit që e panë duke vepruar ashtu, menduan se Profeti do t'i mallkonte idhujtarët, ndërsa nga goja e tij e bekuar dolën fjalët: “Zoti im! Fale, udhëzoje popullin tim, sepse ata nuk e dinë se ç'po bëjnë”.



Si t'i shmangim problemet e stinës së pranverës

Pranvera nuk sjell vetëm gëzim. Por edhe lodhje, nervozizëm, mungesë energjie, vështirësi, humbje të oreksit, dhimbje koke, stres. Sipas një studimi të kryer nga kompania italiane "Eurosalus", kjo befasi me trupin tonë në fillim të verës, ndodh pasi ai gjendet në luftë me përshtatjen ndaj ritmeve të reja të stinës.

"Shkaku kryesor i kësaj, - shpjegon dr. Gabriel Piuri, - vjen nga rritja e orëve aktive të organizmit në tërësi, duke e bërë atë që të konsumojë më shumë energji. Por jo vetëm. Edhe ndryshimi i orës, ju bën që të flini një orë më pak, e kësisoj, për disa njerëz ky kthehet në një shqetësim të vërtetë".

Për të mposhtur këto sëmundje tipike të pranverës, parulla kryesore është: Rregull!

Që do të thotë, përmbushje e një cikli të rregullt gjumi.

Themelore për fizikun tonë, por edhe për me-

ndjen tonë, është që të shkojmë në shtrat dhe të zgjohemi në të njëjtën kohë. Por çfarë të hamë në pranverë? Lidhur me ushqimin në ndryshimin e sezonit, paraqitet e nevojshme që të rritet konsumi i frutave dhe perimeve. Këshilla tjetër që jepet në këtë sezon, është edhe ajo e rritjes së furnizimit të trupit me më shumë vitamina.

Sa u përket mineraleve, magnezi është i rëndësishëm në këtë sezon, pasi forcon muskujt, siguron energji dhe humbje të humorit të keq, në sajë të vepërimit që ushtron në sistemin tonë nervor.



Arsyet pse duhet ta konsumojmë ujin

Nga të gjitha ushqimet dhe artikujt që janë pa kalori dhe pothuajse që nuk kushton fare, por që është me rëndësi të veçantë për jetën dhe ekzistencën tonë, është uji.

Megjithatë, këto nuk janë arsyet e vetme për ta konsumuar atë. Të gjitha sistemet në organizëm e kërkojnë ujin për të funksionuar si duhet.

Uji na ndihmon në zbutjen e stresit.

Konsumimi i ujit gjatë ditëve stresuese na ndihmon në zbutjen e problemeve të shkaktuara nga stresi, nga dhembjet e kokës, tensionimi i muskujve, mos-

përqendrimit dhe rrahja e shpejtë e zemrës. Kjo, pasi stresi ndikon në të gjitha sistemet bazë të trupit dhe, kur jemi të dehidruar, të gjitha këto efekte rriten. Uji nuk e eliminon stresin, por gjithsesi na dhuron më tepër energji dhe e zbut tensionimin tonë, e rregullon frymëmarrjen dhe përmirëson rrahjet e zemrës.

Uji zvogëlon peshën trupore.

Një studim në të cilin kishin marrë pjesë persona të moshës midis 55 dhe 75 vjeçe, ka treguar se, nëse konsumoni dy gota ujë para çdo vakti ushqimi, për 12 javë mund të humbni rreth dy kilogramë, madje në mënyrë shumë të shëndetshme, efekt të cilin nuk mund ta arrijnë shumë dieta. Ky hulumtim ka treguar se personat që para ushqimit konsumojnë ujë, shtojnë rreth 75 kalori më pak, e kjo do të thotë se, nëse gjatë gjithë kohës e vazhdoni një mënyrë të tillë të ushqimit, brenda vitit do të humbni rreth gjashtë kilogramë.

Do të jemi më pak të ekspozuar ndaj ftohjeve.

Uji është mbrojtës natyral i sistemit mbrojtës dhe ndihmon që bakteriet, si viruset dhe gripi, të qëndrojnë sa më larg nesh. Nëse ftohemi, serioziteti i sëmundjes do të jetë më i vogël kur konsumojmë ujë.

Ftohja me ujë për portativët

Kompania Asetek demonstroi një teknologji interesante të ftohjes me ujë të laptopëve dhe kompjuterëve AIO.

Teknologjia kombinon sistemin e ftohjes me ujë dhe zgjidhjen standarde për ftohje me gypat që përçojnë nxehtësinë në një sistem mbresëlënës për ftohjen e kompjuterëve, të cilët kanë dimensione të kufizuara fizike.

Asetek mendon se ftohja me ujë e këtij lloji ka më së shumti kuptim të përdoret në laptopët e fuqishëm për lojërë, në stacionet mobile punuese dhe në kompjuterë "i gjithë në një", si dhe ofron performancat më të mira dhe nivel më të ulët të zhurmës, në krahasim me ftohjen me ajër. Sistemi është demonstruar në portativin M18x të Alienware, me procesorin e overlockuar nga 3.5 në 4.4 GHz dhe me taktet e GPU-së, të ngritur nga 680 në 800 MHz.

Në rastin e laptopit me ftohje ajrore nga fabrika nuk arriti të ftohë komponentët në taktet e përmendur punues, derisa tek zgjidhje e Asetek ai tregon punë të qetë dhe mbresëlënëse me performanca 23% më të larta në 3D Mark Vantage.



Ngrohja globale nuk është thjesht një term që përdoret për të ndërgjegjësuar njerëzit, por është shndërruar në një risk real.

Nga të gjitha llojet e studimeve, më e rrezikuar

duket se është Britania e Madhe.

Vendi ishullor rrezikon "zhdukjen" nga ngritja e nivelit të ujit të oqeanit, si pasojë e shkrirjes së akujve në Polin e Veriut.

Pikërisht për të ndaluar këtë, shkencëtarët britanikë kanë

Teknologjia që do të ftohë planetin

propozuar ndërtimin e "ftohësve të atmosferës". Inxhinieri Stephen Salter paraqiti para autoriteteve britanike projektin e tij për "uzinën ftohëse". Sipas Satler, uzinat duhet të ndërtohen në afërsi të Polin të Veriut dhe vendi ideal janë Ishujt Faroe.

Funksionimi i tyre është mjaft i thjeshtë: marrja e ujit të detit dhe lëshimi i tij në ajër me shpejtësi, duke shfrytëzuar energjinë alternative. Lëshimi me shpejtësi nga gypat e uzinës do të krijonte kondensimin e bulëzave të ujit, duke formuar kështu, ato që ne i quajmë "re të bardha".

Satler thotë se nga studimet, retë e bardha zbehin depërtimin e rrezeve të nxehta diellore, duke formuar një "mur mbrojtës" në Polin e Veriut. "Kjo teknologji do të ftohë planetin"- tha ai.

Të punosh në fabrikat e "APPLE"

Mbase ky nuk është një lajm për risitë shkencore dhe teknologjike, por të gjithë duhet të informohemi për ata, që me duart dhe mundin e tyre bëjnë të mundur që të gjitha këto risi teknologjike, të cilat i përdorim në jetën e përditshme, të shohin dritën e diellit.

Orë pune shtesë dhe asnjë ditë pushimi në javë, konvikte të tejmbushura me njerëz që qëndrojnë si sardele dhe persona të detyruar të qëndrojnë në këmbë 24 orë me radhë. Ky nuk është skenari i ndonjë filmi horror, por kushtet në të cilat punojnë punëtorët kinezë në fabrikat e "Apple", atje ku prodhohet "iPhone" dhe "iPad".

Sikur të mos mjaftonte vetëm trajtimi çnjerëzor, produktet me të cilat ndërtohen pajisjet e teknologjisë së lartë janë të rrezikshme për shëndetin dhe shpeshherë kanë shpërthyer në mënyrë të papritur.

Ishte një reportazh i "New York Times", ai që solli në vë-

mendjen e publikut amerikan mënyrën se si trajtohen "skllëvërit" e "Apple", por problemi është shumë më i gjerë, sepse kushte të ngjashme kompanitë e mëdha ndërkombëtare u ofrojnë gjerësisht punonjësve kinezë, indianë apo të tjerë në fabrikat e tyre të vendosura në vende të botës së tretë.

Më parë, gjatë javës, "Apple" publikoi shifrat e të dhënave të saj financiare, ku flitej për 13 miliardë euro fitime vetëm në periudhën tetor-dhjetor. Kostoja reale e një "iPhone" është më e vogël se 50 dollarë, por ai shitet dhjetë herë më shumë anëmbanë botës. Ndërkohë, një punëtor në Kinë, paguhet jo më shumë se 2-3 dollarë në ditë.



Presidenti i Shqipërisë nderohet me titullin e lartë "Dr. Honoris Causa" në Stamboll

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi u vlerësua nga Universiteti Ajdën i Stambollit (IAÜ) me titullin "Doktor Nderi" në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Prof. Dr. Bamir Topi mori pjesë në Konferencën e Liderëve, organizuar në Stamboll nga Unioni i Universiteteve Euroaziatike (EURAS) dhe Universiteti Ajdën i Stambollit, ku mbajti një fjalim me temë: "Transformimi i Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në 20 vitet e fundit, në drejtim të zhvillimeve ndërkombëtare dhe bashkëpunimit në fushat arsimore dhe kulturore me Shqipërinë".

Krahas Kreut të Shtetit të Shqipërisë, të pranishëm në këtë konferencë ishin Ministri i Integritimit Evropian dhe Kryenegociatori i Turqisë, Egemen Baësh, Presidenti i Bordit Administrues të Universitetit Ajdën të Stambollit, Mustafa Ajdën, Rektori i IAÜ-së, Prof. Dr. Jadigar Izmirli, akademikë dhe studentë.

Ministri i Integritimit Evropian dhe Kryenegociatori i Turqisë, Egemen Baësh, gjatë fjalimit të tij vuri theksin në miqësinë dhe vëllazërinë historike mes popullit turk dhe atij shqiptar.

Ndërsa Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi vuri në dukje se marrëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë shkojnë përtej "miqësisë". Ai përmendi kontributin e madh të Ankarasë në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe nënvizoi se kjo mbështetje nuk do të harrohet kurrë.

Presidenti Topi, i cili tërhoqi vëmendje se një nga çështjet më kryesore të viteve të fundit për Shqipërinë dhe Turqinë është integrimi evropian, vijoi me këto fjalë: "Vendet, që duan ta arrijnë me sukses këtë objektiv, përipiqen me të gjitha forcat dhe përparojnë me hapa të sigurt drejt zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Nëse duhet të flas për vendin tim, gjatë 20 viteve të fundit janë shënuar zhvillime të mëdha. Sot Shqipëria, ku në vitin 1990 mbisundonte

regjimi totalitar, është një ndër 28 vendet anëtare të NATO-s."

Në fund të fjalimit, Presidenti Topi, duke shprehur "interesin dhe gatishmërinë e Shqipërisë për të qenë aktive në nisma e projekte konkrete bashkëpunimi në të gjitha aspektet e bashkëpunimit kulturor e arsimor", vlerësoi "frymën e veçantë të miqësisë historike dhe partneritetin strategjik me Turqinë, si një vend mik, me lidhje të forta historike dhe aktuale, një vend dhe një popull tek i cili kemi gjetur e gjejmë përherë një mik të madh e të sinqertë të popullit dhe të kombit shqiptar".

Ndërkaq, gjatë ligjëratës së tij z. Topi u ballafaqua me një surprizë të studentëve shqiptarë dhe atyre turq, të cilët hapën flamujt kombëtar të Turqisë dhe Shqipërisë, duke bërë kështu që salla të shpërthente në duartrokitje.

Në përfundim të "Konferencës së Liderëve", Presidenti Topi iu përgjigj disa pyetjeve të studentëve të pranishëm lidhur me zhvillimet në Shqipëri, qëndrueshmërinë në rajonin ballkanik dhe efektet e krizës ekonomike në rajon.

Pas fjalimit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, studentët e Modës pranë Universitetit Ajdën të Stambollit organizuan një sfilatë me temë: "Dielli Lind nga Mali Nemrud". Në fund, Prof. Dr. Bamir Topi u vlerësua me titullin "Doktor Nderi" në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.



SHBA kërcënon 12 vende që nuk ulin importin e naftës nga Irani

Shtetet e Bashkuara të Amerikës deklaruan se do të mund të vendosin sanksione ndaj 12 vendeve, të cilat nuk ulin importin e naftës nga Irani. Pretendohet se edhe Turqia gjendet në mesin e këtyre 12 vendeve.


Sipas deklaratës së bërë nga Ministria e Jashtme e Turqisë, në rast se këto vende nuk reduktojnë importin e naftës nga Irani, ndaj tyre do të mund të aplikohen sanksione, por në deklaratë nuk janë dhënë emrat e këtyre vendeve.

Agjencia e lajmeve Reuters, duke u bazuar në deklaratat e një zyrtari të lartë të administratës së Obamas, i cili dëshiron të mbetet anonim, njoftoi se ka vënë në dorë

listën me emra të këtyre vendeve. Sipas kësaj liste të Reutersit, krahas Kinës, Indisë, Koresë së Jugut, Indonezisë, Malajzisë, Pakistanit, Republikës së Afrikës së Jugut gjendet edhe Turqia.

Kina dhe India gjenden në krye të vendeve të cilat importojnë naftë nga Irani. Së bashku me këtë, Pekini në shkurt kishte deklaruar se ka përgjysmuar importin e naftës nga Irani. Departamenti amerikan për Marrëdhënie me Jashtë, më herët kishte deklaruar se nga sanksionet janë të përjashtuar 10 vende të Bashkimit Evropian dhe Japonia.

101 Hapa në Edukim



Vetëm
2€

*Asbtu sikur është e pamundur që dielli të mos ngrohë,
po asbtu është e pamundur të mos mëshiroben ato shpirta që janë të mbushur
me dashuri, ngazëllim dhe shije për besim.*

*Duke arritur në dbuntinë e të vështuarit të krijesave
sipas shikimit që i bën Krijuesi atyre, miqtë e Zotit që i referoben mëshirës,
dbembsburisë dhe dashurisë së Zotit
do të jenë përgjithmonë miqtë e të gjithë universit.*